

LIGJI

PËR TË DREJTAT E AUTORIT

DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

Ligj 04/L-065, GZ 27/2010
ndryshu me ligj 04/L-065, GZ 37/2016

shtypë: mars 2018

**LIGJI Nr. 04/L-065
PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR TË DREJTAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi i Ligjit**

1. Ky ligj rregullon:

1.1. të drejtat e autorit që, në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, në vijim e drejta e autorit;

1.2. të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të përafërta me të drejtat e autorit, në vijim të drejtat e përafërta, u takojnë:

1.1.1. interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre;

1.1.2. prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre;

1.1.3. producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre;

1.1.4. shërbyesit medial Audiovizuel përkitazi me transmetimet e tyre;

1.1.5. prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave;

1.1.6. botuesve përkitazi me botimet e tyre;

1.3. administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta;

1.4. mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta;

1.5. zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj.

**Neni 2
Parimet e zbatimit**

Masat administrative, inspektimi, mbrojtja juridiko-civile dhe penale, të përcaktuara me këtë ligj, zbatohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës administrative dhe gjyqësore.

Neni 3

Marrëdhënia midis të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta

1. Mbrojtja e parashikuar me këtë ligj për të drejtat e përafërta nuk prek dhe nuk ndikon në asnjë mënyrë në mbrojtjen e të drejtës së autorit.

2. Dispozitat e këtij ligji lidhur me:

2.1. elementet e të drejtës së autorit, me supozimin e autorësisë;

2.2. me bashkautorët dhe autorët e veprës së gërshetuar;

2.3. me përmbajtjen e të drejtave pasurore të autorit dhe të drejtën në kompensim të veçantë për riprodhim privat ose tjetër vetanak;

2.4. me marrëdhënien midis të drejtës së autorit dhe të drejtës së pronësisë mbi ekzemplarën e veprës;

2.5. me kufizimet e të drejtës së autorit, përfshirë dhe përfshirjen e kufizimeve;

2.6. me llogaritjen e fillimit dhe efektin e mbarimit të kohëzgjatjes së mbrojtjes të së drejtës së autorit, si dhe kalimin e të drejtës së autorit;

3. Zbatohen ngjashëm dhe sa u takon mutatis mutandis edhe ndaj të drejtave të përafërta.

Neni 4

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Shërbimi medial audiovizual** - shërbimi i cili është nën përgjegjësinë editoriale të ofruesit të shërbimeve programore dhe parim kryesor i së cilës është ofrimi i programeve me qëllim që të informojnë, argëtojnë apo të edukojnë gjithë publikun përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.

1.2. **Shoqata kolektive** - ka kuptimin e asociacionit të formuar në pajtim me dispozitat e kreut III të këtij Ligji, në mënyrë që të zbatojë detyrat dhe aktivitetet e administrimit kolektiv të së drejtës së autorit apo të drejtave të përafërta;

1.3. **Shkalla komerciale** - veprimet e një personi, që zbatohen për përfitim pasuror të drejtpërdrejtë apo jo të drejtpërdrejtë, duke mënjanuar veprimet e zbatuara nga shfrytëzuesit e fundit që veprojnë në mirëbesim;

1.4. **Publikim** - kur një vepër e mbrojtur me të drejta të autorit apo me të drejta të përafërta i është vënë në dispozicion publikut me pëlqimin e bartësit të të drejtës;

1.5. **Të drejtat morale** - të drejtat ekskluzive të cilat mbrojnë integritetin e veprës së mbrojtur të autorit dhe personalitetin e autorit të saj;

1.6. **Zyrë** - Zyra për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, e cila funksionon në pajtim me dispozitat e këtij ligji;

1.7. **Posedues** - personi fizik apo personi juridik i cili posedon një vepër origjinale apo kopjen e veprës;

1.8. **Publik** - një numër më i madh njerëzish të cilët janë jashtë rrethit të zakonshëm të familjes apo jashtë rrethit të njerëzve që njihen personalisht;

1.9. **Botim** - kur një numër i mjaftueshëm i kopjeve të një vepre të mbrojtur me të drejtën e autorit, apo një objekt të të drejtave të përafërta, i është ofruar publikut, ose është vënë në qarkullim me pëlqimin e bartësit të të drejtës.

1.10. **Videogram** - incizim i veprës audiovizuale apo i sekuencave të fotografive me apo pa zë shoqërues dhe fiksimi i tyre, në bartës të fotografisë ose të fotografisë dhe zërit.

1.11. **Vepër audiovizuale** - janë: filmat kinematografikë, televizivë dhe vizatimorë, filmat e shkurtër videomuzikorë, filmat reklamues, filmat dokumentarë si dhe veprat tjera audiovizuale, të shprehura në formë të vargut të pamjeve lëvizëse të ndërlidhura, të shoqëruara me zë apo pa të, pavarësisht nga lloji i mbajtësit lëndor ku janë të fiksuara.

1.12. **Programet kompjuterike** - janë programet e shprehura në çfarëdo forme kompjuterike, duke përfshirë edhe materialin e dizajnuar të përgatitur për krijimin e tyre.

1.13. **Interpretues** - janë aktorët, këngëtarët, muzikantët, vallëzuesit dhe personat e tjerë, që me anë të aktrimit, këndimit, gjuhës së gjesteve apo të lëvizjeve, recitimit apo ndonjë mënyre tjetër interpretojnë vepra të autorit ose shprehje të folklorit, pastaj regjisori i shfaqjes teatrore, dirigjenti i orkestrës, dirigjenti i korit, mjeshtri i tonit dhe artistët e cirkut e të varietesë.

1.14. **Prodhues i fonogramit** - personi fizik apo juridik i cili me iniciativën dhe përgjegjësinë e vet bën i pari fiksimin e tingujve të ndonjë interpretimi ose të tingujve të tjerë si dhe shprehjeve tjera zanore. Konsiderohet se është prodhues i fonogramit të caktuar personi, emri i të cilit, firma, pseudonimi apo marka është e shënuar në mënyrë të zakonshme si e tillë në fonogram ose është treguar me rastin e publikimit të fonogramit, derisa nuk provohet ndryshe.

1.15. **Fonogrami** - fiksimit i tingujve të ndonjë interpretimi ose të tingujve apo shprehjeve të tjera zanore, përveç në formën e fiksimit që është inkorporuar në veprën audiovizuale.

1.16. **Fiksimi** - vendosja e tingujve ose e shprehjeve zanore në bartës nga i cili mund të dëgjohen, riprodhohen ose komunikohen përmes ndonjë pajisjeje.

1.17. **Producent i filmit** - personi fizik apo juridik i cili, me iniciativën dhe nën përgjegjësinë e vet, e fikson i pari një vepër audiovizuale në videogram. Konsiderohet se producent i filmit është personi emri i të cilit, firma ose marka në mënyrë të zakonshme është shënuar në videogram si i tillë ose është treguar me rastin e publikimit të videogramit, derisa nuk provohet ndryshe.

1.18. **Baza e të dhënave** - koleksion i veprave të mëvetësishme, të të dhënave dhe materialeve tjera të çfarëdo forme, të rregulluara në mënyrë sistematike ose metodike që kanë qasje veç e veç nëpërmjet mjeteve elektronike apo mjeteve tjera, me ç'rast marrja, verifikimi apo paraqitja e përmbajtjeve të saj nga ana kualitative dhe kuantitative si dhe kualitative ose kuantitative kërkon investim thelbësor.

1.19. **Prodhues i bazës së të dhënave** - personi fizik apo juridik i cili me iniciativën dhe nën përgjegjësinë e vet bën i pari investim thelbësor në kuptim të nën-paragrafit 1. të këtij paragrafi. Konsiderohet se prodhues i bazës së të dhënave është personi, emri i të cilit, firma, pseudonimi apo marka është shënuar në mënyrë të zakonshme në atë bazë të dhënash ose është treguar me rastin e publikimit të asaj baze, derisa nuk provohet ndryshe.

KREU II

NËNKREU A E DREJTA E AUTORIT

Neni 5

Autorët e veprave në lëmin e letërsisë, shkencës dhe të artit gëzojnë mbrojtjen lidhur me veprat e veta dhe shfrytëzimin e tyre, në përputhje me këtë ligj.

Neni 6

1. E drejta e autorit është e drejtë e pandashme e një vepre, e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale për veprën e mbrojtur.

2. E drejta e autorit përmban:

2.1. autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit, në vijim: të drejtat morale të autorit;

2.2. autorizimet ekskluzive pasurore për të mbrojtur interesat pasurore të autorit, në vijim: të drejtat pasurore të autorit;

2.3. autorizimet tjera të autorit, në vijim: të drejtat tjera të autorit.

Neni 7

1. E drejta e autorit i takon autorit me vetë faktin e krijimit të veprës.

2. Për të gëzuar mbrojtjen e të drejtës së autorit nuk kërkohet plotësim paraprak i çfarëdo formaliteti administrativ.

NËNKREU B VEPRAT E AUTORIT DHE KUSHTET E MBROJTJES

Neni 8 Veprat e mbrojtura

1. Vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale në lëmin e letërsisë, të shkencës dhe artit, që janë të shprehura në çfarëdo mënyre, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

2. Vepra të autorit konsiderohen në veçanti:

2.1. veprat gojore, siç janë fjalimet, leksionet, tregimet dhe vepra të ngjashme të shprehura gojarisht;

2.2. veprat e shkruara, siç janë tekstet në libra, broshurat, gazetat ditore dhe tekste të tjera në lëmin e letërsisë, literaturës shkencore e profesionale, si dhe programe kompjuterike;

2.3. veprat muzikore, me ose pa tekst, pavarësisht a janë të shprehura përmes notave apo në ndonjë formë tjetër;

2.4. veprat teatrore teatrore-muzikore dhe të kukullave, përfshirë dhe radiodramat;

- 2.5. veprat koreografike dhe të pantomimës;
- 2.6. veprat filmike dhe veprat e tjera audiovizuale;
- 2.7. veprat fotografike dhe veprat e bëra me një proces të ngjashëm si ai i fotografisë, siç janë fotografitë artistike, fotomontazhet, fotoafishet, fotografitë e reporterëve;
- 2.8. veprat e artit figurativ në lëmin e pikturës, skulpturës, grafikës, vizatimit;
- 2.9. veprat e arkitekturës, siç janë skicat, planet, maketat dhe objektet e ndërtuara të veprave arkitekturore dhe të inxhinierisë nga fusha e arkitekturës, urbanizmit, arkitekturës së peizazhit dhe rregullimit të enterierit;
- 2.10. veprat skenografike;
- 2.11. veprat e artit aplikativ si dhe të dizajnit industrial e grafik;
- 2.12. veprat kartografike në lëmin e gjeografisë dhe topografisë;
- 2.13. prezantimet shkencore, edukative ose teknike siç janë vizatimet teknike, grafikonet, tabelat, ekspertizat, demonstrimet tredimensionale.

Neni 9 Elementet e veprës së autorit

1. Vepra e pambaruar e autorit, pjesët përbërëse të veprës si dhe titulli i veprës së autorit, që janë vetvetiu krijime intelektuale origjinale, gëzojnë mbrojtje si edhe vetë vepra.
2. Nuk është e lejuar të shfrytëzohet si titull i veprës një titull i cili është shfrytëzuar më parë për llojin e njëjtë të veprës, nëse një titull i tillë shkakton konfuzion në lidhje me autorësinë e veprës.

Neni 10 Veprat e prejardhura

1. Vepër e autorit konsiderohet edhe vepra e prejardhur e përpunuar ose e formësuar, nëse i plotëson kushtet nga paragrafi 1. i nenit 8 të këtij ligji.
2. Vepra të prejardhura janë përkthimet, përshtatjet, aranzhmanet, orkestrimet muzikore dhe përpunimet tjera të një vepre ekzistuese apo materiali tjetër.
3. Mbrojtje gëzojnë edhe përkthimet e teksteve ligjore, vendimeve të gjykatave dhe akteve administrative, nëse ato nuk janë bërë për botim zyrtar.
4. Të drejtat e autorëve të veprave tashmë ekzistuese nuk shkelen me rastin e përpunimit të këtyre veprave ekzistuese.

Neni 11 Koleksionet e veprave

1. Vepër e autorit konsiderohet koleksioni i veprave ekzistuese të autorit ose materialeve të tjera që për nga përzgjedhja, përshtatja dhe bashkërenditja e përmbajtjeve të tyre paraqet krijim origjinal intelektual, përkatësisht vepër të mëvetësishme siç janë: enciklopeditë, antologjitë, koleksionet e kuotimeve, e poezive apo veprave në prozë, përmbledhja e shprehjeve folklorike, e dokumenteve dhe vendimeve gjyqësore.
2. Koleksion konsiderohet edhe baza e të dhënave të veprave të mëvetësishme, të dhënave ose

materialeve tjera të rregulluara, të sistematizuara në mënyrë metodike e që qasen veç e veç me mjete elektronike apo me mjete të tjera.

3. Mbrojtja sipas këtij neni nuk zbatohet ndaj programeve kompjuterike të përdorura për bërjen apo funksionimin e bazës elektronike të të dhënave përveç nëse janë krijime origjinale.

4. Me ngërthimin e veprave ekzistuese në koleksion nuk mund të shkelen të drejtat e autorëve të këtyre veprave autoriale. Me ngërthimin në koleksion, materiali ekzistues nuk bëhet vepër e mbrojtur.

Neni 12 Krijimet pa mbrojtje

1. Mbrojtja juridike e të drejtave të autorit nuk përfshin:

1.1. idetë, parimet, udhëzimet, procedurat, zbulimet ose konceptet matematikore si të tilla.

1.2. ligjet, aktet nënligjore dhe rregullativat tjera.

1.3. materialet zyrtare dhe botimet e organeve parlamentare, qeveritare dhe të organizatave tjera që kryejnë funksione publike.

1.4. përkthimet zyrtare të rregullativave dhe materialeve tjera zyrtare, si dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe instrumenteve tjera.

1.5. parashtrirat dhe aktet tjera në procedurat administrative ose gjyqësore.

1.6. materialet zyrtare të botuara për informim të publikut.

1.7. shprehjet folklorike.

1.8. lajmet e ditës dhe informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të mediave.

NËNKREU C AUTORI

Neni 13 Personi fizik

Autor është personi fizik i cili e ka krijuar veprën.

Neni 14 Supozimi i autorësisë

1. Personi, emri, përkatësisht firma, pseudonimi apo shenja e të cilit është shënuar në ekzemplar të veprës ose është theksuar me rastin e publikimit të veprës, supozohet që është autor i veprës, respektivisht bartës i të drejtës, përderisa nuk provohet e kundërta.

2. Të drejtat e autorit në veprat e publikuara me pseudonim apo shenjë, autori i të cilave është anonim, supozohet se është i autorizuar t'i realizojë botuesi, përderisa nuk zbulohet identiteti i autorit. Nëse edhe botuesi mbetet anonim supozohet se të drejtat e njëjta është i autorizuar t'i realizojë personi që ka bërë publikimin e veprës.

3. Paragrafi 2. i këtij neni pushon së zbatuari, nëse provohet identiteti i autorit.

4. Bartësi i të drejtës sipas paragrafit 2. të këtij neni, duhet t'ia përcjellë autorit përfitimet e dala nga të

drejtat e autorit, nëse nuk është paraparë ndryshe me kontratë. Të drejtat e fituara nga personat e tretë mbesin në fuqi.

Neni 15 Bashkautorët

1. Nëse vepra përbën tërësi të pandashme është krijuar në bashkëpunim të dy apo më shumë personave ata konsiderohen bashkautorë të veprës.
2. E drejta e autorit mbi veprën e bashkautorëve u takon të gjithë bashkautorëve dhe administrohet me pëlqimin e tyre, nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj ose me kontratë.
3. Bashkautori nuk mund të kundërshtojë pa ndonjë arsye dhënien e pëlqimit të vet, për publikim ose shfrytëzim të veprës.
4. Bashkautorët nuk mund t'i administrojnë të drejtat në mënyrë të ndarë, nëse nuk është arritur ndonjë marrëveshje në mes tyre.
5. Marrëdhëniet e bashkautorëve përkritazi me pjesët e tyre të përfitimit pasuror nga shfrytëzimi i veprës përcaktohen në përpjesëtim me kontributet e secilit prej tyre në krijimin e veprës, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me kontratë.
6. Nëse ndonjëri nga bashkautorët heq dorë nga pjesa e tij në përfitimet pasurore shtohen pjesët e koautorëve të tjerë në përpjesëtim me madhësitë fillestare.

Neni 16 Autorët e veprave të gërshetuara

1. Kur dy a më shumë autorë i bashkojnë veprat e tyre me qëllim të shfrytëzimit të përbashkët ose për disa forma të shfrytëzimit, secili prej tyre gëzon të drejtën e autorit lidhur me kontributin e vet.
2. Marrëdhëniet midis autorëve të veprave të gërshetuara rregullohen me kontratë.
3. Dispozitat e nenit 15, paragrafëve 3. deri në 6. të këtij ligji, zbatohen në mënyrë analoge mutatis mutandis, edhe ndaj autorëve të veprave të gërshetuara.

NËNKREU D TË DREJTAT MORALE

Neni 17 E drejta e publikimit të parë

1. Autori ka të drejtë ekskluzive për të vendosur nëse, kur dhe në çfarë mënyre do të publikohet për herë të parë vepra e tij.
2. Autori ka të drejtën ekskluzive për t'ia komunikuar publikut apo për t'ia përshkruar përmbajtjen e veprës së tij përderisa vepra nuk është bërë e ditur me autorizimin e tij.

Neni 18 E drejta e njohjes së autorësisë

1. Autori ka të drejtën ekskluzive të njihet dhe të shënohet si autor i veprës.
2. Autori ka të drejtë të vendosë nëse autorësia e tij duhet të tregohet me emër, pseudonim apo shenjë.

Neni 19
E drejta në integritet të veprës

Autori ka të drejtë ekskluzive ta kundërshtojë çfarëdo deformimi, apo intervenimi tjetër në veprën e tij, si dhe çfarëdo shfrytëzimi të veprës së tij, nëse një ndërhyrje e tillë do të mund ta paragjykonte reputacionin e tij kreativ dhe respektin.

Neni 20
E drejta e pendimit

1. Autori mund ta revokojë të drejtën pasurore që ia ka kaluar tjetrit, nëse për këtë ka arsye serioze morale, me kusht që bartësit të së drejtës t'ia kompensojë dëmin real të shkaktuar nga revokimi i tillë i të drejtës.

2. Me rastin e zbatimit të të drejtës së pendimit e drejta pasurore e bartësit të të drejtës shuhet. Ky zbatim ndodh me pagesën e kompensimit.

3. Bartësi i të drejtës duhet që brenda tre (3) muajve nga dita e paralajmërimit për revokimin e të drejtës ta njoftojë autorin për masën e dëmit të pësuar nga revokimi i të drejtës. Nëse bartësi i të drejtës nuk vepron kështu e drejta e pendimit zbatohet me mbarim të afatit.

4. Nëse autori më vonë dëshiron që përsëri të bëjë kalimin e të drejtave lidhur me shfrytëzimin e veprës së tij, dhe nëse nuk kanë kaluar dhjetë (10) vjet nga përdorimi i të drejtës së pendimit, duhet së pari dhe në kushte të mëparshme t'ia ofrojë këto të drejta së pari bartësit të mëparshëm të të drejtave.

5. Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për programet kompjuterike, veprat audiovizuale dhe për baza të të dhënave.

NËNKREU E
TË DREJTAT PASURORE

Neni 21
E drejta e shfrytëzimit dhe format e saj

1. Autori ka të drejtë ekskluzive për shfrytëzimin pasuror të veprës së tij në çfarëdo forme, si dhe t'ia lejojë apo ndalojë personave të tjerë shfrytëzimin e veprës së tij, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

2. Personat tjerë mund të shfrytëzojnë veprën e autorit vetëm në bazë të autorizimit të autorit për kalimin e të drejtave ekskluzive dhe me kushtet e vendosura prej tij, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

3. Për çdo kalim të të drejtës për shfrytëzimin e veprës, autorit i takon kompensimi, nëse me këtë ligj ose me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 22
Shfrytëzimi i veprës

1. Vepra e autorit mund të shfrytëzohet në formë lëndore, jolëndore dhe të modifikuar.

2. Shfrytëzimi i veprës në formën lëndore përfshin në veçanti të drejtat ekskluzive të autorit si në vijim:

2.1. të drejtën e riprodhimit;

- 2.2. të drejtën e shpërndarjes;
- 2.3. të drejtën e qiradhënies;

3. Shfrytëzimi i veprës në formë jolëndore përfshin në veçanti të drejtat ekskluzive të autorit si në vijim:

- 3.1. të drejtën e interpretimit publik;
- 3.2. të drejtën e shfrytëzimit nga "Shërbyesit medial audiovizual";
- 3.3. të drejtën e komunikimit publik me anë të fonogrameve dhe videogrameve;
- 3.4. të drejtën e shfaqjes publike;
- 3.5. të drejtën e vënies së veprës në dispozicion të publikut.

4. Shfrytëzimi i veprës në formën e modifikuar përfshin në veçanti të drejtat ekskluzive si në vijim:

- 4.1. të drejtën e përpunimit;
- 4.2. të drejtën e përshtatjes audiovizuale.

NËNKREU F SHFRYTËZIMI I VEPRËS NË FORMËN LËNDORE

Neni 23 E drejta e riprodhimit

1. E drejta e riprodhimit është e drejtë ekskluzive e autorit që të lejojë apo ndalojë fiksimin e veprës së tij ose të ekzemplarit të veprës në mbajtës lëndor, të bërë drejtpërdrejt apo tërthorazi, përkohshëm apo përhershëm, në çfarëdo mënyrë apo formë, në tërësi apo pjesërisht dhe pavarësisht nga numri i ekzemplarëve.
2. Vepra është e reprodukuar kur bëhet përmes shumëzimit grafik, riprodhimit tredimensional, shkrirjes, fotografimit, fiksimit audio ose video, regjistrimit elektronik.
3. Ndërtimi i objektit arkitekturor sipas projektit konsiderohet akt reprodukimi.

Neni 24 E drejta e shpërndarjes

1. E drejta e shpërndarjes është e drejtë ekskluzive e autorit për ta autorizuar apo ndaluar vënien në qarkullim të veprës origjinale apo kopjet e veprës së tij përmes shitjes apo ndonjë forme tjetër të bartjes së pronësisë, përfshirë ofrimin e tyre publikut për qëllim të tillë.
2. Me shitjen e parë ose bartjen në formë tjetër të pronësisë për origjinalin apo kopjen e veprës, të bërë nga autori ose me pëlqimin e tij, e drejta e shpërndarjes për atë origjinal apo kopje të veprës shteret për territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 25 E drejta e qiradhënies

1. E drejta e qiradhënies është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndalojë që origjinali apo ekzemplarët e veprës së tij të jepen në shfrytëzim për afat të caktuar, përmes përfitimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasuror.

2. Dispozitat nga paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohen për shfrytëzimin e:

2.1. veprës së ndërtuar arkitekture;

2.2. origjinalit ose të ekzemplarëve të Veprave të arteve aplikative dhe të dizajnit industrial;

2.3. veprës në rast të shikimit të atypëratyshëm, origjinalit ose të kopjeve të saj në hapësira të institucionit.

3. Autori i cili të drejtën e vet të qiradhënies ia ka kaluar prodhuesit të fonogrameve apo producentit të filmit mban të drejtën e kompensimit të drejtë nga qiradhënia.

NËNKREU G **SHFRYTËZIMI I VEPRËS NË FORMËN JOLËNDORE**

Neni 26 **E drejta e interpretimit publik**

1. E drejta e interpretimit publik është e drejtë ekskluzive e autorit për ta lejuar ose ndaluar recitimin publik, ekzekutimin muzikor publik ose shfaqjen publike të veprës së vet.

2. E drejta e recitimit publik është e drejta e komunikimit të veprave të shkruara apo gojore përmes recitimit apo leximit drejtpërdrejtë para publikut.

3. E drejta e ekzekutimit muzikor publik është e drejta e komunikimit të veprës muzikore përmes ekzekutimit të drejtpërdrejtë para publikut.

4. E drejta e shfaqjes publike është e drejta e komunikimit të veprave skenike drejtpërdrejtë para publikut.

Neni 27 **E drejta e transmetimit publik**

E drejta e transmetimit publik është e drejtë ekskluzive e autorit të lejojë apo të ndalojë që recitimet, interpretimet ose shfaqjet e veprës së tij t'i transmetohen përmes altoparlantit, ekranit ose një mjeti tjetër, publikut që gjendet jashtë vendit ose hapësirës burimore.

Neni 28 **E drejta e komunikimit publik me fonogramet ose videogramet**

E drejta e komunikimit publik me anë të fonogrameve ose videogrameve është e drejtë ekskluzive e autorit të lejojë apo ndalojë që vepra e tij, e cila është fiksuar në fonogram apo videogram, t'i komunikohet publikut me anë të mjeteve teknike për riprodhim audiovizuel.

Neni 29 **E drejta e paraqitjes publike**

E drejta e paraqitjes publike është e drejtë ekskluzive e autorit të lejojë apo ndalojë që me anë të mjeteve teknike t'i komunikohet publikut vepra e tij audiovizuale, vepra fotografike, vepra figurative, vepra e arteve aplikative dhe dizajnit industrial, vepra koreografike dhe prezantimet shkencore apo teknike.

Neni 30 **Transmetimi dhe ritransmetimi i përmbajtjeve programore audiovizuale**

1. Shërbimet mediale audiovizuale të licencuara nga Komisioni i Pavarur për Media - KPM si edhe operatorët kabllorë dhe operatorët tjerë që pavarësisht teknologjisë së përdorur ofrojnë përmbajtje audiovizuale, obligohen të bëjnë transmetimin dhe ritransmetimin e programeve bazuar në marrëveshjet valide për të drejtën e autorit.

2. Marrëveshjet mbi të drejtën e autorit që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e programeve audiovizuale do të jenë të vlefshme vetëm pasi ato të jenë regjistruar nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave të cilat licencohen nga Zyra për të drejtën e autorit pranë Ministrisë së Kulturës, në pajtim me nenin 171 të këtij ligji.

3. Të gjitha ankesat që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës së autorit gjatë transmetimit dhe ritransmetimit të programeve nga ana e shërbimeve me përmbajtje audiovizuale do të procedohen tek Komisioni i Pavarur për Media (KPM).

4. Mos përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësisë nga ana e shërbimeve mediale audiovizuale për transmetimin dhe ritransmetimin e programeve, siç përcaktohen me këtë ligj, do të shqyrtohet nga KPM-ja në pajtim me dispozitat e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Neni 31 Programet e koduara

Nëse sinjalet që bartin programin janë të koduara, komunikimi për publikun me anë të satelitit, apo platformave tjera, bëhet me kusht që mjetet për dekodim të transmetimit sigurohen për publikun nga shërbimi medial audiovizual apo me pëlqimin e tij.

Neni 32 E drejta në emetim sekondar

E drejta e emetimit sekondar është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndalojë komunikimin për publikun të një veprë emetuese apo veprës që i është vënë në dispozicion publikut përmes altoparllantit, ekranit ose një mjeti të ngjashëm.

Neni 33 E drejta e vënies së veprës në dispozicion të publikut

E drejta e vënies së veprës në dispozicion të publikut është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndalojë që vepra e tij t'i vihet në dispozicion publikut përmes përcjelljes lineare dhe jolineare, në mënyrën e cila i mundëson individit që veprës t'i qaset nga vendi dhe në kohën që ai e zgjedhë.

Neni 34 Shfrytëzimi i veprës në formën e ndryshuar

1. Shfrytëzimi i veprës në formën e ndryshuar përfshin:

1.1. të drejtën e përpunimit

1.1.1. e drejta e përpunimit është e drejtë e autorit të lejojë apo të ndalojë përkthimin, përshtatjen skenike, përshtatjen muzikore apo përpunimin e veprës së tij në mënyrë tjetër, me qëllim të krijimit të një veprë të prejardhur;

1.1.2. e drejta e parashikuar në paragrafin 1. të këtij neni zbatohet edhe në rastet kur vepra e autorit, në formë të pandryshuar, përfshihet apo ndërthehet në një vepër të re.

1.1.3. autori i veprës burimore mban të drejtën ekskluzive për shfrytëzimin e veprës së tij në versionin e përpunuar, nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj ose

me kontratë.

1.2. të drejtën e përshtatjes audiovizuale

2. E drejta e përshtatjes audiovizuale është e drejtë ekskluzive e autorit ta lejojë apo ta ndalojë që vepra e tij të përshtatet apo të shfrytëzohet për t'u fiksuar në vepër audiovizuale.

KREU III TË DREJTAT E TJERA TË AUTORIT

Neni 35 E drejta e qasjes dhe e ekspozimit

1. Autori ka të drejtë t'i qaset origjinalit apo ekzemplarit të veprës së tij që është në zotërim të personit tjetër, kur kjo i nevojitet për ta riprodhuar apo përpunuar veprën, nëse nuk preken thelbësisht interesat e arsyeshme të zotëruesit.

2. Autori ka të drejtë të kërkojë nga zotëruesi i origjinalit të veprës së tij figurative ose fotografike që t'ia dorëzojë atë përkohësisht, me qëllim të ekspozimit.

3. Dhënien përkohësisht të origjinalit, në përputhje me paragrafin 2. të këtij neni, zotëruesi mund ta kushtëzojë me dhënien e garancionit monetar të mjaftueshëm, ose me lidhje të kontratës për sigurim në lartësi të vlerës në treg të origjinalit.

4. Autori është i detyruar të kujdeset që mënyra e qasjes së veprës ose ekspozimi i saj të rezultojë në sa më pak shqetësime për zotëruesin. Në rast se dëmtohet origjinali ose ekzemplari i veprës, autori mban përgjegjësi objektive edhe pa qenë i fajshëm për dëmtimin.

Neni 36 E drejta në rishitje-droit de suit

1. Në rast të rishitjes së origjinalit të veprës artistike pas tjetërsimit të parë të saj nga ana e autorit autori ka të drejtë të jetë i njoftuar për rishitje, si dhe të drejtë në kompensim në shumën e përcaktuar me këtë nen.

2. Detyrimin e kompensimit sipas paragrafit paraprak e përmbushin në mënyrë solidare: shitësi, blerësi dhe ndërmjetësuesi që merret me shitjen e veprave artistike.

3. Vepra artistike origjinale, sipas paragrafit 1. të këtij neni, konsiderohen: pikturat, kolazhet, vizatimet, tapiceritë, skulpturat, krijimet nga qeramika dhe qelqi, fotografitë si edhe vepra të tjera artistike. Kopjet e veprave të këtyra konsiderohen origjinale nëse janë të krijuara ose të autorizuara nga vetë autori si dhe të bëra në numër të kufizuar dhe sipas rregullit të numëruara dhe të firmosura nga autori.

4. Kompensimi për të drejtën e rishitjes paguhet në përqindje të çmimit shitës të origjinalit në treg, duke mos llogaritur tatimin, por me kusht që çmimi shitës të kalojë dymijë (2.000) Euro.

5. Përqindja nga paragrafi 4. i këtij neni përcaktohet sipas njësive pasuese të çmimit, me atë që shuma e përgjithshme e kompensimit nuk mund të jetë më e lartë se dymbëdhjetëmijë e pesëqind (12.500) Euro:

5.1. 4% nga pjesa e çmimit shitës mbi dymijë (2.000) deri në pesëdhjetëmijë (50.000) Euro;

5.2. 3% nga pjesa e çmimit shitës mbi pesëdhjetëmijë (50.000) deri në dyqind mijë (200.000) Euro;

5.3. 1% nga pjesa e çmimit shitës mbi dyqind mijë (200.000) deri në treqind e pesëdhjetëmijë (350.000) Euro;

5.4. 0.5% nga pjesa e çmimit shitës mbi treqind e pesëdhjetëmijë (350.000) deri në pesëqind mijë (500.000) Euro;

5.5. 0.25% nga pjesa e çmimit shitës mbi pesëqind mijë (500.000) Euro

6. E drejta e rishitjes nuk mund të jetë lëndë e braktisjes ose e kalimit, gjatë jetës së autorit, e as lëndë e përmbarimit të detyrueshëm.

Neni 37 **E drejta e huazimit publik**

1. E drejta e huazimit publik është e drejtë e autorit në kompensim të arsyeshëm, kur origjinali ose ekzemplari i veprës së tij vihet në dispozicion përmes institucionit publik, për t'u përdorur për kohë të caktuar dhe pa përfitim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë pasuror.

2. Paragrafi 1. i këtij neni nuk zbatohet për përdorim të:

2.1. origjinalit ose të ekzemplarëve të Veprës në bibliotekat e shkollave të të gjitha niveleve;

2.2. veprave të ndërtuara arkitekturore;

2.3. origjinalit ose ekzemplarëve të Veprës së arteve aplikative dhe dizajnit industrial;

2.4. origjinalit ose ekzemplarëve të Veprës në hapësirat e institucionit publik për qëllim të shikimit të atypëratyshëm;

2.5. qëllimit të huazimit ndërmjet institucioneve publike.

3. Huazimi publik i origjinalit ose i ekzemplarëve të programeve kompjuterike dhe bazave të të dhënave është e drejtë ekskluzive e autorit të tyre.

Neni 38 **E drejta për kompensim të veçantë**

1. Në rastet kur vepra e autorit, varësisht nga natyra e saj, mund të riprodhohet edhe për përdorim privat në kuptim të nenit 44 të këtij ligji në formë të realizimit të fiksimit audiovizuel, autori ka të drejtë në një pjesë të kompensimit të veçantë për një riprodhim të tillë të veprës së tij.

2. Kompensimi i veçantë nga paragrafi 1. i këtij neni për fiksimit audiovizuel paguhet me rastin e shitjes së parë ose importimit të bartësve të rinj të zbrazët të tingullit ose të pamjes.

3 Kompensimi i veçantë nga paragrafi 1. i këtij neni për fotokopjim duhet të paguhet:

3.1. me rastin e shitjes së parë ose Importimit të aparateve të reja për fotokopjim;

3.2. për secilën fotokopje, nëse është bërë me pagesë, duke marrë parasysh numrin e mundshëm të tyre gjatë një viti.

4. Me termat audio ose videofiksimit, si dhe fotokopjim, nga ky nen, nënkuptohen edhe teknikat e tjera të ngjashme të riprodhimit.

5. E drejta në kompensim të veçantë nuk mund të braktiset apo të tjetërsohet gjatë jetës së autorit, dhe nuk mund të jetë as objekt i përmbarimit të detyrueshëm.

Neni 39
Pagesa e kompensimit të veçantë

1. Kompensimin e veçantë në kuptim të nenit paraprak 38 të këtij ligji e paguajnë: prodhuesit e pajisjeve për fotokopjim, prodhuesit e bartësve të zbrazët të zërit ose të pamjes, si dhe zotëruesit e aparateve fotokopjuese që ofrojnë ose bëjnë shërbime fotokopjimi me pagesë. Krahas prodhuesve debitorë solidarë janë shitësit dhe importuesit e pajisjeve të tilla dhe të mbartësve të zbrazët të tingullit ose pamjes, përveç kur importimi i tyre bëhet për përdorim privat ose jokomercial, si pjesë e bagazhit personal, de minimis imports.

2. Prodhuesit nga paragrafi paraprak 1. i këtij neni nuk janë të detyruar të paguajnë kompensim të veçantë për ato aparate ose bartës të zbrazët të tingullit apo të pamjes të cilat prodhohen për eksport. E njëjta vlen edhe për importuesit e pajisjeve apo bartësve të zbrazët të tingullit apo të pamjes të cilat janë të importuara në Republikën e Kosovës, dhe eksportohen pa i ofruar së pari për shitje në territorin e Republikës së Kosovës.

3. Personat nga paragrafi 1. i këtij neni duhet, sipas kërkesës së Shoqatës për administrim kolektiv të këtyre të drejtave, të dorëzojnë të dhëna në lidhje me llojin dhe numrin e aparateve dhe të bartësve të zërit ose të pamjeve që i kanë shitur ose importuar, si dhe të dhënat për numrin e fotokopjeve të shitura, të cilat nevojiten për të llogaritur kompensimin e veçantë.

Neni 40
Shumat e kompensimit të veçantë

1. Shumat e përgjithshme të kompensimeve të veçanta sipas nenit 38 të këtij ligji, që u takojnë të gjithë bartësve të të drejtave, sipas këtij ligji, i miraton Qeveria e Kosovës. Me kontratë të posaçme në mes të Shoqatës për administrim kolektiv të këtyre të drejtave dhe shfrytëzuesve, mund të caktohen tarifatat e veçanta të këtyre kompensimeve.

2. Shumat e kompensimeve të veçanta nga paragrafi paraprak caktohen ndaras: për çdo lloj të bartësve të fiksimit të tingullit ose pamjeve në varësi me kapacitetin e mundshëm dhe qëndrueshmërinë e fiksimit përfshirë CD-ROM, DVD dhe bartësit e ngjashëm, për çdo aparat fotokopjimi përfshirë faks-aparatet, skanerët etj., në varësi me kapacitetin e tyre, numrin e kopjeve në minutë dhe mundësinë e fotokopjimit me ngjyra në shumën e dyfishuar nga kopjimi bardh e zi, si dhe për çdo faqe të kopjuar.

3. Shumat nga paragrafi 1. i këtij neni caktohen në vlera nominale të parasë. Me rastin e caktimit të lartësisë së tyre merret parasysh shtrirja e mundshme e pranisë së masave mbrojtëse efektive teknologjike në treg.

KREU IV
KUFIZIMET E TË DREJTËS SË AUTORIT

Neni 41
Kufizimet e të drejtës së autorit

1. Kufizimet e të drejtës së autorit nënkuptojnë se një vepër mund të shfrytëzohet:

1.1. pa leje të autorit dhe pa pagesë të Kompensimit përkatës, në vijim: shfrytëzim i lirshëm;

1.2. pa leje të autorit, por me pagesë të kompensimit përkatës.

2. Kufizimet e të drejtës së autorit vlejnë vetëm në rastet e parapara shprehimisht në këtë nen, ndërkaq vëllimi dhe mënyra e shfrytëzimit kufizohet me synimin të cilit i shërben, me kusht që të mos

jetë në kundërshtim me shfrytëzimin normal të veprës dhe të mos shkelen në mënyrë të paarsyeshme interesat e ligjshme të autorit.

3. Në rastet kur shfrytëzimi i veprave lejohet sipas dispozitave të këtij neni, duhet patjetër të shënohet emri i autorit dhe burimi, përveç kur kjo është objektivisht e pamundur ose kur shprehimisht e përjashton ky ligj.

Neni 42

Shfrytëzimi i lirshëm dhe zbatimi i procedurave zyrtare

Është i lirshëm shfrytëzimi i veprës për nevoja të sigurimit publik ose për rrjedhat e rregullta të veprimit apo raportimit në procedurat administrative, parlamentare ose gjyqësore, pa qenë e domosdoshme të shënohet emri i autorit dhe burimi prej nga është marrë vepra.

Neni 43

Mësimdhënia

1. Vetëm për qëllim të ilustrimit të mësimdhënies nëpër shkollat e të gjitha niveleve, ndërsa në suazë të synimit jokomercial, është i lirshëm:

1.1. interpretimi publik i veprave të publikuara nëse kjo është formë e drejtpërdrejtë e mësimdhënies në shkollë;

1.2. interpretimi publik i veprave të publikuara në kremtimet shkollore pa pagesë, me kusht që interpretuesit nuk kompensohen për këtë.

1.3. komunikimi i veprave nga fonogramet dhe videogramet për qëllime të mësimdhënies;

1.4. riprodhimi i pjesëve të shkurta të veprave të publikuara, për qëllime të mësimdhënies së drejtpërdrejtë ose për provime;

1.5. emetimi i mëtejme audiovizuel i emisioneve shkollore;

1.6. riprodhimi i emisioneve shkollore audiovizuele në fonograme ose videograme, vetëm për qëllime të mësimdhënies së drejtpërdrejtë në hapësirat e institucionit shkollor.

Neni 44

Riprodhimi privat dhe vetanak

1. Në kuptim të nenit 38 të këtij ligji, riprodhimi i veprave të publikuara është i lirshëm nëse bëhet deri në tre ekzemplarë dhe nëse janë përmbushur kushtet sipas paragrafit 2. dhe 3. të këtij neni.

2. Personi fizik mund të riprodhojë lirshëm një vepër:

2.1. në çfarëdo bartësi, nëse këtë e bën për përdorim privat dhe pa interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë komercial, si dhe nëse ekzemplarët e tillë nuk do t'i shpërndahen apo komunikohen publikut;

2.2. në letër apo në bartës tjetër të ngjashëm, me përdorim të fotokopjimit ose të një teknike të ngjashme fotografike;

3. Bibliotekat publike, arkivat publike, muzetë dhe institucionet arsimore apo shkencore, mund të riprodhojnë lirshëm veprën në çfarëdo bartësi lëndor, nëse riprodhimin e bëjnë nga ekzemplari që zotërojnë dhe pa interes komercial të drejtpërdrejtë apo të tërthortë;

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1., 2. dhe 3. të këtij neni, nuk lejohet riprodhimi i veprës së shkruar në vëllim të plotë të librit, partiturave muzikore, bazës elektronike të të dhënave, programeve

kompjuterike dhe në formë të veprave të ndërtuara arkitektonike, nëse nuk parashihet ndryshe në këtë ligj ose me kontratë.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 4. të këtij neni, por në përputhje me kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, lejohet:

5.1. riprodhimi i plotë i një libri, nëse ekzemplarët e shtypur janë të shitur të paktën dy (2) vjet më parë;

5.2. transkriptimi i partiturave muzikore me shkrim dore.

Neni 45 Incizimet kalimtare

1. Shërbyesi medial audiovizual i cili ka leje për të transmetuar një vepër mund të bëjë incizimin e kësaj vepre lirshëm, me mjete vetanake dhe për nevoja të veta.

2. Shërbyesi medial audiovizual mund të transmetojë incizimin e referuar sipas paragrafit 1. të këtij neni vetëm një herë, dhe duhet ta fshijë atë jo më vonë se brenda një (1) muaji pas transmetimit.

3. Incizimi, i referuar në paragrafin 1. të këtij neni, mund të dorëzohet në një arkiv zyrtar, me kusht që ai të ketë karakter të jashtëzakonshëm dokumentues. Shërbyesi medial audiovizual duhet të njoftojë menjëherë bartësin e të drejtës në lidhje me dorëzimin e tillë.

Neni 46 Personat me nevoja të veçanta

Është i lejueshëm riprodhimi, shpërndarja dhe komunikimi i veprës së publikuar në dobi të personave me nevoja të veçanta, por në masën që dikton nevoja e veçantë. Shfrytëzimi i këtillë është i lejueshëm me kusht që të jetë në lidhje të drejtpërdrejtë me personat me nevoja të veçanta, si dhe që të mos bëhet për interes të drejtpërdrejtë apo të tërthortë komercial.

Neni 47 Ceremonitë dhe festimet

Është i lirshëm shfrytëzimi i veprës gjatë ceremonive fetare dhe në festimet zyrtare që organizohen nga autoriteti publik.

Neni 48 Rastet e veçanta të shfrytëzimit të lirshëm

1. Janë të lirshme aktet e riprodhimit të përkohshëm të një vepre të cilat janë kalimtare ose përcjellëse, që janë pjesë përbërëse dhe thelbësore e ndonjë procesi teknologjik, që nuk kanë rëndësi të pavarur ekonomike dhe kanë të vetmin qëllim të mundësojnë që vepra:

1.1. të transmetohet në rrjet midis palëve të treta nëpërmjet ndërmjetësuesit; ose

1.2. të shfrytëzohet ligjshëm.

2. Është i lirshëm shfrytëzimi i veprës së publikuar në material tjetër, nëse aty përfshihet rastësisht dhe nuk paraqet element thelbësor të atij shfrytëzimi.

Neni 49 E drejta e informimit publik

1. Për të pasur qasje të lirë në informim të karakterit publik është i lirshëm:

1.1. riprodhimi, shpërndarja dhe komunikimi për publikun i veprës audiovizuale që paraqet pjesë përbërëse të ngjarjes për të cilën raportohet, por pa kaluar masën e raportimit për ngjarjen e ditës;

1.2. riprodhimi dhe komunikimi për publikun, në mënyrë të shkurtër, në formë recensionit apo ndonjë referim tjetër i përmbajtjes së veprave të publikuara të autorit.

2. Shfrytëzimi i pjesëve të shkurtra të shkëputura nga komente të ndryshme dhe artikuj të tjerë të publikuar në media publike, në formë të pasqyrit të temave të ditës;

3. Shfrytëzimi i fjalimeve politike dhe i fjalimeve të tjera të mbajtura në debate publike, në masën e qëllimit informativ.

Neni 50 Citimet

Është i lejueshëm shfrytëzimi në veprën vetanake i pjesëve të shkëputura nga një vepër e huaj e publikuar, ose vepra e plotë e huaj e publikuar në lëmin e fotografisë, të arteve figurative, dizajnit industrial, arkitekturës, arteve aplikative dhe kartografisë, nëse kjo ka të bëjë me kritikën apo shtjellimet në veprën e vetë autorit, me kusht që kjo të jetë në përputhje me parimet e vetëdijes dhe ndershmërisë.

Neni 51 Përpunimet e lirshme

1. Përpunimi i veprës është i lejueshëm:

1.1. nëse ka të bëjë me përpunim privat apo tjetër vetanak, i cili nuk është në dispozicion të publikut;

1.2. për përpunim në parodi apo karikaturë, nëse kjo nuk krijon apo nuk mund të krijojë huti në lidhje me burimin;

1.3. nëse përpunimi përkon me shfrytëzim të lejueshëm dhe me qëllimin e ligjshëm.

Neni 52 Katalogët

Është i lirshëm riprodhimi dhe shpërndarja në katalogë i veprave të ekspozuara të arteve figurative, arteve aplikative dhe dizajnit industrial, si dhe i veprave fotografike që botohen nga organizatori për të promovuar ekspozitën ose ankandin, duke përjashtuar çfarëdo interesi komercial të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Neni 53 Veprat e vendosura në vende publike

1. Veprat e vendosura në hapësira publike dhe në vende të tjera ku është e lejuar qasja e përgjithshme publike shfrytëzohen lirshëm.

2. Shfrytëzimi i veprave nga paragrafi 1. të këtij neni nuk është i lejueshëm të bëhet në formë tredimensionale ose për qëllim të njëjtë si vepra burimore, e as për interes komercial të drejtpërdrejtë apo të tërthortë.

Neni 54 Demonstrimi i pajisjeve

Në punëtori, shitore, panaire dhe ofiçina të riparimit është i lejueshëm riprodhimi i veprës në fonogram

apo video, si dhe komunikimi i veprave për publikun, por vetëm në masën e domosdoshme për demonstrimin e punës së pajisjeve që prodhohen, shiten ose riparohen në hapësira të tilla.

Neni 55

Bazat e të dhënave

1. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose i ekzemplarit të saj mundet lirshëm ta riprodhojë ose të bëjë ndryshime në atë bazë të të dhënave, me kusht që kjo të jetë e nevojshme për t'iu qasur përmbajtjes së saj dhe shfrytëzimit normal të kësaj përmbajtjeje. Kur shfrytëzuesi është i autorizuar që të shfrytëzojë vetëm një pjesë të bazës së të dhënave, kjo dispozitë zbatohet vetëm në lidhje me atë pjesë.

2. Çdo dispozitë kontraktuale në kundërshtim me paragrafin 1. i këtij neni është i pavlefshëm.

Neni 56

Librat e leximit dhe tekstet shkollore

Me pagesë të kompensimit përkatës është i lejueshëm riprodhimi dhe marrja e pjesëve të shkëputura të veprës së publikuar të autorit, respektivisht i veprave të publikuara veç e veç nga lëmi i arteve figurative, fotografisë, arkitekturës, arteve aplikative dhe dizajnit industrial, si dhe i kartografisë, në libra leximi dhe tekste shkollore që përmbajnë vepra të më shumë autorëve dhe që i dedikohen mësimdhënies në shkolla të të gjitha niveleve.

Neni 57

Komentet e Shërbyesve medial audiovizual dhe artikujt e shtypit

Pas pagesës përkatëse, duhet të jetë e lejueshme riprodhimi nga ana e shtypit, komunikimi publikut apo vënia në dispozicion të publikut e artikujve të publikuar mbi temat aktuale ekonomike, politike apo fetare, apo të veprave të transmetuara, ose temave të tjera të karakterit të njëjtë, përveç nëse përdorimi i tillë është shprehimisht i rezervuar nga bartësi i të drejtës.

Neni 58

Emetimi i veprës nga fonogramet e botuara

I lejohet transmetuesit emetimi i veprave nga fonogramet e botuara, me kusht që, para emetimit, me Shoqatën kolektive të ketë lidhur kontratë për lartësinë, mënyrën dhe afatin e pagesës së kompensimit.

Neni 59

Institucionet sociale

Me pagesë të kompensimit përkatës, është i lejueshëm riprodhimi dhe emetimi i mëtejshëm i emisioneve të Shërbyesve medial audiovizual në shtëpitë e pleqve, në spitale, burgje dhe institucione të ngjashme sociale.

Neni 60

Sigurimi i kufizimeve të të drejtave

1. Nëse bartësi i të drejtave zbaton masa teknologjike në kuptim të dispozitave të këtij ligji ai është i detyruar që përfituesit e kufizimeve të të drejtave nga nenet 42 deri 46 dhe nenit 59 të këtij ligji, me kërkesën e tij, por jo më vonë se katërmëdhjetë (14) ditë nga dita e paraqitjes së saj, t'i vërë në dispozicion mjetet për shfrytëzim të këtyre kufizimeve, por me kusht që ato të përdoren vetëm në masën e domosdoshme dhe që përfituesi të ketë qasje të ligjshme në veprën e mbrojtur apo në objekt të të drejtave të përfaqëta.

2. Nëse bartësi i të drejtave nuk e përmbush detyrimin sipas paragrafit 1. të këtij neni shfrytëzuesi ose shoqatat e shfrytëzuesve mund t'i drejtohen gjykatës kompetente.

3. Paragrafët e mësipërm të këtij neni nuk zbatohen:

3.1. nëse bartësi i të drejtës, vullnetarisht ose sipas kontratës, i ka vënë shfrytëzuesit në dispozicion mjetet për të shfrytëzuar kufizimet e të drejtave të këtilla, në masë të kënaqshme dhe të domosdoshme;

3.2. ndaj masave teknologjike të zbatuara gjatë përmbushjes së detyrimeve të titullarëve të drejtave nga paragrafët e mësipërm të këtij neni;

3.3. ndaj veprave të vëna në dispozicion të publikut sipas kushteve të kontraktuara, në mënyrën që pjesëtarëve të publikut u është bërë e mundur qasja nga vendi dhe në kohën që ata e zgjedhin individualisht.

KREU V KUFIZIMET E KOHËZGJATJES TË SË DREJTËS SË AUTORIT

Neni 61 Afati i kohëzgjatjes

1. E drejta e autorit zgjat gjatë gjithë jetës së autorit dhe shtatëdhjetë (70) vjet pas vdekjes së tij.
2. E drejta e autorit në veprat anonime dhe me pseudonim do të vazhdojë për shtatëdhjetë (70) vjet pas zbulimit të ligjshëm të veprës. Kur pseudonimi nuk lë dyshim në lidhje me identitetin e autorit, ose nëse autori zbulon identitetin e tij gjatë periudhës shtatëdhjetë (70) vjeçare pas zbulimit të ligjshëm të veprës, e drejta e autorit do të vazhdojë në përputhje me dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni.
3. E drejta e autorit në veprën e bashkautorëve do të zgjasë për shtatëdhjetë (70) vjet nga data e vdekjes së bashkautorit të fundit që ka jetuar.
4. E drejta e autorit në veprat kolektive zgjat për shtatëdhjetë (70) vjet pas zbulimit të ligjshëm të veprës, përveç nëse personat fizikë që kanë krijuar veprën janë identifikuar si të tillë në versione të veprës të cilat i janë zbuluar publikut.
5. Në rast të identifikimit të autorëve që përfshihen në vepra të tilla, aplikohen dispozitat e paragrafit 1. dhe 3. të këtij neni.
6. Kur afati nuk rrjedh që nga vdekja e autorit, ndërsa vepra nuk ka qenë ligjshëm e publikuar, e drejta e autorit zgjat shtatëdhjetë (70) vjet nga vdekja e tij.
7. Kur afati i mbrojtjes llogaritet nga dita e zbulimit ose publikimit të ligjshëm të veprës, dhe kur vepra publikohet në vëllime, pjesë, kapituj, numra apo episode, afati i mbrojtjes vazhdon për secilën artikull, si të ndarë.
8. Ndryshimet jo qenësore gjatë përzgjedhjes, korrigjimit apo renditjes së përmbajtjes së koleksionit të veprave nuk e zgjasin afatin e mbrojtjes të së drejtës në koleksion.
9. Afatet nga ky nen llogariten që nga 1 janari i vitit që pason vitin në të cilin ndodh ngjarja e cila është relevante për fillimin e afatit.

Neni 62 Efekti i mbarimit të afateve

Me mbarimin e afateve të kohëzgjatjes së mbrojtjes, siç përcaktohet në këtë kapitull, vepra e mbrojtur me të drejtën e autorit kalon në domenin publik dhe është e lirë për t'u shfrytëzuar.

Neni 63

E drejta e publikimit dhe e drejta e tërheqjes

E drejta e publikimit dhe e drejta e tërheqjes, që i referohet nenit 17 dhe nenit 20 të këtij ligji, zgjasin derisa autori të jetë gjallë.

Neni 64

E drejta e autorësisë dhe e integritetit të veprës

Pavarësisht nga dispozitat e neneve 61 dhe 62 të këtij ligji, detyrimi për respektimin e të drejtës së autorit, neni 18, dhe të drejtës së integritetit të veprës, neni 19, zgjat pa kufizim kohor.

KREU VI

KALIMI I TË DREJTAVE TË AUTORIT

Neni 65

Autori nuk mund t'ia kalojë të drejtat morale të tij personit tjetër.

Neni 66

Trashëgimi i të drejtës së autorit

Të drejtat ekonomike dhe të drejtat tjera, si dhe zbatimi i të drejtave morale që zgjasin pas vdekjes së autorit, kalohen në përputhje me dispozitat për trashëgimi.

Neni 67

Kalimi i të drejtave pasurore të autorit

Të drejtat pasurore dhe të drejtat e tjera të autorit janë pjesë përbërëse e pasurisë së bartësit të tyre dhe mund të jenë objekt i kalimit juridik.

Neni 68

Bartësi i të drejtave pasurore

1. Autori është bartësi i parë i të gjitha të drejtave pasurore dhe të drejtave tjera mbi veprën e vet.
2. Përveç autorit, bartësi i të drejtave nga paragrafi 1. i këtij neni mund të jetë edhe personi fizik apo juridik të cilit i kalohen këto të drejta mbi bazë ligjore ose me veprim juridik.

Neni 69

Zotërimi juridik

Të drejtat të cilat autorit i njihen me ligj, përfshirë këtu edhe mbrojtjen e tyre gjyqësore, i takojnë bartësit tjetër të të drejtave, në masën dhe sipas llojit që i barten me ligj apo me veprim juridik, përveç nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

Neni 70

Përmbarimi

1. E drejta e autorit, vepra e pakryer, origjinalet e pa publikuara dhe dorëshkrimi i veprës nuk mund të jenë objekt i përmbarimit.
2. Lëndë e përmbarimit mund të jenë vetëm përfitimet pasurore nga e drejta e autorit.

Neni 71

Marrëdhënia e të drejtës së autorit me të drejtën e pronësisë

1. E drejta e autorit është e pavarur nga e drejta e pronësisë mbi sendin ku është e përfshirë vepra e autorit, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.
2. Kalimi veç e veç i të drejtave pasurore të autorit dhe të drejtave tjera mbi veprën e autorit nuk ndikon në të drejtën e pronësisë mbi sendin ku është përfshirë vepra e autorit, nëse në këtë ligj apo me kontratë nuk parashikohet ndryshe.
3. Kalimi juridik i sendit ku është e përfshirë vepra e autorit nuk ndikon në të drejtat e veçanta pasurore dhe të drejtat e tjera të autorit mbi atë vepër, nëse me këtë ligj apo me kontratë nuk parashikohet ndryshe.

Neni 72

Në pasurinë e përbashkët të bashkëshortëve bien vetëm përfitimet pasurore që dalin nga shfrytëzimi i të drejtës së autorit.

Neni 73

Pronari i veprës së ndërtuar arkitekturore mund ta përpunojë lirshëm atë vepër.

Neni 74

1. Pronari që synon ta asgjësojë origjinalin e veprës së autorit dhe kur ka bazë të supozojë se autori ka interes të arsyeshëm në ruajtjen e origjinalit nuk mund ta asgjësojë origjinalin e këtillë para se t'ia ketë ofruar atë autorit. Pronari nuk mund të kërkojë më tepër se që është vlera reale e materialit.
2. Nëse është e pamundur të kthehet origjinali, pronari mund ta asgjësojë atë, por duhet t'ia mundësojë autorit bërjen e kopjes së veprës në shpenzime të autorit.
3. Pronari i veprës së ndërtuar arkitekturore mund ta asgjësojë atë vepër, por autori ka të drejtën ta fotografojë dhe të kërkojë t'i dorëzohen kopjet e planeve në shpenzime të veta.
4. Dispozitat e këtij neni nuk ndikojnë në mbrojtjen e veprës sipas dispozitave të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore.

Neni 75

Kontrata për të drejtat e autorit

1. Autori mund t'ia kalojë personit tjetër të drejtat pasurore për shfrytëzim të veprës së tij, përmes lidhjes së kontratës apo veprimit tjetër juridik, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.
2. Kontrata e të drejtës së autorit përmban në veçanti: emrat e palëve kontraktuese, titullin, përkatësisht identifikimin e veprës që është si objekt i kontratës, të drejtat, përkatësisht format e shfrytëzimit që janë objekt i kalimit, format e kompensimit të autorit, kufizimet eventuale të përmbajtjes, kufizimet e mundshme në shtrirje territoriale, kohëzgjatjen.
3. Ndaj kontratës së të drejtës së autorit zbatohen dispozitat e të drejtës së detyrimeve, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me këtë ligj.

Neni 76

Vëllimi i kalimit të të drejtave

1. Kalimi i disa të drejtave pasurore apo të drejtave tjera vetanake të autorit mund të bëhet me kufizime në përmbajtje, territor dhe kohëzgjatje.

2. Kalimi i të drejtave pasurore mund të jetë ekskluziv ose joekskluziv:

2.1. kalimi ekskluziv e autorizon vetëm marrësin e të drejtës që, në mënyrën e përcaktuar me kontratë, të shfrytëzojë veprën e autorit, duke përjashtuar të gjithë personat tjerë, përfshirë edhe autorin;

2.2. kalimi joekskluziv e autorizon marrësin e të drejtës që, në mënyrën e përcaktuar me kontratë, të shfrytëzojë veprën e autorit, krahas autorit dhe cilit do person tjetër që është titullar i të drejtës së autorit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve të këtij neni, kalimi ekskluziv i të drejtave të shfrytëzimit të veprës së caktuar nuk e ndalon autorin ta shfrytëzojë atë vepër në koleksion të veprave të zgjedhura të tij, apo në koleksion të të gjitha veprave të tij.

4. Kalimi joekskluziv, të cilin autori e ka lejuar para se të ketë bërë kontratë për kalim joekskluziv, mbetet i vlefshëm ndaj marrësit të së drejtës ekskluzive, nëse me kontratë midis autorit dhe marrësit të së drejtës ekskluzive nuk është parashikuar ndryshe.

Neni 77

Supozimi i masës së kalimit të të drejtave

1. Nëse me ligj apo me kontratë nuk është specifikuar se kalimi i të drejtave është ekskluziv ose joekskluziv konsiderohet se kalimi është joekskluziv.

2. Nëse me ligj apo me kontratë nuk është specifikuar shtrirja territoriale, konsiderohet se kalimi vlen vetëm për territorin e Republikës së Kosovës.

3. Nëse me ligj apo me kontratë nuk është specifikuar se cilat të drejta veç e veç kalohen, ose në çfarë mase kalohet një e drejtë, konsiderohet se janë kaluar ato të drejta dhe vetëm deri në atë masë që është thelbësore për t'i arritur synimet e kontratës.

Neni 78

Kalimi i mëtejme i të drejtave

1. Personi që me anë të kalimit ka fituar të drejtën pasurore ose një të drejtë tjetër të autorit nuk mundet pa leje të autorit të bëjë kalim të mëtejme të të drejtave të tilla në një person të tretë, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

2. Leja sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk është e nevojshme, në rast se kalimi i mëtejme është pasojë e shitjes, bankrotit ose likuidimit të rregullt të personit juridik i cili është bartës i të drejtës.

3. Kalimi i të drejtës së caktuar për të shfrytëzuar veprën nuk nënkupton edhe kalimin e të drejtës në kompensim të autorit, në rastet kur shfrytëzimi i veprës së autorit mund të bëhet pa leje të autorit, por me detyrim të pagesës së kompensimit të autorit.

4. Nëse kalimi i mëtejme, pa pajtim të autorit, është i lejueshëm me ligj apo me kontratë marrësi i parë i të drejtës dhe bartësi i ri i të drejtës mbajnë përgjegjësi solidare ndaj autorit për përmbushjen e detyrimeve nga kontrata për kalim.

Neni 79

Rregulla e kalimeve të veçuara

1. Kalimi i një të drejte pasurore ose i një të drejte tjetër të autorit nuk ndikon në kalimin e të drejtave të tjera, nëse me ligj apo me kontratë nuk parashihet ndryshe.

2. Me rastin e kalimit të të drejtës për riprodhim të veprës nuk kalohet edhe e drejta e regjistrimit të saj në formën elektronike si dhe e drejta për fiksim të zërit apo të pamjeve, nëse me këtë ligj apo me kontratë nuk parashihet ndryshe.

3. Me rastin e kalimit të të drejtës për qiradhënie të fonogramit, përkatësisht videogramit të veprës së autorit, autori mban të drejtën në kompensim për çdo qiradhënie të veprës. Autori nuk mund të heqë dorë nga kjo e drejtë.

Neni 80 **Supozimi i kalimit të bashkëlidhur**

Me rastin e kalimit të të drejtës për riprodhimin të veprës, konsiderohet se është kaluar edhe e drejta për shpërndarjen e ekzemplarëve të saj, përveç nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 81 **Kalimi i të drejtës për botime periodike**

1. Nëse autori i kalon të drejtat e veta në formë të përfshirjes së veprës së tij në koleksionin që botohet periodikisht, konsiderohet se botuesi ka fituar të drejtën ekskluzive të riprodhimit dhe shpërndarjes së veprës.

2. Në rastin nga paragrafi 1. i këtij neni kalimi bëhet ekskluziv pas një viti nga dita e botimit të koleksionit periodik.

Neni 82 **Pavlefshmëria**

1. Konsiderohen të pavlefshme përcaktimet kontraktuese me të cilat autori bën kalimin e të drejtave të mëposhtme:

1.1. të drejtën e autorit si tërësi;

1.2. të drejtat morale;

1.3. të drejtat pasurore mbi të gjitha veprat e ardhshme të tij;

1.4. të drejtat pasurore për forma ende të panjohura të shfrytëzimit të veprës së tij.

Neni 83 **Formaliteti**

1. Të gjitha kontratat dhe veprimet tjera juridike me anë të të cilave bëhet kalimi i të drejtave pasurore dhe të drejtave tjera të autorit, ose jepen autorizime për shfrytëzim të veprës, bëhen në formë të shkruar, nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

2. Në rast të mospajtimit me paragrafin 1. të këtij neni, të gjitha definimet e diskutueshme apo të paqarta të marrëveshjes gojore interpretohen në favor të autorit.

Neni 84 **Kompensimi i autorit**

1. Kompensimi i autorit mund të caktohet: në shumë të njëhershme, në varësi me masën e shfrytëzimit të veprës, në varësi me efektet ekonomike të shfrytëzimit të veprës, në varësi me madhësinë apo cilësinë e veprës ose me kombinimin e këtyre metodave, si dhe duke marrë parasysh edhe kushtet

tjera që mund të ndikojnë në lartësinë e tij.

2. Nëse kompensimi i autorit nuk është caktuar me kontratë duhet të caktohet sipas pagesave të zakonshme për llojin e veprës, sipas masës dhe kohëzgjatjes së shfrytëzimit të veprës si dhe rrethanave tjera.

Neni 85

E drejta në revizionin e kompensimit të shpërpjesëtuar

1. Në rast se fitimprurja nga shfrytëzimi i veprës është në shpërpjesëtim të dukshëm me kompensimin e kontraktuar në shumë të njëhershme autori ka të drejtë të kërkojë ndryshimin e kontratës, në kuptim të caktimit më të drejtë të hises në fitim.

2. E drejta nga paragrafi 1. i këtij neni parashkruhet në afat prej dy (2) vjetësh nga dita e marrjes së njohurisë për ekzistimin e kompensimit të shpërpjesëtuar, por më së largu në afat prej dhjetë (10) vjetësh pas kalimit të të drejtës së shfrytëzimit të veprës së autorit.

3. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij sipas paragrafit 1. të këtij neni.

Neni 86

Detyrimi për mbajtjen e evidencës

1. Në rast kur kompensimi është përcaktuar në varësi me fitimin e realizuar nga shfrytëzimi i veprës shfrytëzuesi i të drejtës së autorit duhet patjetër të mbajë librin përkatës dhe evidencat tjera të kontabilitetit, prej ku është e mundur të konstatohen të ardhurat e realizuara.

2. Shfrytëzuesi i veprës është i detyruar që autorit apo përfaqësuesit të tij t'ia mundësojë kontrollin e evidencave nga paragrafi 1. i këtij neni, ndërsa në afatet e caktuara dhe të paktën një herë në vit t'i dërgojë edhe raporte të sakta lidhur me realizimin e të ardhurave.

Neni 87

Revokimi i të drejtës pasurore

1. Autori mund ta revokojë të drejtën pasurore të dhënë për shfrytëzim, nëse bartësi i të drejtës e ka shfrytëzuar atë të drejtë në masë të pamjaftueshme ose nuk e ka shfrytëzuar fare, me çka janë dëmtuar dukshëm interesat e arsyeshme të autorit, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

2. Autori nuk mund të vë në veprim të drejtën e revokimit para se të kenë kaluar dy (2) vite nga dita kur ka bërë kalimin e të drejtës së shfrytëzimit ose ka dorëzuar ekzemplarën e veprës, nëse ky dorëzim është bërë pas lidhjes së kontratës. Nëse ka të bëjë me artikull për shtypin ditor ky afat është tre (3) muaj, ndërsa për shtypin periodik është një (1) vit.

3. Autori mund të vë në veprim të drejtën e revokimit, vetëm pasi ta ketë paralajmëruar marrësin e të drejtës për revokim pasues dhe t'i ketë lënë një afat shtesë dhe të arsyeshëm për të shfrytëzuar të drejtën e dhënë.

4. Me rastin e bërjes së revokimit e drejta e dhënë për shfrytëzim të veprës shuhet.

5. Autori duhet që marrësit të të drejtës t'ia kompensojë në mënyrë të drejtë dëmin e shkaktuar me revokimin e të drejtës.

6. Autori nuk mund të heqë dorë nga e drejta e revokimit sipas këtij neni.

KREU VII
KONTRATAT E VEÇANTA PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Neni 88
Objekti i kontratës së botimit

1. Me kontratë botimi autori ia kalon të drejtën botuesit për të riprodhuar veprën e tij me anë të shtypshkrimit dhe të drejtën për shpërndarje të ekzemplarëve të veprës, ndërkaq botuesi merr për detyrim të bëjë riprodhimin dhe shpërndarjen e veprës si dhe për këtë t'i paguajë autorit kompensimin.
2. Në rastin kur vepra nuk është e publikuar me kontratë për botim të veprës konsiderohet se është dhënë pëlqimi edhe për publikimin e saj.
3. Me kontratë për botim botuesi mund të autorizohet edhe për përkthim të veprës në një gjuhë tjetër, si dhe për riprodhim dhe shpërndarje të saj.
4. Kontrata për botimin, objekt i së cilës është botimi i artikujve, vizatimeve, karikaturave dhe kontributeve tjera të autorit në shtypin ditor dhe atë periodik, nuk është e domosdoshme të bëhet në formë të shkruar.
5. Përfaqësuesi i autorit mund të lidhë kontratë për botim vetëm për ato vepra që janë caktuar shprehimisht në autorizimin e autorit.

Neni 89
Përmbajtja e kontratës

1. Kontrata për botim të veprës përmban, në veçanti:
 - 1.1. afatin brenda të cilit autori detyrohet t'ia dorëzojë botuesit dorëshkrimin ose një ekzemplar tjetër të veprës, në mënyrë që botuesit t'ia mundësojë botimin e veprës. Nëse me kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, ky afat është një (1) vit nga dita e lidhjes së kontratës;
 - 1.2. afatin brenda të cilit botuesi detyrohet të nisë nxjerrjen në treg të ekzemplarëve të veprës. Nëse me kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, ky afat është një (1) vit që nga dita e pranimit të dorëshkrimit a të një ekzemplari tjetër të rregullt të veprës;
 - 1.3. numrin e botimeve të cilat botuesi është i autorizuar t'i nxjerrë. Nëse me kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, botuesi ka të drejtë në një botim;
 - 1.4. afatin brenda të cilit botuesi, pas shterjes së botimit të parë, është i detyruar të nisë nxjerrjen në treg të ekzemplarëve të botimit të ardhshëm, nëse kjo është paraparë në kontratë. Nëse në kontratë nuk është përcaktuar ndryshe, ky afat është një (1) vit që nga dita kur autori ka kërkuar një gjë të tillë;
 - 1.5. dukjen dhe faqosjen teknike të ekzemplarëve të veprës.
2. Nëse kompensimi është i caktuar në përqindje nga çmimi me pakicë i ekzemplarëve të shitur, në kontratën për botim të veprës duhet të caktohet tirazhi i botimit të parë. Nëse kjo nuk është caktuar, supozohet se vepra është botuar në të paktën pesëmijë (5.000) ekzemplarë.
3. Nëse kompensimi është caktuar në shumë të njëhershme, në kontratë duhet patjetër të caktohet tirazhi i përgjithshëm i ekzemplarëve që do të shtypen. Nëse kjo nuk është caktuar apo nuk rezulton nga qëllimi i kontratës doket profesionale apo rrethanat tjera botuesi mund t'i riprodhojë dhe t'i shpërndajë deri në pesëqind (500) ekzemplarë.

Neni 90 Detyrimet e botuesit

1. Botuesi ka për detyrë:

1.1. të kujdeset për shitjen e ekzemplarëve dhe për këtë ta informojë herë pas here autorin, me kërkesën e tij;

1.2. që autorit, me kërkesën e tij, në fazën përkatëse të procesit teknik të shumëzimit t'ia mundësojë korrekturën;

1.3. që, me rastin e përgatitjes së çdo botimi të ardhshëm të veprës, t'i mundësojë autorit futjen e ndryshimeve përkatëse, me kusht që kjo të mos e ndryshojë karakterin e veprës dhe që, duke pasur parasysh tërësinë e kontratës për botim të veprës, të mos paraqet shpërpjesëtim në pikëpamje të detyrimeve të botuesit.

Neni 91 Detyrimi për kthimin e dorëshkrimit

Dorëshkrimi ose ekzemplari tjetër origjinal që i është dorëzuar botuesit duhet patjetër t'i kthehet autorit, përveç artikujve, vizatimeve dhe kontributeve tjera në shtypin ditor dhe në atë periodik, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 92 E drejta e përparësisë së botuesit

1. Botuesi i cili ka marrë të drejtën për botimin e veprës në formë të librit, ka të drejtën e përparësisë që, krahas ofertuesve tjerë të barabartë, ta botojë atë vepër në formë elektronike.

2. E drejta e përparësisë nga paragrafi 1. i këtij neni zgjat tre vjet që nga dita e kontraktimit të datës së botimit të veprës. Botuesi duhet të deklarohet në formë të shkruar brenda tridhjetë (30) ditësh që nga dita e marrjes së ofertës me shkrim nga autori.

Neni 93 Shkatërrimi i ekzemplarëve të pa shitur

Nëse botuesi synon që ekzemplarët e pa shitur të veprës t'i shesë si letër të vjetër, është i detyruar që blerjen paraprakisht t'ia ofrojë autorit, nëse rëndom është i arritshëm, sipas çmimit për letër të thjeshtë.

Neni 94 Shkatërrimi i veprës nga fuqia madhore

1. Nëse i vetmi ekzemplar ekzistues i veprës shkatërrohet nga shkaku i fuqisë madhore pasi t'i jetë dorëzuar botuesit, autori ka të drejtë në kompensim, siç do t'i takonte po të ishte botuar vepra.

2. Nëse nga shkaku i fuqisë madhore është shkatërruar i tërë tirazhi i përgatitur i veprës, para se të jetë nxjerrë në treg, botuesi ka të drejtë të përgatisë botimin e ri, ndërsa autorit i takon kompensimi vetëm për botimin e shkatërruar.

3. Nëse nga shkaku i fuqisë madhore është shkatërruar një pjesë e tirazhit të veprës, para se të jetë nxjerrë në treg, botuesi ka të drejtë pa pagesë shtesë të kompensimit të shumëzohet po aq ekzemplarë sa janë shkatërruar.

Neni 95 Përfundimi i kontratës

1. Kontrata e botimit përfundon:

- 1.1. nëse autori vdes para përfundimit të veprës;
- 1.2. nëse ekzemplarët e të gjitha tirazheve të kontraktuara janë shitur;
- 1.3. me skadimin e afatit të kohëzgjatjes së kontratës;
- 1.4. me zgjidhjen e kontratës në përputhje me Ligjin mbi detyrimet.

Neni 96 Zgjidhja e kontratës

1. Nëse botuesi nuk e boton veprën brenda afatit të kontraktuar ose brenda afatit nga paragrafi 1. i nenit 89 të këtij ligji, autori ka të drejtë ta zgjidhë kontratën e botimit, të mbajë, përkatësisht të kërkojë pagesën e kompensimit të caktuar, si dhe të kërkojë dëmshpërblimin.

2. Autori mund ta zgjidhë kontratën e botimit në rast se botuesi, pasi të jetë shitur tirazhi i botimit paraprak ndërkaq kontrata përmban detyrimin për ribotime, nuk fillon të nxjerrë në treg ekzemplarët e botimit të ardhshëm brenda afatit nga paragrafi 1. të nenit 89 të këtij ligji.

3. Botuesi mund të zgjidhë kontratën e botimit nëse autori nuk ia dorëzon dorëshkrimin ose një ekzemplar tjetër të veprës brenda afatit nga paragrafi 1. të nenit 89 të këtij ligji.

4. Konsiderohet se tirazhi i botimit është shitur nëse numri i ekzemplarëve të pa shitur është më i vogël se njëqind (100).

Neni 97 Kontrata e shfaqjes dhe kontrata e interpretimit

Me kontratën për shfaqjen, përkatësisht kontratën për interpretimin e veprës, autori ia kalon shfrytëzuesit të drejtën për të shfaqur, përkatësisht për të interpretuar publikisht veprën e tij, ndërsa shfrytëzuesi merr detyrimin që atë vepër ta shfaqë, përkatësisht ta interpretojë publikisht në afatin e caktuar, në mënyrën dhe nën kushtet e përcaktuara me kontratë, dhe për këtë t'i paguajë autorit kompensimin.

Neni 98

Të drejtën e shfaqjes, përkatësisht të drejtën e interpretimit publik të veprës, autori mund ta kalojë njëkohësisht në disa persona, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 99

Bartësi i të drejtës në shfaqjen apo interpretimin publik të veprës teatrore, teatrore-muzikore dhe koreografike lidhë edhe kontratë për regjinë teatrore, koreografinë, skenografinë dhe kostumografinë.

Neni 100

Nëse autori nuk ia dorëzon shfrytëzuesit veprën, brenda afatit të kontraktuar, shfrytëzuesi mund të zgjidhë kontratën dhe të kërkojë dëmshpërblim.

Neni 101

Dorëshkrimi, partitura ose origjinali tjetër i veprës që është objekt i kontratës i kthehen autorit, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 102

Shfrytëzuesi detyrohet t'ia mundësojë autorit përcjelljen dhe ecurinë e përgatitjeve për shfaqjen, përkatësisht interpretimin e veprës, të kujdeset për kushtet përkatëse teknike për shfaqjen, përkatësisht interpretimin e veprës, si dhe t'i dërgojë autorit ose përfaqësuesit të tij programin dhe herë pas here ta informojë për të ardhurat nga shfaqja, përkatësisht interpretimi i veprës.

Neni 103

Nëse shfrytëzuesi nuk e shfaq, përkatësisht nuk e interpreton veprën në afatin e kontraktuar, autori mund ta zgjidhë kontratën dhe të kërkojë dëmshpërblim, e pos kësaj mund të mbajë kompensimin e paguar, respektivisht të kërkojë pagesën e kompensimit të kontraktuar.

Neni 104

Kontrata e përpunimit të veprës

Me kontratën për përpunimin e veprës së autorit, autori e kalon të drejtën për t'u përpunuar vepra e tij në formën e përshtatjes skenike, përshtatjes audiovizuale ose për mënyra të tjera të shfrytëzimit të veprës në formë të ndryshuar.

Neni 105

Kontrata e porosisë së veprës së autorit

1. Me kontratën për porosi të veprës së autorit, autori merr detyrimin që për porositesin të krijojë veprën e autorit dhe t'ia dorëzojë origjinalin ose ekzemplarin e veprës, ndërsa porositesi merr detyrimin që autorit t'ia paguajë kompensimin.
2. Porositesi mund të mbikëqyrë procesin e krijimit të veprës dhe të japë udhëzime, por duke mos ndërhyrë në lirinë e shprehjes artistike apo shkencore të autorit.
3. Porositesi gëzon të drejtën e publikimit dhe të shpërndarjes së veprës, ndërsa autori ruan të drejtat tjera, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.
4. Dispozitat e këtij neni zbatohen ngjashëm dhe aq sa i takon mutatis mutandis edhe ndaj veprës që autori e ka krijuar si fitues i konkursit publik.
5. Ndaj kontratës për porosi të veprës së autorit zbatohen dispozitat e përgjithshme të të drejtës së detyrimeve, në mënyrë analoge, që kanë të bëjnë për kontratë për vepër, nëse me këtë ligj nuk parashihet ndryshe.

Neni 106

Kontrata e veprës kolektive të autorit

1. Vepra kolektive e autorit është vepër e krijuar në bashkëpunim të disa autorëve, duke gërshetuar kontributet e tyre veç e veç në një tërësi siç janë: enciklopeditë, leksikonet, bazat e të dhënave, programet kompjuterike, koleksionet dhe veprat tjera të ngjashme me iniciativën dhe nën drejtimin e një personi fizik apo juridik si porositës i veprës.
2. Për krijimin e një vepre kolektive lidhet kontratë e veçantë. Nëse nuk janë plotësuar kushtet nga

paragrafi 1. i këtij neni kontrata e tillë është e pavlefshme.

3. Konsiderohet se porositësit i është bërë kalimi i pakufizuar dhe ekskluziv i të gjitha të drejtave pasurore dhe i të drejtave tjera të autorit në veprën kolektive, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

4. Porositësi i veprës kolektive të autorit gëzon të drejtën për ta publikuar dhe shfrytëzuar veprën në emrin e vet, por në çdo ekzemplar të veprës duhet patjetër të jetë vënë lista e autorëve pjesëmarrës në krijimin e veprës kolektive.

KREU VIII DISPOZITA TË VEÇANTA PËR DISA VEPRA TË AUTORIT

Neni 107 E drejta e përshtatjes audiovizuele

1. Me kontratë të përshtatjes audiovizuele të veprës së autorit, autori ia kalon producentit të filmit të drejtën ekskluzive të përpunimit të veprës së tij burimore, për ta xhiruar dhe shfrytëzuar si vepër audiovizuele.

2. Konsiderohet se autori i veprës burimore ia kalon ekskluzivisht dhe pa kufizime producentit të filmit të drejtën e përshtatjes së veprës burimore në vepër audiovizuele, të gjitha të drejtat pasurore dhe të drejtat e tjera të autorit në atë vepër audiovizuele, përkthimet si dhe përshtatjet audiovizuele të saj, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2. të këtij neni autori i veprës burimore ruan:

3.1. të drejtën ekskluzive për përpunim të mëtejshëm të veprës audiovizuele në një formë tjetër artistike.

3.2. të drejtën ekskluzive për të lejuar një përshtatje të re audiovizuele të veprës burimore të tij, por pasi të kenë kaluar dhjetë (10) vjet që nga dita e lidhjes së kontratës nga paragrafi 2. i këtij neni.

3.3. të drejtën e kompensimit përkatës nga producenti i filmit, për çdo qiradhënie të videogrameve të veprës audiovizuele.

4. Autori i veprës burimore nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij sipas paragrafit 3. të këtij neni.

Neni 108 Supozimi i kalimit

Nëse një vepër burimore është krijuar nga dy apo më shumë bashkautorë, dhe vetëm njëri prej tyre e ka dhënë të drejtën e përshtatjes audiovizuele, ndërsa bashkautorit tjetër vetëm ka marrë pjesën e vet të pagesës së kompensimit, konsiderohet se edhe bashkautorit tjetër e ka dhënë në heshtje të drejtën e tij.

Neni 109

Për kalimin e mëtejshëm të të drejtës së fituar për përshtatje nuk nevojitet autorizimi i autorit në rastet kur producenti i filmit nuk është në gjendje ta përfundojë me sukses veprën.

Neni 110

1. Nëse me kontratë nuk është parashikuar ndryshe, konsiderohet se producenti i filmit ka të drejtë që titullin e veprës së përshtatur ta përdorë për titull të veprës audiovizuele.

2. Autori i veprës burimore, nëse kërkon, ka të drejtë që emri i tij dhe njoftimi se vepra audiovizuale është bërë sipas veprës së tij, të shënohen në afishe, programe të kinemasë dhe mjete të tjera reklamuese.

Neni 111

Kontrata e përshtatjes audiovizuale mund të përmbajë klauzolën mbi atë se autori i veprës burimore ka të drejtë ta shikojë skenarin para fillimit të produksionit.

Neni 112

Bashkautorët e veprës audiovizuale

1. Vepra audiovizuale është tërësi e mëvetësishme e kontributeve krijuese të bashkautorëve që kanë bashkëpunuar në bërjen e saj, si dhe vepër në të cilën mishërohen kontributet e autorëve të tjerë, por që nuk konsiderohen si bashkautorë.

2. Bashkautorë të veprës audiovizuale konsiderohen: autori i përshtatjes, autori i skenarit, autori i dialogjeve, drejtori i fotografisë dhe regjisori kryesor.

3. Nëse muzika është kompozuar enkas për atë vepër bashkautor i veprës është edhe kompozitori.

4. Nëse animacioni përbën element thelbësor të veprës audiovizuale bashkautor i kësaj vepre konsiderohet edhe animatori kryesor.

5. Kompozitori i muzikës dhe animatori, përkatësisht vizatuesi që nuk konsiderohen bashkautorë të veprës sipas paragrafit 3. dhe 4. të këtij neni, si dhe skenografi, kostumografi, piktori i grimtë dhe montazheri, konsiderohen autorë të kontributeve përkatëse në veprën e autorit.

Neni 113

Kontrata e prodhimit të filmit

1. Marrëdhëniet e ndërsjella të producentit të filmit me autorët e veprës audiovizuale dhe autorët e kontributeve, si dhe marrëdhëniet midis vetë bashkautorëve rregullohen me anë të kontratës për prodhim të filmit.

2. Me kontratën e prodhimit të filmit autorët e veprës audiovizuale dhe autorët e kontributeve marrin përsipër detyrimin ndaj producentit të filmit për të bashkëpunuar në mënyrë krijuese në krijimin e veprës audiovizuale, dhe ia kalojnë të gjitha të drejtat e tyre pasurore mbi atë vepër, ndërkaq producenti i filmit merr përsipër detyrimin për t'iu paguar kompensimin e autorit.

3. Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit, konsiderohet se bashkautorët dhe autorët e kontributeve, në mënyrë ekskluzive dhe pa kufizime, ia kalojnë producentit të filmit të gjitha të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit mbi veprën audiovizuale, përkthimet e saj në gjuhë të tjera dhe përpunimet tjera audiovizuale si dhe fotografitë që kanë të bëjnë me veprën, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

4. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 3. të këtij neni:

4.1. bashkautorët ruajnë të drejtën ekskluzive deri në përpunimin e mëtejshëm të veprës audiovizuale në një formë tjetër artistike;

4.2. autorët e kontributeve e ruajnë të Drejtën ekskluzive që kontributet e tyre në veprën audiovizuale, pas përfundimit të veprës, t'i shfrytëzojnë ndaras nga vepra audiovizuale, nëse me këtë nuk do të shkelen të drejtat e producentit të filmit;

4.3. bashkautorët dhe autorët e kontributeve ruajnë të drejtën e kompensimit përkatës nga Producenti i filmit, për çdo qiradhënie të videogramave të veprës audiovizuale.

5. Bashkautorët dhe autorët e kontributeve nuk mund të heqin dorë nga të drejtat sipas paragrafit 4. të këtij neni.

Neni 114 Kompensimi i autorit

1. Bashkautorëve të veprës audiovizuale u takon kompensimi i autorit ndaras për secilën të drejtë pasurore, apo të drejtë tjetër të autorit që ia kanë kaluar producentit të filmit.

2. Producenti i filmit detyrohet që, të paktën një herë në vit, t'i informojë bashkautorët e veprës audiovizuale lidhur me të ardhurat e realizuara për secilën formë të autorizuar të shfrytëzimit të veprës, si dhe t'u mundësojë të njihen me të dhënat që u referohen të ardhurave.

Neni 115 Përfundimi i veprës audiovizuale

1. Vepra audiovizuale konsiderohet e përfunduar kur mes regjisorit kryesor dhe producentit të filmit arrihet pëlqimi se kopja e parë standarde është e përfunduar.

2. Çfarëdo ndryshimi i kopjes së parë standarde nga paragrafi 1. i këtij neni nuk lejohet të bëhet pa pëlqimin e arritur ndërmjet regjisorit kryesor dhe producentit të filmit.

3. Nuk lejohet shkatërrimi i kopjes së parë standarde të veprës audiovizuale.

4. Po qe se një nga bashkautorët apo autorët e kontributeve nuk dëshiron përfundimin e plotë të kontributit të vet në veprën audiovizuale ose kur nuk ka mundësi për të vazhduar bashkëpunimin nuk mund ta kundërshtojë shfrytëzimin e kontributit të tij të deriatëhershëm për qëllim të përfundimit të plotë të veprës. Në rast të këtillë autori gëzon të drejtat lidhur me kontributin e tij të deriatëhershëm.

Neni 116 Zgjidhja e kontratës

1. Nëse producenti i filmit nuk ka arritur ta përfundojë veprën audiovizuale për tri (3) vite, që nga dita e lidhjes së kontratës për veprën filmike, bashkautorët kanë të drejtë të zgjidhin kontratën, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

2. Përveç të drejtës për zgjidhjen e kontratës, bashkautorët e veprës audiovizuale kanë të drejtë në dëmshpërblim, nëse producenti i filmit nuk fillon shfrytëzimin e veprës së përfunduar audiovizuale brenda një (1) viti që nga dita e përfundimit të kopjes së parë standarde, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

3. Në rastet nga paragrafët 1. dhe 2. të këtij neni, bashkautorët dhe autorët e kontributeve mbajnë të drejtën e pagesës së kompensimit.

Neni 117 Të drejtat mbi fotografitë

Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit konsiderohet se drejtori i fotografisë ia ka kaluar producentit të filmit të gjitha të drejtat e shfrytëzimit të fotografive që janë bërë gjatë prodhimit të veprës audiovizuale.

Neni 118 Kufizimi i të drejtave

Autori i veprës burimore, i cili ka kaluar të drejtën për përshtatje audiovizuale, si dhe bashkautorët e

veprës audiovizuale dhe autorët e kontributeve në veprën audiovizuale nuk gëzojnë të drejtën e pendimit neni 20 si dhe të drejtën e revokimit të të drejtave ekonomike neni 87 të këtij ligji.

Neni 119

Programet kompjuterike

Nuk gëzojnë mbrojtje idetë dhe parimet që përbëjnë bazën e cilitdo element të programit, duke përfshirë edhe ato që përbëjnë bazën e ndërfaqes.

Neni 120

Nëse autori ka bërë program kompjuterik duke përmbushur detyrat e tij të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit të tij, përkatësisht nëse autori ka bërë program kompjuterik në bazë të kontratës për porosi të veprës, konsiderohet se të gjitha të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit mbi atë program kompjuteri i janë kaluar ekskluzivisht dhe pa kufizime punëdhënësit, përkatësisht porositësit të programit, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 121

Të drejtat e autorit

1. Autori i programit kompjuterik ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo të ndalojë, në veçanti:

1.1. riprodhimin e pjesëve përbërëse apo të programit kompjuterik në tërësi, me çfarëdo mjeti apo në çfarëdo forme, pa marrë parasysh a është i përkohshëm apo përhershëm. Në rast se vendosja, ekspozimi, vënia në punë, transmetimi ose deponimi i programit kërkon riprodhimin e tij, për të kryer këto veprime duhet patjetër leja e autorit;

1.2. përkthimin, përshtatjen, rregullimin ose ndonjë përpunim tjetër të programit kompjuterik, si dhe riprodhimin e rezultateve të ndryshimeve të tilla, por pa prekur të drejtat e personit i cili ka bërë ato ndryshime;

1.3. shpërndarjen e origjinalit të programit kompjuterik ose të ekzemplarëve të tij në çfarëdo forme, duke përfshirë edhe qiradhënien.

1.4. autori mundet, gjithashtu, të kalojë të drejtat nga nën-paragrafi 1.3. i këtij paragrafi në personat e tretë edhe me kontratë për dhënien e licencës.

Neni 122

Kufizimet e të drejtave të autorit

1. Nëse me kontratë nuk përcaktohet ndryshe, zotëruesi i ligjshëm i programit kompjuterik pa autorizimin e autorit mund t'i kryejë veprimet sipas nën-paragrafëve 1.1. dhe 1.2., të paragrafit 1. të nenit 121 të këtij ligji, duke përfshirë edhe korrigjimin e gabimeve, por në masën që është e domosdoshme për shfrytëzimin e programit kompjuterik në përputhje me qëllimin e tij.

2. Personi që gëzon të drejtën për të shfrytëzuar programin kompjuterik, pa autorizimin e autorit, mund të bëjë një kopje rezervë të programit kompjuterik, nëse kjo është e nevojshme për shfrytëzimin e tij.

3. Personi që gëzon të drejtën për të shfrytëzuar kopjen e programit kompjuterik, pa autorizimin e autorit, mund të vëzhgojë, studiojë ose të provojë funksionimin e programit kompjuterik, për të forcuar idetë dhe parimet që janë themel i cilitdo element të programit kompjuterik, nëse këtë e bën gjatë veprimit të vendosjes, ekspozimit, vënies në punë, transmetimit ose deponimit të programit për të cilin ka autorizim.

4. Ndaj programeve kompjuterike nuk zbatohen dispozitat lidhur me të drejtën e pendimit sipas nenit 20, të drejtën e kompensimit të veçantë sipas nenit 38 dhe të drejtën për reprodukim privat ose tjetër vetanak sipas neni 44 të këtij ligji.

5. Përcaktimet kontraktore që janë në kundërshtim me dispozitat nga paragrafi 2. dhe 3. të këtij neni janë të pavlefshme.

Neni 123 Zbërthimi

1. Nuk është e domosdoshme leja e autorit, në kuptim të nën-paragrafit 1.1. dhe 1.2. të paragrafit 1. të nenit 121 të këtij ligji, për të bërë riprodhimin e kodit apo përkthimin e formave të tij, kur riprodhimi apo përkthimi i tillë është i domosdoshëm për të nxjerrë të dhënat për arritjen e ndërveprimit të programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur, me programet tjera ose mekanizmin e kompjuterit, nëse plotësohen kushtet në vijim:

1.1. që këto veprime të bëhen nga zotëruesi i licencës ose shfrytëzuesi tjetër i autorizuar ose në emër të tyre, nga një person tjetër;

1.2. që informacioni i nevojshëm për ndërveprim nuk ka qenë më parë i kapshëm në mënyrë të lehtë për personat nga nën-paragrafi 1.1. i këtij paragrafi;

1.3. që këto veprime të kufizohen vetëm në ato pjesë të programit ekzistues që janë të domosdoshme për arritjen e ndërveprimit.

2. Është e ndaluar që informacionet e nxjerra me veprimet nga paragrafi 1. i këtij neni:

2.1. të përdoren për qëllime të tjera, përveç për arritjen e ndërveprimit të programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur;

2.2. t'iu jepen personave të tjerë, përveç kur kjo është e domosdoshme për arritjen e ndërveprimit të programit kompjuterik të krijuar në mënyrë të pavarur;

2.3. të përdoren për krijimin, prodhimin ose nxjerrjen në treg të programit tjetër kompjuterik, i cili për nga shprehja e tij është thelbësisht i ngjashëm, ose për çfarëdo veprimi me të cilin shkelet e drejta e autorit.

3. Dispozitat nga paragrafi 1. i këtij neni nuk mund të interpretohen në atë mënyrë që do të lejojë zbatimin e tyre në kundërshtim me përdorimin normal të programit kompjuterik ose duke cenuar të drejtat e ligjshme të autorit.

4. Përcaktimet kontraktore që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij neni janë të pavlefshme.

Neni 124 Masat e veçanta të mbrojtjes

1. Cenim i të drejtës së autorit mbi programin kompjuterik konsiderohet:

1.1. çdo shpërndarje, duke përfshirë edhe ofertën për shfrytëzimin e një a më shumë ekzemplarëve të programit kompjuterik, për të cilin dihet ose do të mund të dihej se është ekzemplar i paligjshëm.

1.2. zotërimi për qëllime komerciale i ekzemplarit të programit kompjuterik, për të cilin dihet ose do të mund të dihej se është ekzemplar i paligjshëm.

Neni 125 Zbatimi i dispozitave të tjera ligjore

Dispozitat e këtij ligji lidhur me programet kompjuterike nuk prekin dispozitat tjera ligjore lidhur me

programet kompjuterike, siç janë ato për patentën, markën e prodhimit, mbrojtjen e gjysmëpërçuesve, mbrojtjen nga konkurrenca jolojale, sekretin zyrtar, si dhe të drejtës së detyrimeve.

Neni 126

Vepra e autorit nga marrëdhënia e punës

1. Kur vepra e autorit krijohet nga i punësuar gjatë marrëdhënies së punës, duke përbushur detyrat e veta të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit, konsiderohet se të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit i janë kaluar ekskluzivisht dhe pakufizime punëdhënësit, për një periudhë dhjetëvjeçare që nga përfundimi i veprës, nëse me kontratën e punësimit apo me një akt tjetër të shkruar me punëdhënësin nuk është parashikuar ndryshe.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1. të këtij neni, të drejtat do t'i kthehen autorit të punësuar para mbarimit të afatit të tillë, në rast të vdekjes së punëdhënësit, përkatësisht në rast të likuidimit të punëdhënësit si person juridik.

3. Nëse punëdhënësi fare nuk i shfrytëzon të drejtat pasurore mbi atë vepër, ose i shfrytëzon në masë të papërfillshme, autori i punësuar ka të drejtë të kërkojë nga punëdhënësi që ky t'ia kalojë ato të drejta kundrejt kompensimit të shpenzimeve.

4. Nëse nuk është kontraktuar ndryshe në mes autorit dhe punëdhënësit, i punësuar si autor i veprës gëzon të drejtën të kërkojë nga punëdhënësi kompensim shtesë, nëse paga e tij është në shpërpjesëtim të dukshëm me fitimet apo kursimet e realizuara në saje të shfrytëzimit të veprës.

Neni 127

Pavarësisht nga dispozitat tjera të këtij ligji autori i veprës ruan të drejtën ekskluzive për të përfshirë veprën e vet në koleksion të veprave të zgjedhura të tij ose në koleksion të të gjitha veprave të tij.

Neni 128

Të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit që kanë të bëjnë me bazën e të dhënave ose me veprën kolektive të krijuar gjatë marrëdhënies së punës konsiderohen se i janë kaluar punëdhënësit ekskluzivisht dhe pa kufizime, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 129

Veprat e krijuara gjatë shkollimit

Institucionet arsimore kanë të drejtë që vepra të plota të autorëve ose pjesë të veprave të nxënësve apo studentëve të vet t'i përfshijnë në koleksione veprash shkollore të nxënësve apo studentëve të vet, si dhe këto koleksione t'i reprodukojnë dhe shpërndajnë.

KREU IX

TË DREJTAT E PËRAFËRTA ME TË DREJTËN E AUTORIT

NËNKREU A

TË DREJTAT E INTERPRETUESVE

Neni 130

Të drejtat morale të interpretuesve

1. Interpretuesit kanë të drejtë ekskluzive:

1.1. që emri, pseudonimi apo shenja e tyre të tregohet me rastin e shfrytëzimit të interpretimit të tyre;

- 1.2. të kundërshtojnë çdo deformim, shëmtim apo shfrytëzim të interpretimit që mund të cenojnë nderin dhe namën e tyre.
2. Nëse interpretimin e bën ansambli i interpretuesve të drejtën nga nën-paragrafi 1.1. i paragrafit 1. të këtij neni e mban ansambli si tërësi, solistët dhe udhëheqësi artistik.
3. Me rastin e vlerësimit nëse me një formë konkrete të shfrytëzimit cenohen nderi dhe respekti i interpretuesit merret parasysh masa e arsyeshme e ndjeshmërisë së interpretuesit.

Neni 131
Të drejtat pasurore të interpretuesve

1. Interpretuesi ka të drejtë të lejojë apo të ndalojë:
 - 1.1. fiksimin e interpretimit të tij drejtpërdrejt;
 - 1.2. riprodhimin e interpretimit të tij në fonograme dhe videograme;
 - 1.3. shpërndarjen e fonogrameve dhe të videogrameve që përmbajnë interpretimin e tij;
 - 1.4. qiradhënien e fonogramit ose të videogramit që përmban interpretimin e tij;
 - 1.5. emetimin radioteleviziv të interpretimit të tij në të gjallë;
 - 1.6. transmetimin publik të interpretimit të tij në të gjallë;
 - 1.7. përpunimin e interpretimit të tij tashmë të fiksuar;
 - 1.8. vënien e interpretimit të tij në dispozicion publikut.

Neni 132
E drejta e kompensimit

1. Interpretuesit kanë të drejtën e hises në kompensimin që merr prodhuesi i fonogramit, për komunikimin publik të interpretimit të tyre nga fonogrami i botuar për qëllime komerciale.
2. Interpretuesit që ia kalojnë të drejtën e qiradhënies prodhuesit të fonogramit ose producentit të filmit ruajnë të drejtën e kompensimit përkatës nga qiradhënia. Interpretuesit nuk mund të heqin dorë nga kjo e drejtë.
3. Interpretuesi ka të drejtën e hises në kompensim të veçantë nga paragrafi 2. i nenit 38 të këtij ligji.

Neni 133
Supozimi i kalimit

1. Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit supozohet se interpretuesi ekskluzivisht dhe pa kufizime ia ka kaluar producentit të filmit të gjitha të drejtat e veta pasurore lidhur me interpretimin, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe, përjashtimisht siç është përcaktuar në paragrafin 3. të këtij neni.
2. Për secilën të drejtë pasurore që do ta ketë kaluar sipas paragrafit 1. të këtij neni, interpretuesi ka të drejtë të kompensimit përkatës nga ana e producentit të filmit.
3. Interpretuesi nuk mund të heq dorë nga e drejta e referuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Neni 134
Përfundimi i veprës audiovizuale

Nëse interpretuesi refuzon përfundimin e kontributit të vet për veprën audiovizuale ose nuk ka mundësi ta përfundojë atë, nuk mund të kundërshtojë që kontributi i tij tashmë i dhënë të shfrytëzohet për përfundimin e plotë të veprës. Interpretuesi gëzon të drejtat përkatëse për kontributin e deriatëhershëm.

Neni 135

Përfaqësuesi i ansamblit të interpretuesve

1. Lidhur me administrimin e të drejtave të interpretuesve ansamblin e përfaqëson personi që është i autorizuar me shkrim nga shumica e anëtarëve të ansamblit.

2. Nëse në interpretim të veprës pos ansamblit marrin pjesë dirigjenti, solistë dhe bartësit e roleve kryesore, të cilët nuk janë njëkohësisht anëtarë të ansamblit, për administrimin e të drejtave nga ky ligj është i domosdoshëm pajtimi i të gjithë këtyre personave, nëse në kontratë midis tyre dhe ansamblit nuk parashihet ndryshe.

3. Dispozitat e paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni nuk kanë të bëjnë me dirigjentët, solistët dhe regjisorët e shfaqjeve teatrore.

Neni 136

Interpretimi nga marrëdhënia e punës

Në lidhje me interpretimet që janë rezultat i përbushjes së detyrave të punës ose udhëzimeve të punëdhënësit gjatë kohëzgjatjes së punësimit, ngjashëm dhe sa u takon mutatis mutandis zbatohen dispozitat e këtij ligji, që u referohen veprave të autorit të krijuara gjatë marrëdhënies së punës.

Neni 137

Kohëzgjatja e mbrojtjes

1. Të drejtat pasurore të interpretuesit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga interpretimi i bërë. Nëse interpretimi i fiksuar brenda kësaj periudhe është botuar në mënyrë të ligjshme ose i është komunikuar publikut, të drejtat e interpretuesit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e botimit të parë ose e komunikimit të parë të tillë, varësisht se cili veprim është bërë më përpara.

2. Të drejtat morale të interpretuesit zgjasin pa kufizime kohore.

NËNKREU B

TË DREJTAT E PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE

Neni 138

Të drejtat e prodhuesve të fonogrameve

1. Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtë ekskluzive të lejojnë apo të ndalojnë:

- 1.1. riprodhimin e fonogrameve të veta;
- 1.2. shpërndarjen e fonogrameve të veta;
- 1.3. qiradhënien e fonogrameve të veta;
- 1.4. vënien e fonogrameve të veta në dispozicion të publikut;
- 1.5. përpunimin e fonogrameve të veta.

Neni 139

E drejta e kompensimit për komunikimin e fonogrameve publikut

1. Prodhuesi i fonogramit ka të drejtën e kompensimit për komunikim të publikut të fonogramit të tij të botuar për qëllime komerciale.
2. Nëse me kontratë mes prodhuesit të fonogramit dhe interpretuesve nuk është parashikuar ndryshe, prodhuesi i fonogramit është i detyruar që gjysmën e kompensimit nga paragrafi 1. i këtij neni t'ua përcjellë interpretuesve, interpretimet e të cilëve gjenden në fonogramin e tij.
3. Në kuptim të këtij neni, fonogramet të botuara për qëllime komerciale konsiderohen fonogramet e vëna në dispozicion të publikut.

Neni 140
E drejta në kompensim të veçantë

Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtën e hises në kompensimin e veçantë nga paragrafi 1. i nenit 38 të këtij ligji.

Neni 141
Kohëzgjatja e të drejtave

Të drejtat e prodhuesit të fonogrameve zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga koha e fiksimit. Nëse brenda kësaj kohe fonogrami është botuar ligjshëm, të drejtat zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga botimi i tij i parë. Nëse gjatë kësaj periudhe fonogrami nuk është botuar ligjshëm, por i është komunikuar ligjshëm publikut, të drejtat zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e komunikimit të parë të ligjshëm për publikun.

NËNKREU C
TË DREJTAT E PRODUCENTËVE TË FILMIT

Neni 142
Të drejtat e producentëve të filmit

1. Producentët e filmit kanë të drejtë ekskluzive të lejojnë apo të ndalojnë:

- 1.1. riprodhimin e videogrameve të veta;
- 1.2. shpërndarjen e videogrameve të veta;
- 1.3. qiradhënien e videogrameve të veta;
- 1.4. shfaqjen publike të videogrameve të tyre;
- 1.5. vënien e videogrameve të veta në dispozicion të publikut.

Neni 143
E drejta në kompensim të veçantë

Producentët e filmit gëzojnë të drejtën e hises në kompensim të veçantë nga paragrafi 2. i nenit 38 të këtij ligji.

Neni 144
Kohëzgjatja e të drejtave

Të drejtat e producentëve të filmit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga fiksimi i parë i videogramit. Nëse gjatë kësaj periudhe videogrami është botuar ose i është komunikuar ligjshëm publikut, të drejtat e producentit të filmit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e botimit të parë ose e komunikimit të parë publikut, varësisht se cili veprim është bërë më përpara.

NËNKREU D
TË DREJTAT E SHËRBYESVE MEDIAL AUDIOVIZUEL

Neni 145
Të drejtat e shërbyesve medial audiovizuel

1. Shërbyesi medial audiovizuel ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo të ndalojë:
 - 1.1. fiksimin e emisioneve të veta;
 - 1.2. riprodhimin e emisioneve të veta të fiksuara;
 - 1.3. shpërndarjen e fiksimeve të emisioneve të veta;
 - 1.4. riemetimin radioteleviziv të emisioneve të veta;
 - 1.5. emetimin e mëtejshëm të emisioneve të veta, kur kjo bëhet në ato vende ku hyrja e publikut është me pagesë;
 - 1.6. vënien në dispozicion publikut të emisioneve të veta të fiksuara.

Neni 146
Kohëzgjatja e të drejtave

Të drejtat e shërbyesve medial audiovizuel zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e emetimit të parë radioteleviziv të emisionit të tyre.

NËNKREU E
TË DREJTAT E PRODHUESVE TË BAZAVE TË TË DHËNAVE

Neni 147
Mbrojtja e bazës së të dhënave

Mbrojtja e bazës së të dhënave apo e përmbajtjeve të saj zbatohet pavarësisht nga mbrojtja autor-juridike ose mbrojtja tjetër juridike. Të drejtat që ekzistojnë lidhur me materialin e ngërthyer në bazën e të dhënave dhe të shfrytëzimit të tij mbeten të paprekshme.

Neni 148
Objekti i mbrojtjes

1. Mbrojtja e bazës së të dhënave në kuptim të këtij kapitulli zbatohet:
 - 1.1. ndaj tërë përmbajtjes të bazës së të dhënave;
 - 1.2. ndaj çdo pjese thelbësore kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative të përmbajtjes së saj;
 - 1.3. ndaj pjesëve jothelbësore kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative të përmbajtjes së saj, kur ato përdoren në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, për çka bie ndesh me shfrytëzimin normal të kësaj baze të të dhënave ose me këtë preken së tepërmi interesat ekzistuese të ligjshme të prodhuesit të bazës së të dhënave.
2. Në kuptim të këtij kapitulli, mbrojtja nuk përfshin programet kompjuterike të përdorura për bërjen

ose funksionimin e bazës elektronike të të dhënave.

Neni 149

Të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhënave

1. Prodhuesi i bazës së të dhënave ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo ndalojë:

- 1.1. riprodhimin e bazës së tij të të dhënave;
- 1.2. shpërndarjen e bazës së tij të të dhënave;
- 1.3. qiradhënien e bazës së tij të të dhënave;
- 1.4. vënien e bazës së tij të të dhënave në dispozicion të publikut;
- 1.5. çfarëdo formë tjetër të komunikimit të bazës së vet të të dhënave për publikun.

Neni 150

Të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesve të ligjshëm

1. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose të ekzemplarit të saj mund të shfrytëzojë lirshëm në mënyrë kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative, pjesët jothelbësore të përmbajtjeve të saj, për çfarëdo qëllimi. Në rast se shfrytëzuesi është i autorizuar të përdorë vetëm një pjesë të caktuar të bazës së të dhënave dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për atë pjesë.

2. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose i ekzemplarit të saj nuk mund të bëjë veprime që janë në kundërshtim me shfrytëzimin normal të asaj baze të të dhënave ose me çka pa arsye do të prekeshin të drejtat e prodhuesit të asaj baze të të dhënave.

3. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose i ekzemplarit të saj nuk mund të shkelë të drejtën e autorit ose të drejtat e përafërta për veprat ose lëndët e ngërthyera në atë bazë të dhënash.

4. Çdo përcaktim kontraktor në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

Neni 151

Punësimi dhe kontrata e porosisë

Kur baza e të dhënave është bërë nga personi i punësuar duke pëmbushur detyrat e tij të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit, ose kur është bërë në bazë kontratës së porosisë, supozohet se të gjitha të drejtat për atë bazë të të dhënave i janë kaluar ekskluzivisht dhe pa kufizime punëdhënësit, përkatësisht porositësit, nëse me këtë ligj apo me kontratë nuk parashihet ndryshe.

Neni 152

Kufizimet e të drejtave

1. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave mund të përdorë lirshëm pjesë thelbësore të përmbajtjes së saj:

- 1.1. për përdorim privat ose përdorim tjetër të brendshëm, nëse ka të bëjë me bazë jo elektronike të të dhënave;
- 1.2. për nevojat e ilustrimit të mësimdhënies ose hulumtimeve shkencore, me kusht që të përmendet burimi, për qëllim jokomercial deri në masën e lejuar me ligj;

1.3. për nevojat e sigurimit publik ose për të siguruar ecurinë e drejtë të veprimeve dhe raportimeve në procedurat administrative, parlamentare dhe gjyqësore.

Neni 153

Kohëzgjatja e mbrojtjes

1. Të drejtat e prodhuesit të bazës së të dhënave zgjasin pesëmbëdhjetë (15) vjet që nga bërja e plotë e saj. Nëse baza e të dhënave është publikuar në mënyrë të ligjshme gjatë kësaj periudhe, të drejtat zgjasin pesëmbëdhjetë (15) vjet që nga publikimi i parë i saj.

2. Çdo ndryshim thelbësor kualitativ dhe kuantitativ si dhe kualitativ ose kuantitativ i përmbajtjes së bazës së të dhënave që rezulton me investim të ri thelbësor kualitativ dhe kuantitativ si dhe kualitativ ose kuantitativ do ta kualifikojë atë bazë të dhënash me kohëzgjatje të re të mbrojtjes. Si ndryshim thelbësor i përmbajtjes konsiderohen edhe shtojcat e njëpasnjëshme, fshirjet ose ndryshimet e tjera të bazës së të dhënave.

NËNKREU F TË DREJTAT E BOTUESVE

Neni 154

E drejta e hises për kompensim të veçantë

1. Botuesit kanë të drejtën e hises në kompensim të veçantë nga neni 38 paragrafi 3. i këtij ligji.
2. E drejta nga paragrafi 1. i këtij neni zgjatë pesëdhjetë (50) vjet që nga botimi i ligjshëm i veprës.

Neni 155

Veprat e papublikuara në domenin publik

1. Personi që për herë të parë boton në mënyrë të ligjshme ose i komunikon publikut veprën ende të pa publikuar dhe e cila bie në domenin publik gëzon mbrojtje të njëjtë siç është për të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit.
2. Të drejtat në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni zgjasin njëzetepesë (25) vjet që nga botimi i parë i ligjshëm, përkatësisht komunikimi i veprës për publikun.

Neni 156

Botimet shkencore

1. Botimet që përbëhen nga vepra dhe tekste për të cilat ka mbaruar mbrojtja gëzojnë mbrojtje të njëjtë siç është për të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit, nëse janë rezultat i përpjekjeve shkencore dhe dallohen dukshëm nga botimet e njohura paraprake të këtyre veprave, përmes rimës, thyerjes dhe karakteristikave tjera redaktuese.
2. Të drejtat në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni zgjasin tridhjetë (30) vjet që nga botimi i parë i ligjshëm i veprës.

KREU X

NËNKREU A ADMINISTRIMI I TË DREJTAVE

Neni 157

1. Bartësi i të drejtës së autorit ose i të drejtave të përafërta mund t'i administrojë të drejtat e tij në mënyrë individuale ose kolektive.

2. E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta administrohen në mënyrë individuale, kur për çdo vepër të autorit ose lëndë nga të drejtat e përafërta administrimi bëhet veç e veç.

3. E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta administrohen në mënyrë kolektive, kur administrimi mbulon një sërë veprash të autorit ose lëndësh nga të drejtat e përafërta dhe njëkohësisht një sërë bartësish të të drejtave të lidhura me to.

NËNKREU B ADMINISTRIMI INDIVIDUAL I TË DREJTAVE

Neni 158

1. Administrimin individual të të drejtave bartësi i të drejtave e ushtron personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit të tij në bazë të autorizimit përkatës.

2. Punët e përfaqësuesit të autorizuar mund t'i kryej personi fizik apo juridik.

NËNKREU C ADMINISTRIMI KOLEKTIV I TË DREJTAVE

Neni 159

Suazat e administrimit kolektiv të të drejtave

1. Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta përfshin:

1.1. kalimin joeksluziv të të drejtave për kategoritë e caktuara të të drejtave të autorit dhe të lëndëve të të drejtave të përafërta;

1.2. parashtrimin e kërkesave dhe mbledhjen e kompensimeve për shfrytëzimin e kategorisë së caktuar të veprave të autorit ose lëndëve nga të drejtat e përafërta;

1.3. shpërndarjen e kompensimeve të mbledhura bartësve të të drejtave;

1.4. ushtrimin e kontrollit lidhur me përmbushjen e detyrimeve kontraktore e ligjore nga ana e shfrytëzuesve;

1.5. përfaqësimi në realizimin e mbrojtjes së të drejtave para gjykatave dhe organeve të tjera.

Neni 160

Sfera e administrimit kolektiv të të drejtave

1. Administrimi kolektiv i të drejtave lejohet vetëm lidhur me lëndët e mbrojtura tashmë të publikuara dhe në rastet që kanë të bëjnë me:

1.1. komunikimin publikut të veprave muzikore joskenike dhe të veprave të shkruara, të drejtave të vogla;

1.2. rishitjen e origjinalit të veprave të arteve figurative, droits de suite;

1.3. huadhënien publike të origjinaleve ose kopjeve të veprave;

1.4. kompensimin për shfrytëzim privat apo tjetër vetanak dhe fotokopjimin jashtë masës siç përcaktohet në dispozitat e këtij ligji;

1.5. ritransmetimin kabllorik të lëndëve të mbrojtura, përveç emisioneve vetanake të shërbyesve medial audiovizuel, pa marrë parasysh nëse ka të bëjë me të drejtat e tyre vetanake apo të drejtat e kaluara nga bartësit e tjerë të të drejtave.

1.6. riprodhimin e lëndëve të mbrojtura në fonogram dhe videograme, të drejtat mekanike;

1.7. qiradhënien e fonogrameve dhe videogrameve;

1.8. riprodhimin e lëndëve të mbrojtura nëpër libra leximi dhe Tekste shkollore për qëllime të mësimdhënies;

1.9. rishtypjen e artikujve aktual në botimet ditore dhe periodike;

1.10. riprodhimin e veprave të arteve të bukura figurative, fotografive, vizatimeve dhe skicave në botimet ditore dhe periodike;

1.11. rishtypjen e pjesëve të veprave apo veprave të shkurtra letrare në botimet ditore dhe periodike;

1.12. riprodhimin dhe komunikimin publikut të lëndëve të mbrojtura, në kuadër të reklamave që nuk zgjasin më shumë se gjashtëdhjetë (60) sekonda;

1.13. riprodhimin për qëllime komerciale të veprave që ndodhen në vende ku publiku ka qasje.

2. Të drejtat nga ritransmetimi kabllor të lëndëve të mbrojtura ushtrohet vetëm përmes shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave, përveç transmetimeve vetanake të shërbyesve medial audiovizuel, pavarësisht nëse ka të bëjë me të drejtat e tyre vetanake apo të drejtat e kaluara nga bartësit e tjerë të të drejtave.

Neni 161

Shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave

1. Administrimi kolektiv i të drejtave mund të bëhet përmes shoqatave të bartësve të të drejtave të cilat, për kryerjen e veprimtarisë së këtyre, kanë leje nga Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

2. Për realizimin e të drejtave të caktuara të autorit dhe bartësve të të drejtave nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave nga paragrafi 1. i këtij neni, nevojitet autorizimi nga autori apo nga bartësi tjetër i të drejtave.

3. Të drejtat e autorit në shfaqjet publike të veprave muzikore apo letrare joperformuese të njohura si të drejta të vogla, mund të administrohen nga shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave edhe pa autorizimin e autorit dhe bartësit të së drejtës.

4. Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, në tekstin e mëtejshëm Zyra, do t'i lëshojë leje shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave, të cilat i përmbushin kriteret profesionale dhe ligjore të përcaktuara nga Zyra.

5. Nëse shoqatat për administrim kolektiv të të drejtave nuk i përmbushin kriteret e përcaktuara për kryerjen e aktiviteteve të këtyre Zyra e anulon lejen e dhënë.

Neni 162

Veprimtaria dhe statusi

1. Në kuadër të veprimtarisë dhe të autorizimeve, shoqata për administrim kolektiv të të drejtave, kujdeset për administrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, të bartësve vendorë dhe të huaj të të drejtave në Kosovë, si dhe bartësve vendorë të këtyre të drejtave jashtë Kosovës.

2. Administrimi kolektiv i të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta është veprimtari e vetme e shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.

Neni 163

1. Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave është subjekt juridik, i regjistruar për të administruar në mënyrë kolektive të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë dhe qeveriset nga anëtarët e saj.

2. Shoqata për administrimin kolektiv të të drejtave ka statusin e organizatës joqeveritare dhe jo për përfitim.

3. Shoqata për administrimin kolektiv të të drejtave vepron në emër të vet dhe për llogari të bartësve të të drejtave.

4. Selia e Shoqatës për administrimin kolektiv të të drejtave duhet të jetë në Kosovë.

Neni 164

1. Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave është e pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së vet dhe ndërmarrjen e masave organizative e të masave të tjera të nevojshme për funksionimin e saj dhe përmbushjen e detyrimeve kontraktore e ligjore.

2. Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave është e detyruar të sigurojë kushtet për një administrim efektiv e pasuror të të drejtave dhe të interesave të bartësve të të drejtave, duke përfshirë këtu personelin, pajisjet teknike dhe skemat e organizimit.

Neni 165 **Qeverisja**

1. Shoqata për administrimin kolektiv të të drejtave qeveriset nga anëtarët, nëpërmjet organeve të saj dhe në përputhje me statutin.

2. Organet e shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave janë: Kuvendi, Këshilli Drejtues, Drejtori dhe Këshilli Mbikëqyrës.

3. Kuvendin e shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave e përbëjnë të gjithë anëtarët e saj.

4. Kuvendi i shoqatës për administrimin kolektiv të të drejtave i miraton vendimet në seancë të përgjithshme të anëtarëve me shumicën e thjeshtë të votave.

5. Forma dhe mënyra e vendimmarrjes në Kuvend, përcaktohet me statutin e shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.

Neni 166 **Statuti**

1. Statuti është akti juridik më i lartë dhe themeltar që rregullon organizimin dhe funksionimin e shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.

2. Të gjitha aktet tjera juridike duhet të jenë në përputhje me statutin e shoqatës sipas paragrafit 1. të këtij neni.

3. Statuti i Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave përmban dispozitat të cilat rregullojnë sidomos:

- 3.1. objektivat dhe detyrat e Shoqatës për administrimin kolektiv të të drejtave;
- 3.2. llojin e të drejtave që administrohen në mënyrë kolektive;
- 3.3. marrëdhëniet me bartësit e të drejtave dhe me shfrytëzuesit e të drejtave;
- 3.4. marrjen dhe humbjen e cilësisë së autorit;
- 3.5. kategoritë identike të bartësve të të drejtave dhe kategoritë e anëtarësisë;
- 3.6. të drejtat e anëtarëve dhe mënyrën e votimit sipas kategorisë së anëtarësisë;
- 3.7. detyrimet e anëtarëve dhe rregullat e mirësjelljes;
- 3.8. sistemin e qeverisjes së Shoqatës;
- 3.9. parimet themelore për shpërndarjen e të ardhurave, bartësve të të drejtave;
- 3.10. sistemin e mbikëqyrjes së administrimit financiar dhe ekonomik;
- 3.11. detyrimin e llogaridhënies ndaj bartësve të të drejtave dhe ndaj Zyrës;
- 3.12. informimin e anëtarëve dhe të publikut.

4. Statutin e miraton Kuvendi i Shoqatës për administrim të të drejtave në seancë të përgjithshme.

5. Statuti i nënshtrohet pëlqimit të Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Neni 167

Tarifat e përgjithshme dhe marrëveshjet tarifore

1. Shumat e kompensimit që duhet të paguajnë shfrytëzuesit për format e ndryshme të shfrytëzimit të lëndëve të mbrojtura caktohen me tarifa të përgjithshme.

2. Tarifat e përgjithshme i propozon bordi drejtues i Shoqatës dhe i miraton Kuvendi i Shoqatës.

3. Tarifat e përgjithshme të propozuara nga paragrafi 2. i këtij neni i nënshtrohen negociatave me organizatat e shfrytëzuesve të llojit të njëjtë të lëndëve të mbrojtura.

4. Nëse nuk arrihet marrëveshja gjatë negociatave të parapara në paragrafin 3. të këtij neni, palët e përfshira në negociata janë të obliguara të propozojnë ndërmjetësesin.

5. Në rast se ndërmjetësimi i paraparë në paragrafin 4. të këtij neni nuk rezulton me arritje të marrëveshjes, tarifat e përgjithshme sipas këtij neni i nënshtrohen miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

6. Në rast se nuk ekziston organizata e shfrytëzuesve të llojit të njëjtë të lëndëve të mbrojtura, shfrytëzuesi individual i nënshtrohet tarifave të përgjithshme të miratuara.

7. Tarifat e përgjithshme të aprovuara botohen në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

Neni 168
Rregullorja për shpërndarjen e të ardhurave

1. Kriteret dhe mënyra e shpërndarjes së kompensimeve që mbliidhen nga shfrytëzuesit e lëndëve të mbrojtura parashikohen me rregulloren për shpërndarjen e kompensimeve.
2. Kompensimet e mbledhura u shpërndahen bartësve të të drejtave, në përpjesëtim me hisen reale nga shfrytëzimi i lëndëve të tyre të mbrojtura në kompensimet gjithsej që shoqatat i kanë mbledhur nga shfrytëzimet e lëndëve të mbrojtura.
3. Me rastin e përcaktimit të hises së bartësve të të drejtave në kompensimet e mbledhura gjithsej merret parasysh kategoria e lëndëve të mbrojtura, rëndësia e tyre për zhvillimin kulturor e historik të shoqërisë, format dhe masat e shfrytëzimit të lëndës së mbrojtur si dhe faktorët e tjerë që do të pasqyronin në mënyrë sa më të përpiktë madhësinë e saj.
4. Rregulloren për shpërndarjen e kompensimeve e aprovon Kuvendi i Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.
5. Shpërndarjen e kompensimeve të mbledhura nga shfrytëzuesit e lëndëve të mbrojtura Shoqata e realizon së paku një herë në vit.
6. Shpërndarja duhet të mbështetet në të dhënat e sakta. Në mungesë të tyre, ose kur sigurimi i tyre do të ishte barrë e tepërt organizative dhe financiare, është e lejueshme mbështetja në vlerësimet e bazuara që rezultojnë në faktet e besueshme relevante.

Neni 169
Kostoja e Shoqatës për administrimin kolektiv të së drejtës

1. Në përputhje me statutin dhe në bazë të vendimit të bordit drejtues veçohet një pjesë e të ardhurave të grumbulluara për mbulimin e shpenzimeve të Shoqatës kolektive për administrim të të drejtave.
2. Shoqata në përputhje me statutin dhe vendimet e Kuvendit të Shoqatës themelon fondin për qëllime të aktiviteteve kulturore të rëndësishme së veçantë, kujdesit për shëndetin dhe statusin social të anëtarëve të vet.
3. Për fondin e paraparë në paragrafin 2. të këtij neni Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave ndan 10% nga shuma e tërësishme e mjeteve të grumbulluara, brenda një viti, nga shfrytëzuesit e lëndëve të mbrojtura.

Neni 170
Evidenca dhe llogaria

1. Shoqata për administrimin kolektiv të të drejtave obligohet të mbajë dhe të ruaj evidencat dhe dokumentet shoqëruese për të gjitha faktet relevante lidhur me mbledhjen e kompensimeve si dhe llogaritjen e hyrjeve dhe daljeve.
2. Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave i mban llogaritë sipas standardeve përkatëse.
3. Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave është e obliguar që për çdo vit të mëparshëm të hartojë raport vjetor të punës me të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse si dhe pasqyrimin e fakteve relevante. Ky raport iu vihet në dispozicion anëtarëve.
4. Të paktën tridhjetë (30) anëtarë të Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave mund të kërkojnë që një apo me shumë auditorë të pavarur të bëjnë auditimin financiar të punës së Shoqatës.

Neni 171
Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

1. Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta është organ administrativ i cili është themeluar dhe funksionon në kuadër të Ministrisë përkatëse për Kulturë.

2. Veprimtaria themelore e Zyrës përfshin:

2.1. dhënien e lejes shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;

2.2. marrjen e lejes së dhënë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave në rast të mos përmbushjes së kriteve të parapara me ligj;

2.3. mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe aktiviteteve të shoqatave për administrim kolektiv të të drejtave;

2.4. promovimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për dhënien e informatave të duhura autorëve, bartësve të të drejtave dhe opinionit të gjerë lidhur me të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta;

2.5. përcjelljen e legjislacionit ndërkombëtar dhe dhënien e rekomandimeve përkitazi me fushën e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Neni 172
Dhënia e lejes për administrim kolektiv të të drejtave

1. Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta i lëshon leje për administrimin e të drejtave kolektive shoqatës e cila:

1.1. ka selinë në Republikën e Kosovës;

1.2. posedon hapësirën përkatëse të punës si dhe shërbimin profesional më së paku një të punësuar me fakultet juridik të kryer;

1.3. administrimin kolektiv të të drejtave e ushtron si veprimtari të vetme;

1.4. administron të drejtat në emër të vet dhe për llogari të bartësve të të drejtave;

2. Kundër vendimit për mosdhënien e lejes nga ana e Zyrës, shoqata nuk ka të drejtë ankese, mirëpo në gjykatën kompetente mund të ngritët padi sipas dispozitave të procedurës administrative.

Neni 173
Marrja e lejes

1. Marrjen e lejes së dhënë shoqatave për administrimin kolektiv të të drejtave Zyra e bën nëse paraqiten rrethanat të cilat mund të jenë shkak për shkelje të rëndë të dispozitave të këtij ligji. Para marrjes së lejes Zyra e njofton Shoqatën për administrim kolektiv të të drejtave për arsyet dhe i jep afat kohor jo më pak se tridhjetë (30) ditë për të eliminuar shkakun për marrje të lejes.

2. Kundër vendimit për marrjen e lejes nga ana e Zyrës, Shoqata nuk ka të drejtë ankese, mirëpo në gjykatën kompetente mund të ngritët padi sipas dispozitave të procedurës administrative.

Neni 174
Detyrimi i shfrytëzimit për dhënien e informatave

1. Shfrytëzuesit e lëndëve të mbrojtura si dhe detyruesit e pagesës së kompensimit të veçantë janë të detyruar t'i mundësojnë Shoqatës për administrimin kolektiv të të drejtave dhe të kontrollojë përmbushjen e përpiktë dhe me kohë të kontratave të lidhura për administrim kolektiv.
2. Shfrytëzuesit e lëndëve të mbrojtura janë të detyruar ta njoftojnë Shoqatën për administrim kolektiv të të drejtave për titullin e lëndës së mbrojtur, shpeshhtësinë dhe vëllimin e shfrytëzimit të saj si dhe për rrethanat tjera ndikuese në llogaritjen e detyrimit të kompensimit që paguhet sipas tarifës, pavarësisht se lënda e mbrojtur shfrytëzohet në bazë të lejes së marrë apo në bazë të këtij ligji.
3. Në rastet kur nevojitet leja sipas këtij ligji, organizatorët e shfaqjeve publike, kulturore, artistike apo zbavitëse si dhe shfrytëzuesit e tjerë të lëndëve të mbrojtura, detyrohen të marrin leje paraprake nga Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave.
4. Nëse organizatori i shfaqjeve publike, kulturore, artistike apo zbavitëse si dhe shfrytëzuesit e tjerë të lëndëve të mbrojtura nuk posedon leje në kuptimin e paragrafit 3. të këtij neni organi kompetent i policisë së Republikës së Kosovës, me kërkesë të bartësit të së drejtës ose Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave, do të ndalojë shfaqjen publike, respektivisht shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur.
5. Shfrytëzuesit e lëndëve të mbrojtura, kur ato mund të shfrytëzohen pa qenë e nevojshme të bëhet kalimi i të drejtës, janë të detyruar që një herë në muaj t'i dërgojnë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave të dhënat për çdo formë dhe për çdo shpeshhtësi të shfrytëzimit.
6. Shërbyesit medial audiovizuel janë të detyruara t'i dërgojnë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave, një herë në muaj, raporte lidhur me emetimin e lëndëve të mbrojtura gjatë muajit të mëparshëm, duke paraqitur njëkohësisht listën e autorëve, të interpretuesve dhe të prodhuesve, titujt e lëndëve të mbrojtura si dhe shpeshhtësinë e shfrytëzimit të tyre.
7. Nëse organizatori i shfaqjeve publike, kulturore, artistike apo zbavitëse si dhe shfrytëzuesit tjerë të lëndëve të mbrojtura, përkatësisht shërbyesve medial audiovizuel, nuk i dorëzon informacionet në kuptim të paragrafit 5. dhe 6. të këtij neni, konsiderohet se ka shkelur të drejtat të cilat i administron Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave.
8. Pronari i veprës origjinale të arteve figurative, shtëpia aksionare, galeria ose agjenti tjetër detyrohet t'ia dërgojë Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave të dhënat për origjinalin e tjetërsuar, autorin e veprës, shitësin dhe pronarin e ri të veprës si dhe çmimin e shitjes së origjinalit, brenda tridhjetë (30) ditëve që nga dita e rishitjes.

Neni 175

Mbikëqyrja administrative e punës së Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave

1. Zyra do të mbikëqyrë nëse Shoqata kolektive kryen funksionet e veta në pajtim me dispozitat e ligjit.
2. Zyra në çdo kohë mund të kërkojë nga Shoqata kolektive çfarëdo lloj informatash ose dokumentesh lidhur me Shoqatën kolektive apo administrimin kolektiv të të drejtave, në përgjithësi apo në lidhje me një autor të caktuar, një vepër të caktuar ose përdorues, dhe mund të inspektojë librat ose çfarëdo dokumenti tjetër lidhur me Shoqatën kolektive ose administrimin kolektiv të të drejtave, përfshirë funksionimin dhe shpenzimin e fondeve speciale nëse ekzistojnë.
3. Zyra mund të urdhërojë Shoqatën kolektive të sigurojë raportin e kompanisë së auditimit lidhur me ndonjë çështje specifike dhe brenda një fushëveprimi të përcaktuar nga Zyra, por jo më shumë se një herë në vit, me shpenzime të Shoqatës kolektive.
4. Zyra mund të emërojë një ose më shumë përfaqësues të vet, të cilët marrin pjesë në takimet e asamblesë dhe organeve tjera të shoqatave kolektive me të drejtën për të folur, por pa pasur të drejtë të votojnë.

5. Zyra mund t'i lëshojë shoqatave kolektive udhëzime obligative.

Neni 176
Ndërmjetësimi

1. Shoqatat kolektive dhe përfaqësuesit e përdoruesve në bazë të një marrëveshjeje ndërmjetësuese mund të propozojnë ndërmjetësim në një kontest:

1.1. lidhur me konkludimet e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse;

1.2. lidhur me konkludimet e një marrëveshjeje për ritransmetimin kabllor të transmetimeve;

1.3. lidhur me:

1.3.1. përdorimin për të mirë të personave me të meta;

1.3.2. përdorimin me qëllim të mësimt;

1.3.3. riprodhimin privat apo të brendshëm;

1.3.4. performancën e punimeve zyrtare; dhe

1.3.5. incizimet kalimtare të bëra nga organizatat transmetuese;

1.3.6. marrëveshjen lidhur me përcaktimin e tarifave të përgjithshme.

2. Ndërmjetësuesi duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe jo i obliguar me instruksione.

3. Ndërmjetësuesi duhet të sigurojë se të gjitha palët kryejnë negociata me qëllim të mirë dhe nuk i pengojnë ato pa justifikime valide.

4. Ndërmjetësuesi palëve mund t'iu paraqesë propozime lidhur me zgjedhjen e konfliktit. Propozimi për zgjedhje duhet të synojë të jetë i pranuar nëse palët arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse ose marrëveshje për ritransmetim, brenda tre muajve pas pranimit të propozimit.

5. Konfidencialiteti duhet të sigurohet gjatë procedurave të ndërmjetësimt.

6. Palët bashkërisht do të zgjedhin ndërmjetësuesin nga lista e ndërmjetësuesve të caktuar nga Zyra.

7. Zyra duhet të ofrojë ndihmë administrative për ndërmjetësuesin.

8. Palët duhet ta kompensojnë ndërmjetësuesin për punën e tij.

9. Zyra duhet të definojë në hollësi procedurat e ndërmjetësimt, nivelin e kompetencës profesionale të ndërmjetësuesit si dhe kushtet tjera që duhet të përmbushë.

KREU XI
MBROJTJA E TË DREJTAVE

NËNKREU A
PERSONAT QË GËZOJNË MBROJTJE

Neni 177

1. Personi, të cilit i janë shkelur të drejtat që mbrohen me këtë ligj, mund të kërkojë mbrojtjen e të

drejtave të tij dhe zhdëmtim përkatës në varësi me shkeljen.

2. Mbrojtje e njëjtë e të drejtave mund të kërkohet edhe kur është i dukshëm rreziku i shkeljes së të drejtave të mbrojtura me këtë ligj.

3. Mbrojtja e parashikuar nga dispozitat tjera ligjore mbetet e paprekur.

Neni 178 Solidarësia e palëve

1. Kur janë më shumë se një bartës i një të drejte që u është shkelur e që njihet nga ky ligj secili prej tyre mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtës së tillë në tërësinë e saj.

2. Kur ekzistojnë më shumë se një shkelës të një të drejte të bartësit të të drejtës që njihet nga ky ligj secili prej tyre përgjigjet për dëmin e tërësishëm.

Neni 179 Mbrojtja e masave teknologjike

1. Konsiderohet se një person ka shkelur të drejtat ekskluzive që njihen nga ky Ligj nëse ka bërë çfarëdo veprimi për t'i shmangur masat teknologjike efektive.

2. Konsiderohet se një person ka shkelur të drejtat ekskluzive që njihen nga ky ligj, në rast se i punon, importon për shpërndarje, shet, jep me qira, reklamon për shitje a qiradhënie ose mban për qëllime komerciale teknologji, mjete ose programe kompjuterike, ose pa autorizim kryen shërbime, të cilat:

2.1. reklamohen a tregtohen enkas për shmangien e masave teknologjike efektive;

2.2. kanë qëllim të dukshëm komercial ose përdorim vetëm në aspektin e shmangies së masave teknologjike efektive;

2.3. janë dizajnuar, prodhuar, përshtatur apo punuar para së gjithash për shmangien e masave teknologjike efektive.

3. Në kuptim të paragrafit 2. të këtij neni, masë teknologjike është çdo teknologji, program kompjuteri a një mjet tjetër i cili është parashikuar që gjatë veprimit të vet normal të parandalojnë ose të pengojnë shkeljen e të drejtave të mbrojtura. Këto masa do të konsiderohen efektive aty ku hyrja ose përdorimi i veprës së autorit ose i lëndës nga të drejtat e afërta kontrollohet nëpërmjet proceseve të mbrojtjes me të cilat, në mënyrë operative dhe të besueshme dhe me autorizimin e bartësve të të drejtave, arrihen qëllimet e mbrojtjes.

4. Ky nen do të aplikohet ngjashëm dhe aq sa i takon mutatis mutandis edhe ndaj çdo teknologjie, mjeti apo programi kompjuterik, me të cilin informacionet elektronike të administrimit të të drejtave hiqen ose ndryshohen.

Neni 180 Mbrojtja e informacioneve të realizimit të të drejtave

1. Konsiderohet se një person ka shkelur të drejtat ekskluzive që mbrohet nga ky ligj kur bën një nga veprimet e mëposhtme, me të cilin nxit, mundëson, lehtëson ose fsheh shkeljet e të drejtave nga ky ligj siç janë:

1.1. heqja ose ndryshimi i cilit do informacion elektronik lidhur me administrimin e të drejtave;

1.2. riprodhimi, importi për shpërndarje, qiradhënia ose komunikimi publikut të një lënde të mbrojtur, në të cilën informacioni elektronik i administrimit të të drejtave është hequr apo

ndryshuar pa autorizim përkatës.

2. Informacion i administrimit të të drejtave në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni konsiderohet çdo informacion i futur nga ana e bartësit të të drejtës, me të cilin identifikohet lënda që është objekt i të drejtave, autori, bartësi i të drejtës, kohëzgjatja dhe kushtet e përdorimit, si dhe numrat dhe kodet e tyre përkatëse që shënohen në ekzemplarin e lëndës së mbrojtur ose që shfaqen me rastin e komunikimit të lëndës së mbrojtur.

NËNKREU B MBROJTJA GJYQËSORE

Neni 181 Kërkesëpaditë

1. Në rast të shkeljes së të drejtave ekskluzive të përcaktuara me këtë ligj, bartësi i të drejtës mund të kërkojë:

1.1. gjetjen e ekzistimit të shkeljes së të drejtave;

1.2. lëshimin e një vendimi, që ndalon vazhdimin e shkeljes dhe të shkeljeve të përsëritura në të ardhmen, si edhe disa akte përgatitore për shkeljet e tilla periodike;

1.3. mallrat që krijohen si rezultat i shkeljes së të drejtave, materialet dhe mjetet kryesisht të përdorura në krijimin apo fabrikimin e mallrave që shkelin të drejtat do të kërkojë që definitivisht të largohen nga tregu dhe të shkatërrohen, me shpenzime të shkelësit;

1.4. kompensim të dëmit material që nënkupton dëmin aktual dhe fitimin e humbur, ose zhdëmtim të posaçëm.

1.5. kompensim të dëmit jomaterial të shkaktuar si rezultat i shkeljes së të drejtave morale;

1.6. të bëhet shpallja e plotë apo pjesërisht e aktgjykimit nga gjykata, në masmedia, me shpenzime të shkelësit.

2. Dispozitat e nën-paragrafit 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni, për aq sa ndërlidhen me shkatërrimin, nuk aplikohen për objekte arkitekturore, përveç kur shkatërrimi i objektit arsyetohet nga rrethanat e rastit.

Neni 182 Zhdëmtimi i posaçëm

1. Në vend të kompensimit të dëmit material, bartësi i të drejtës mund të kërkojë që shkelësi t'ia dorëzojë gjithë fitimin e arritur me shkeljen e të drejtës.

2. Kur e drejta ekskluzive e paraparë me këtë ligj është shkelur me dashje apo nga pakujdesia e rëndë, bartësi i të drejtës mund të kërkojë pagesë të një shume apo shpërblim të caktuar për këtë lloj përdorimi, dhe atë në vlerë të dyfishtë nga kjo shumë, pa marrë parasysh, nga dëmi aktual i shkaktuar nga ai si pasojë e kësaj shkeljeje. Nëse një shkelje e tillë është kryer për qëllim të përfitimit pasuror, bartësi i të drejtës mund të kërkojë pagë apo shpërblim në vlerë të trefishtë nga shuma e tillë.

3. Nëse dëmi material është më i madh se zhdëmtimi në kuptimin e paragrafëve paraprak titullari i të drejtës ka të drejtë të kërkojë diferencën deri në kompensim të plotë të dëmit.

Neni 183 Zhdëmtimi monetar i dëmit jomaterial

Pa marrë parasysh zhdëmtimin material nga ana e shkelësit, autori apo interpretuesi ka të drejtë të kërkojë zhdëmtim të duhur monetar për shkak të shkeljeve të të drejtave morale të tij.

Neni 184 **Masat paraprake**

1. Në rast se bartësi i të drejtës paraqet provat e bazuara se e drejta e tij ekskluzive sipas këtij ligji është shkelur dhe se zhdëmtimi ka gjasa të rrezikohet gjykata mundet, me kërkesë të bartësit të së drejtës, të urdhërojë konfiskimin e përkohshëm të pronës së luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pandehur, duke përfshirë edhe bllokimin e llogarive të tij bankare dhe pasuritë tjera.

2. Kjo masë përfshin edhe mundësinë e gjykatës që të urdhërojë dhe sekuestrojë dokumentet bankare financiare apo dokumentet komerciale të shkelësit, apo qasje të duhur në informatë përkatëse.

3. Në rast se bartësi i të drejtës ka prova të bazuara se vonesa në marrjen e masave të përkohshme nga paragrafi 1. dhe 2. mund t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm, apo nëse këto masa mund të mos jenë efektive më vonë, gjykata mund të urdhërojë dhe të ekzekutojë masa të tilla pa njoftim paraprak dhe dëgjim të palës tjetër inaudita altera parte.

4. Procedura lidhur me masat paraprake zbatohet brenda tri (3) ditëve pas parashtrimit të kërkesës.

Neni 185 **Masat e përkohshme**

1. Në rast se bartësi i të drejtës paraqet prova të bazuara se i është shkelur e drejta e tij në përputhje me këtë ligj, apo nëse ekziston rreziku i pashmangshëm nga shkelja, gjykata mundet, me kërkesë të bartësit të të drejtës, të urdhërojë ndonjë masë të përkohshme e cila është e pranueshme për të siguruar kërkesën e bartësit të të drejtës:

1.1. ndalesën e shkeljeve të pritura apo ndalesën e vazhdimit të kryerjes së shkeljes së supozuar;

1.2. konfiskimin ose heqjen nga qarkullimi të mallrave, të dyshuar për shkeljen e një të drejte sipas këtij ligji, për të parandaluar hyrjen e tyre në treg;

1.3. konfiskimin ose heqjen nga qarkullimi të materialeve dhe mjeteve që kryesisht përdoren në punimin apo fabrikimin e mallrave të dyshimta që shkelin të drejtën sipas këtij ligji.

2. Në rast se bartësi i të drejtës paraqet prova të bazuara se vonesa në marrjen e masave të përkohshme nga paragrafi 1. i këtij neni ka gjasa që atij t'i shkaktojë dëm të pariparueshëm, apo nëse këto masa mund të mos jenë efektive më vonë, gjykata mund të urdhërojë dhe të ekzekutojë ato masa pa njoftim paraprak dhe dëgjim të palës së tretë inaudita altera parte.

3. Procedurat për urdhëresën e masave parandaluese janë të përshpejtuara. Gjykata urdhëron ndërmarrjen e masave të përkohshme brenda shtatë (7) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

4. Në rast të kërkesëpadisë për shkak të mos pagesës së kompensimit, gjykata mund të nxjerrë si masë të përkohshme ndalesën e shfrytëzimit të mëtutjeshëm të lëndës së mbrojtur.

Neni 186 **Sigurimi i provave**

1. Me kërkesë të bartësit të së drejtës, i cili ka prova të bazuara se i është shkelur e drejta ekskluzive që njihet nga ky ligj dhe që ekziston rreziku i mundshëm që provat për shkeljen e të drejtës të shkatërrohen ose që më vonë të jetë e pamundur të sigurohen, gjykata mund të urdhërojë ruajtjen dhe

sigurimin e provave.

2. Masat për ruajtjen e provave mund të përfshijnë përshkrimin e hollësishëm të mallrave që shkelin të drejtat, marrjen e mostrave, ose konfiskimin fizik të mallrave që shkelin të drejtat, inspektimin e vendeve, inspektim ose konfiskimin e dokumenteve, inventarit, bazat e të dhënave ose artikuj të tjerë që kanë vlerë dëshmuese në lidhje me shkeljen, ekzaminimin e dëshmitarëve, emërimin dhe ekzaminimin e ekspertëve.

3. Nëse bartësi i të drejtës ka prova të bazuara për vonesë të marrjes së masave nga paragrafi 2. i këtij neni dhe ka gjasa që atij t'i shkaktohet dëm i pariparueshëm, apo se ekziston rreziku evident për shkatërrim të provës, gjykata mund të urdhërojë dhe të ekzekutojë masat e tilla pa njoftim paraprak dhe dëgjim të palës tjetër inaudita altera parte.

4. Urdhri i gjykatës për caktimin e masave për ruajtjen e provave pa njoftim paraprak dhe dëgjim të palës së tretë i dorëzohet palës tjetër në kohën kur këto masa të ekzekutohen apo, nëse kjo do të jetë e mundur, sa më parë pas ekzekutimit të masave.

5. Procedurat lidhur me sigurimin e provave zbatohet brenda shtatë (7) ditësh pas parashtrimit të kërkesës.

6. Në rastet kur konstatohet se kërkesa e bartësit të të drejtës për ruajtjen e provës ka qenë e pa bazuar, apo se bartësi i të drejtës nuk e ka arsyetuar atë, pala tjetër ka të drejtë të kërkojë:

6.1. kthimin e sendeve të sekuestruara;

6.2. ndalimin e përdorimit të informatës të marrë përmes ekzekutimit të masave sipas këtij neni;

6.3. kompensimin për çfarëdo lëndimi të shkaktuar nga ato masa.

7. Në procedurat për ruajtjen e provës sipas këtij neni, gjykata do të kujdeset që informata konfidenciale e palëve të mbrohet, dhe se procedurat e tilla të mos përdoren për qëllime të këqija, me të vetmin qëllim që të merret informata konfidenciale nga pala tjetër.

Neni 187 Shpejtimi i procedurës

Procedura lidhur me shkeljen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta është e shpejtë. Gjykata do të caktojë seancën e parë të dëgjimit jo më vonë se brenda tre (3) muajve që nga dita e pranimit të kërkesëpadisë.

Neni 188 Kompetenca

Për proceset lidhur me shkeljen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta vendos gjykata kompetente.

NËNKREU C MASAT PËR ZBATIMIN E MBROJTJES

Neni 189 Detyrimi për dhënie informacioni

1. Gjatë procedurave përkitazi me shkeljet e të drejtave të njohura me këtë ligj, dhe në përgjigje të kërkesës së arsyetuar nga parashtruesi i kërkesës, gjykata mund të urdhërojë që shkelësi të jep

informacion të plotë mbi origjinën dhe rrjetet e shpërndarjes së mallrave ose shërbimeve ndëshkuese.

2. Gjykata mund të urdhërojë që informacioni, që i referohet paragrafit 1. të këtij neni, të sigurohet edhe nga ndonjë person tjetër i cili:

2.1. posedon mallrat që shkelin të drejtat në shkallë komerciale;

2.2. shfrytëzon shërbime që shkelin të drejtat në shkallë komerciale;

2.3. ofron shërbime në shkallë komerciale në shfrytëzim të aktiviteteve që shkelin të drejtat;

2.4. paraqitet nga ana e cilitdo person nga nën-paragrafët 2.1., 2.2. dhe 2.3. të këtij paragrafi, që është i përfshirë në prodhimin, shpërndarjen e mallrave apo dhënien e shërbimeve që shkelin të drejtat.

3. Secili person që nuk plotëson obligimin në ofrimin e informacionit sipas dispozitave të këtij neni do të jetë përgjegjës për dëmet që do të mund të shkaktohen nga dështimi për të përmbushur detyrimin.

KREU XII DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 190

1. Me gjobë prej dymijë (2.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro dënohet personi juridik, nëse në kuadër të veprimtarisë së vet ose në biznes me të tjerët, shfrytëzon pa leje veprën e autorit ose lëndën nga të drejtat e përafërta.

2. Me gjobë prej pesëqind (500) deri në dymijë (2.000) Euro dënohet personi përgjegjës i personit juridik kur kryen kundërvajtjen e përmendur në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 191

1. Me gjobë prej pesëmijë (5.000) deri në njëzetepesëmijë (25.000) Euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik, nëse në kuadër të veprimtarisë ose bashkëpunimin të biznesit:

1.1. kryen cilindo veprim të shmangies të masave efektive teknologjike të mbrojtjes;

1.2. kryen veprimin e heqjes apo të ndryshimit të informacionit elektronik të realizimit të të drejtave.

2. Me gjobë prej njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro dënohet personi i cili kryen kundërvajtjen e përcaktuar në paragrafin 1. të këtij neni.

Neni 192

1. Me gjobë prej jo më pak se pesëqind (500) deri njëzetepesëmijë (25.000) Euro dënohet për kundërvajtje çdo person juridik:

1.1. që nuk i dorëzon shoqatës kolektive kompetente informacionin lidhur me llojet dhe numrin e pajisjeve të shitura ose të importuara për fiksime vizuale ose të zërit, pajisjet fotokopjuese, transmetuesit bosh të zërit apo të imazhit, si dhe informacionin mbi fotokopjet e shitura të cilat janë të nevojshme për llogaritjen e kompensimit të veçantë;

1.2. që nuk i dorëzon shoqatës kolektive kompetente raporte ose informacione apo programe në mënyrën dhe afatet, siç është përcaktuar nga ky ligj, të rëndësishme për llogaritjen

e kompensimit të veçantë;

2. Me gjobë prej jo më së paku se njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5.000) Euro dënohet personi që kryen kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 193

1. Me gjobë prej së paku katërmijë (4.000) deri në njëzetmijë (20.000) Euro, dënohet për kundërvajtje Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave, nëse:

1.1. nuk mban apo në mënyrë neglizhente operon me të dhënat dhe kontabilitetin;

1.2. nuk ia përcjellë bartësit të të drejtës të ardhurat që i takojnë nga kompensimet e mbledhura prej shfrytëzuesve të lëndëve të mbrojtura;

1.3. nuk e zbaton kërkesën për auditimin e veprimtarisë financiare nga ana auditorëve të pavarur;

1.4. nuk i kryen detyrimet ndaj Zyrës ose nuk i zbaton masat që kjo Zyrë i ka urdhëruar për mënjanimin e parregullsive në punë.

2. Me gjobë prej jo më pak se njëmijë (1.000) deri pesëmijë (5.000) Euro, dënohet për kundërvajtje nga paragrafi 1. i këtij neni edhe personi përgjegjës i Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave.

Neni 194

Gjësendet e përfituara me kryerjen e kundërvajtjeve nga nenet e lartcekura konfiskohen.

Neni 195

Procedura për kundërvajtje fillon me kërkesën e organit të inspektimit, policisë, palës së dëmtuar, Shoqatës për administrim kolektiv të të drejtave ose të Zyrës.

KREU XIII MBROJTJA E PERSONAVE TË HUAJ

Neni 196

1. Personat e huaj fizikë ose juridikë gëzojnë mbrojtjen e njëjtë të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta sikurse edhe personat vendas, nëse kështu parashihet me marrëveshje ndërkombëtare apo më këtë ligj, ose në rast se ekziston reciprociteti faktik.

2. Autorët dhe interpretuesit e huaj gëzojnë mbrojtje të njëjtë të të drejtave morale që njihen nga ky ligj.

3. Autorët e huaj të veprave të artit gëzojnë mbrojtjen e këtij ligji sa i përket rishitjes të të drejtës vetëm në rast se ekziston reciprociteti faktik.

Neni 197 Autorët

1 Mbrojtjen sipas këtij ligji e gëzojnë autorët e huaj:

1.1. të cilët kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë;

1.2. përkitazi me veprat e tyre të publikuara për herë të parë në Kosovë apo brenda tridhjetë

(30) ditëve pasi të jenë publikuar në ndonjë vend tjetër;

1.3. përkitazi me veprat e publikuara për herë të parë në Kosovë;

1.4. përkitazi me veprat e arkitekturës dhe të arteve figurative, të cilat në territorin e Republikës së Kosovës janë patundshmëri ose janë pjesë integrale e një patundshmërie.

2. Nëse vepra e autorit është krijuar nga disa autorë, ata të gjithë gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji edhe kur vetëm njëri prej tyre i plotëson kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 198 Interpretuesit

1. Mbrojtjen sipas këtij ligji e gëzojnë interpretuesit e huaj:

1.1. që kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë;

1.2. interpretimi i tyre bëhet në territorin e Republikës së Kosovës;

1.3. interpretimi i të cilëve është i fiksuar në fonograme, i cili gëzon mbrojtje me këtë ligj;

1.4. interpretimi i tyre i pafiksuar në fonogram është përfshirë në emision radioteleviziv që gëzon mbrojtje sipas këtij ligji;

2. Nëse interpretimi është krijuar nga disa interpretues ata të gjithë gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji, edhe kur vetëm njëri prej tyre i plotëson kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni.

Neni 199 Bartësit tjerë të huaj të të drejtave të përafërta

1 Mbrojtjen me këtë ligj e gëzojnë bartësit e tjerë të huaj të të drejtave të përafërta që kanë vendbanim të përhershëm apo seli të korporatës të regjistruar në Republikën e Kosovës.

2. Mbrojtjen sipas këtij ligji e gëzon prodhuesi i fonogramit, përkatësisht producenti i filmit nëse fonogrami ose filmi i tyre është bërë së pari në Republikën e Kosovës.

3. Mbrojtjen sipas këtij ligji e gëzon botuesi sa i përket të drejtave të tyre të përafërta, nëse edicioni i tij është publikuar së pari në Republikën e Kosovës ose brenda tridhjetë (30) ditëve pas publikimit në një vend tjetër.

4. Mbrojtjen sipas këtij ligji e gëzon transmetuesi emisionet e të cilit transmetohen nëpërmjet rrjetit transmetues që është në territorin e Republikës së Kosovës.

5. Mbrojtjen sipas këtij ligji e gëzon prodhuesi i bazës së të dhënave nëse kjo bazë është bërë për herë të parë në Republikën e Kosovës.

Neni 200 Komunikimi me publikun përmes satelitit

1. Mbrojtje sipas këtij ligji gëzojnë autorët dhe bartësit e të drejtave të përafërta kur vepra e tyre ose lënda nga të drejtat e përafërta i komunikohet publikut me anë të satelitit nga territori i Republikës së Kosovës dhe nën kontrollin dhe përgjegjësinë e shërbyesit medial audiovizuel dërgohen sinjalet përkatëse të programit në një zinxhir të pashkëputur komunikimi që shpie deri te sateliti dhe prapa në tokë.

2. Mbrojtja sipas këtij ligji ekziston edhe kur nuk përmbushet kushti nga paragrafi 1. i këtij neni, me

kusht që:

- 2.1. në Kosovë gjendet pika e lidhjes marrëse nga e cila drejtohet transmetimi i sinjaleve të programit; ose
- 2.2. shërbyesve medial audiovizuel që kryen komunikimin me publikun përmes satelitit e ka selinë e korporatës të regjistruar në Kosovë.

Neni 201 Krahasimi i afateve të mbrojtjes

Për bartësit e huaj të të drejtave të përfaqësuara që gëzojnë mbrojtje sipas këtij ligji vlejshëm afatet e mbrojtjes të caktuara me këtë ligj, por skadojnë më së voni në ditën kur skadon mbrojtja në shtetin që i përkasin si shtetas ose ku kanë vendbanimin apo selinë dhe nuk mund të zgjasin më shumë se afatet e parapara sipas këtij ligji.

Neni 202 Personat pa shtetësi dhe refugjatët

1. Autorët dhe bartësit e të drejtave të përfaqësuara që nuk kanë shtetësi ose kur ajo nuk mund të verifikohet, gëzojnë mbrojtje të njëjtë sikurse bartësit vendorë të të drejtave, nëse kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë.
2. Nëse nuk kanë vendbanim të përhershëm apo vendbanimi nuk mund të verifikohet gëzojnë mbrojtje të njëjtë sikurse bartësit vendorë të të drejtave, nëse kanë vendbanim të përkohshëm në Kosovë.
3. Nëse në Kosovë nuk kanë as vendbanim të përhershëm dhe as vendbanim të përkohshëm gëzojnë mbrojtje në Kosovë sikurse qytetarët e shtetit në të cilin e kanë vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm të tyre.
4. Dispozitat e këtij neni vlejshëm njëjtë si për autorët ashtu edhe për bartësit e të drejtave të përfaqësuara, të cilët në përputhje me traktatet ndërkombëtare ose me Ligjin e Kosovës gëzojnë statusin e refugjatit.

Neni 203 Reciprociteti faktik

Reciprocitetin duhet ta dëshmojë ai i cili thirret në të.

KREU XIV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 204

1. Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha veprave të autorit, ndaj të gjitha interpretimeve të interpretuesve si dhe të gjitha emitimeve të të gjithë shërbyesit medial audiovizuel që, deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë gëzuar mbrojtje në bazë të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të Përfaqësuara nr.2004/45.
2. Ky ligj zbatohet ndaj fonogrameve dhe incizimeve të fiksuara mbi të, nëse nga fiksimi, përkatësisht botimi ligjor si dhe nga vënia në dispozicion publikut, nuk kanë kaluar pesëdhjetë (50) vite, duke llogaritur nga fillimi i vitit kalendarik në të cilin ka hyrë në fuqi ky ligj.
3. Ky ligj zbatohet ndaj videogrameve, emisioneve të shërbyesve medial audiovizuel dhe botimeve të botuesve, nëse për herë të parë janë fiksuar, transmetuar ose botuar në mënyrë të ligjshme pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

4. Procedurat e filluara por të papërfunduara lidhur me mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta do të vazhdojnë sipas dispozitave procedurale të këtij ligji.

5. Kontratat për kalimin e të drejtave, të lidhura para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk mund të ndryshohen me justifikim se duhet të jenë në përputhje me këtë ligj.

6. Të gjitha të drejtat e fituara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbeten të paprekshme, kurse aktet normative të shoqatave për administrimin kolektiv të të drejtave zbatohen edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe harmonizohen me dispozitat e të njëjtit në afat prej gjashtë (6) muajsh nga hyrja në fuqi.

7. Dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me programet kompjuterike dhe bazat e të dhënave zbatohen edhe në programet kompjuterike dhe në bazat e të dhënave që janë krijuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, nëse me këtë nuk preken kontratat e lidhura dhe të drejtat e fituara para kësaj dite.

8. Me pranimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, shfrytëzimi i të drejtës për shpërndarje, e referuar në paragrafin 2. të nenit 24 të këtij ligji, do të aplikohet për çfarëdo shitje të parë ose transfer tjetër të pronësisë në një kopje origjinale ose kopje të punës, të bërë kudo në Bashkimin Evropian ose në Zonën Ekonomike Evropiane.

Neni 205

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për të drejtat e Autorit dhe të drejtat tjera të përafërta Nr. 2004/45 si dhe aktet nënligjore që burojnë nga ky ligj.

Neni 206 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-065
21 tetor 2011**

Ligji shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 80 paragrafi 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

LIGJI Nr. 05/L -047**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-065 PËR TË DREJTAT E AUTORIT
DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr.04/L-065 PËR TË DREJTAT E
AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA****Neni 1****Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta me qëllim të harmonizimit me direktivat e Bashkimit Evropian të fushës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

2. Ky ligj është në përputhshmëri të plotë me këto direktiva të Bashkimit Evropian: Direktivën 98/83/EEC e datës 27 shtator 1993 e cila ka synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllorë (OJ L 248, 06/10/1993), Direktivën 2001/29/EC të datës 22 maj 2001 mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë e informacionit (OJ L 167, 22/06/2001), Direktivën 2001/84/CE e datës 27 shtator 2001, mbi të drejtën e rishitjes, respektivisht përfitimin e autorit të një vepre origjinale të artit (OJ L 272, 13/10/2001), Direktivën 96/9/EC e datës 11 mars 1996, mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, (OJ L 077, 27/03/1996), Direktivën 2006/115/EC e datës 12 dhjetor 2006, për drejtat mbi qiradhënien dhe huazimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave e përafërta në fushën e të drejtave pronësore intelektuale (OJ L 376, 27/12/2006), Direktivën 2004/48/EC e datës 29 prill 2004, mbi zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale, (OJ L 195, 02/06/2004), Direktivën 2009/24/EC versioni i kodifikuar e datës 23 prill 2009 e cila ka harmonizuar legjislacionin Evropian në lidhje me mbrojtjen e programeve kompjuterike (OJ L 111, 05/05/2009), Direktivën 2011/77/EU të datës 27 shtator 2011 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, (OJ L 265, 11/10/2011, p. 1 – 5), e cila direktivë ka ndryshuar Direktivën 2006/116/EC e datës 12 dhjetor 2006 (OJ L 372, 27/12/2006, p. 12-18), Direktivën 2012/28/EU e datës 25 tetor 2012 mbi përdorimin e lejueshëm të veprave jetime, (OJ L 299, 27/10/2012).

Neni 2

Në nenin 4 të ligjit bazik pas nënparagrafit 1.19, shtohen paragrafët 1.20. dhe 1.21.me tekstin si në vijim:

1.20. **Satelit** - do të thotë çfarëdo sateliti që vepron në breza frekuencash, të cilat sipas Ligjit të telekomunikacioneve, janë rezervuar për transmetimin e sinjaleve të kapshme nga publiku ose të cilat janë rezervuar për komunikim të mbyllur, bazë-bazë (nga një pikë në një tjetër). Megjithatë, në rastin e fundit, në rrethanat në të cilat ndodh, pranimi individual i sinjaleve duhet të jetë i krahasueshëm me ato që zbatohen në rastin e parë.

1.21.Ritransmetim kabllor - është ritransmetimi i njëkohshëm, i pandryshuar dhe i pandërprerë të publiku, nëpërmjet sistemit me tel, mediumet optike dhe mikrovalore për marrjen nga publiku të transmetimit që vjen nga një organizatë tjetër transmetuese.

Neni 3

Në nenin 8 të ligjit bazik, pas nënparagrafit 2.13 shtohet nënparagrafi 2.14, me tekstin si në vijim:

2.14. Mbrojtja me këtë ligj e programeve kompjuterike dhe materialeve të tyre modeluese përgatitore, aplikohet edhe në çdo shprehje e në çdo formë të një programi kompjuterik. Idetë dhe parimet, që qëndrojnë pas cilit do element të një programi kompjuterik, përfshirë ato që qëndrojnë pas ndër veprueshmërisë së tij, nuk mbrohen nga e drejta e autorit. Një program kompjuterik mbrohet në rast se është origjinal në kuptimin që, është krijim intelektual personal i autorit.

Neni 4

Në nenin 12 të ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.8, shtohet nënparagrafi i ri 1.9 me tekstin si në vijim:

1.9. Lajmet e ditës dhe informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të mediave mund të riprodhohen vetëm pasi të kenë kaluar së paku dymbëdhjetë (12) orë nga publikimi i tyre.

Neni 5

Pas nenit 12 të ligjit bazik shtohen katër nene të reja, neni 12A, 12B, 12C dhe neni 12D, me tekstin si në vijim:

Neni 12A

Veprat jetime

1. Një vepër ose një fonogram konsiderohet si vepër jetime, në rast se asnjëri nga mbajtësit e të drejtave në atë vepër apo fonogram nuk është i identifikuar, apo edhe nëse një ose më shumë prej tyre janë të identifikuar, por asnjëri prej tyre nuk gjendet pavarësisht se është bërë kërkim i plotë dhe i arsyeshëm për mbajtësit e të drejtave dhe është regjistruar në përputhje me nenin 12B.

2. Kur ka më shumë se një mbajtës të drejtave në një vepër ose fonogram dhe jo të gjithë janë identifikuar, ose janë identifikuar, por nuk gjenden edhe pas një kërkimi të plotë dhe të regjistruar sipas nenit 12B, vepra ose fonogrami mund të përdoren në përputhje me këtë ligj, në rast se mbajtësit e të drejtave të identifikuar dhe të gjetur kanë autorizuar organizatën e referuar në paragrafin 6, të kryejë veprimet e riprodhimit dhe vënies në dispozicion të publikut, ashtu si është parashikuara në mënyrë specifike në nenet 23 dhe 33 të këtij ligji.

3. Paragrafi 2, nuk paragjykon të drejtat e mbajtëseve të të drejtave të identifikuar dhe të gjetur, mbi veprën ose fonogramin.

4. Neni 12D aplikohet mutatis mutandis ndaj mbajtësve e të drejtave që nuk janë identifikuar dhe gjetur në veprat e përmendura në paragrafin 2.

5. Organizatat që mund të përdorin veprat jetime janë bibliotekat, institucionet arsimore dhe muzetë që ofrojnë qasje publike, si dhe nga arkivat, institucionet e trashëgimisë audio apo të filmit dhe organizatat publike transmetuese, të themeluara në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të përmbushin qëllimet e tyre lidhur me misionin e interesit publik.

6. Veprat që mund të konsiderohen si vepra jetime janë:

6.1. Veprat e publikuara në formën e librave, revistave profesionale, gazetave, revistave ose shkrime të tjera pjesë e përmbledhjeve në biblioteka, institucione arsimore dhe muzetë që ofrojnë qasje publike, si dhe në përmbledhjet e arkivave, të institucioneve të trashëgimisë së filmit apo audio;

6.2. Veprat kinematografike ose audiovizuale dhe fonogramët që janë pjesë e përmbledhjeve të bibliotekave, institucione arsimore dhe muzeve që ofrojnë qasje publike, si dhe përmbledhje në arkivat ose në institucionet e trashëgimisë audio apo të filmit; dhe

6.3. Veprat kinematografike ose audiovizuale dhe fonogramet të prodhuara nga organizatat transmetuese publike deri më 31 dhjetor 2002 përfshirë edhe ato të cilat janë pjesë e arkivave të tyre, të cilat mbrohen nga e drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura dhe të cilat janë publikuar për herë të parë në Republikën e Kosovës ose, në mungesë të publikimit, transmetimi i parë është bërë në Republikën e Kosovës.

7. Mund të konsiderohen vepra jetime, veprat dhe fonogramet e përmendura në paragrafin 6, të cilat nuk janë publikuar ose transmetuar kurrë por, të cilat janë bërë të qasshme për publikun nga organizata e përmendur në paragrafin 5 me miratimin e mbajtësit të të drejtave, me kusht që të jetë e arsyeshme të mendohet që, mbajtësit e të drejtave nuk do të kundërshtojnë përdorimet e përcaktuara në nenin 59A. Ky paragraf do të aplikohet të veprat dhe fonogramet të cilat janë depozituar tek këto organizata përpara datës 29 tetor 2014.

8. Mund të konsiderohen vepra jetime, veprat dhe lëndët e tjera të mbrojtura, të cilat janë të trupëzuara ose bashkangjitura, ose përbëjnë pjesë integrale të veprave ose fonogrameve të përmendura në paragrafët 6 dhe 7.

Neni 12B

Kërkim i plotë

1. Me qëllim përcaktimin nëse një vepër apo fonogram është një vepër jetime, organizatat e përmendura në nenin 12A, paragrafi 5, duhet sigurojnë në mirëbesim, që është kryer një kërkim i plotë lidhur me secilën vepër ose lëndë tjetër të mbrojtur, duke konsultuar burimet e duhura për kategorinë e veprave dhe lëndëve të tjera të mbrojtura në fjalë. Kërkimi i plotë kryhet përpara përdorimit të veprës ose fonogramit.

2. Nëse ka fakte që, sugjerojnë se informacioni përkatës mbi mbajtësit e të drejtave mund të gjendet në shtetet e tjera, burimet e informacionit të disponueshme në këto

shtete e tjera gjithashtu duhet të konsultohen.

3. Organizatat e përmendura në nenin 12A paragrafi 5, obligohen të mbajnë evidencë për kërkimet e plota të kryera dhe të dorëzojnë këtë informacion në Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përkatësisht informacionin e mëposhtëm:

3.1. rezultatet e kërkimeve të plota që organizatat kanë kryer, kërkime të cilat kanë çuar në konkluzionin se një vepër ose fonogram konsiderohet vepër jetime;

3.2. përdorimin që i bën organizata veprës jetime në përputhje me këtë ligj;

3.3. në përputhje me nenin 12D, çdo ndryshim i statusit të veprës jetime, të veprave ose fonogrameve që organizatat përdorin;

3.4. informacionin e kontaktit të organizatës përkatëse.

Neni 12C

Burimet e kërkimit të plotë

1. Burimet që duhet konsultohen për të kryer kërkimin e plotë të paraparë në nenin 12B, për kategorinë përkatëse të veprave janë:

1.1. për librat e publikuara:

1.1.1. deponimet ligjore, katalogët e bibliotekave dhe dokumentacionin që kanë në dispozicion bibliotekat dhe institucionet tjera;

1.1.2. shoqatat e botuesve dhe autorëve në Republikën e Kosovës;

1.1.3. bazat e të dhënave dhe regjistrat si WATCH (Shkrimtarët, Artistët dhe mbajtësit e të drejtave të tyre të autorit), ISBN (Numri Standard Ndërkombëtarë i Librit) dhe bazat e të dhënave që i listojnë librat e shtypura;

1.1.4. bazat e të dhënave të shoqatave për administrim kolektiv, përkatësisht shoqatave që mbajnë të drejtat e riprodhimit;

1.1.5. burimet që përmbajnë bazat e të dhënave dhe regjistrat, përfshirë VIAF (Autoriteti Ndërkombëtarë i Dokumenteve Virtuale) dhe ARROW (Regjistrat me Qasje në Informacionin e Drejtave dhe Veprave Jetime).

2. Për gazeta, revista, revista profesionale dhe publikime periodike:

2.1. ISSN (Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Serike) për publikimet periodike;

2.2. indekset dhe katalogët nga bibliotekat dhe koleksionet;

2.3. deponimet ligjore, përkatësisht të bibliografive kombëtare dhe të veçanta;

2.4. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mirëmbajtur nga shoqatat e botuesve dhe shoqatat e gazetarëve në Republikën e Kosovës;

2.5. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i shoqatave për administrim kolektiv, përfshirë organizatat e të drejtave të riprodhimit.

3. Për veprat virtuale, përfshirë veprat e arteve të bukura, fotografinë, ilustrimin, dizajnin, arkitekturën, skeçet e veprave të përmendura së fundi, si dhe veprat që janë pjesë e librave, revistave profesionale, gazetave dhe revistave ose pjesë e veprave tjera:

3.1. burimet e përmendura në paragrafin 1 dhe 2;

3.2. bazat e të dhënave dhe dokumentacionin e shoqatave për administrim kolektiv, përkatësisht për artet pamore, dhe duke përfshirë edhe organizatat e të drejtave të riprodhimit;

3.3. bazat e të dhënave të shoqatave të fotografisë, kur janë të aplikueshme.

4. Për veprat audio-vizuale dhe fonograme:

4.1. deponimet ligjore;

4.2. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni që kanë shoqatat e prodhuesve në Republikën e Kosovës;

4.3. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni për film dhe fonograme të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe bibliotekave kombëtare;

4.4. bazat e të dhënave me standarde dhe identifikues si ISAN (Standardi Ndërkombëtarë i Numrit Audio-vizual), për material audio-vizual, ISWC (Standardi Ndërkombëtarë i Kodit për Veprat Muzikore) për fonograme;

4.5. bazat e të dhënave dhe dokumentacionin e shoqatave për administrim kolektiv, përkatësisht për autorë, interpretues, prodhues të fonogrameve dhe prodhues të materialit audio-vizual;

4.6. meritat dhe informatat tjera që janë të shkruara në paketimin e veprës ose lëndës së mbrojtur me drejtat e përafërta;

4.7. bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i shoqatave tjera relevante që përfaqësojnë kategori specifike të mbajtësve të të drejtave.

Neni 12D

Përfundimi i statusit të veprës jetime

Statusi i veprës jetime do të përfundojë në rast se mbajtësi i të drejtës së autorit bëhet i njohur ose i gjendet vendndodhja.

Neni 6

Neni 23 i ligjit bazik, paragrafët 1 dhe 2 riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Autori ka të drejtën ekskluzive të lejoj ose ndalojë riprodhimin e veprës së tij.

2. "Riprodhimi" është bërja e një ose më shumë kopjeve të një vepre apo objekti të të drejtave të përfaqëta, qoftë drejtpërdrejtë apo tërthorazi, dhe në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, në çfarëdo lloj forme, në formë të plotë apo të pjesëshme, përfshirë çdo regjistrim audio ose video, dhe ruajtje të përkohshme apo të përhershme të veprës apo objektit të të drejtave të përfaqëta në një medium elektronik.

Neni 7

Në nenin 25 të ligjit bazik, paragrafit 1 i shtohet teksti si në vijim:

Kjo e drejtë nuk shuhet nga shitja apo çdo akt tjetër i shpërndarjes së veprave origjinale ose kopjeve të tyre.

Neni 8

Në nenin 36 të ligjit bazik, pas paragrafit 6 shtohet paragrafi 7, me tekstin si në vijim:

7. Për një periudhë tre (3) vjeçare pas rishitjes, autori ose organizata e administrimit kolektiv mund të kërkojë nga çdo person në paragrafin 2, informacion që mund të jetë i nevojshëm, për të siguruar pagesën e shpërblimit lidhur me rishitjen e parashikuar në këtë nen.

Neni 9

Në nenin 37 të ligjit bazik, paragrafit 1 i shtohet teksti si në vijim:

Kjo e drejtë nuk shuhet nga shitja apo çdo akt tjetër i shpërndarjes së veprave origjinale ose kopjeve të tyre.

Neni 10

Neni 44 i ligjit bazik, paragrafi 3, riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Lejohet që pa lejen e autorit dhe pa pagesë, një bibliotekë jo-fitim prurëse, muze, arkiv dhe institucion arsimor dhe shkencor, të riprodhojë një kopje shtesë nga një kopje e veprës e cila gjendet tashmë në koleksionin e përhershëm të tyre, nëse qëllimi është të zëvendësojë kopjet që kanë humbur, janë shkatërruar ose janë bërë të papërdorshme, apo për të bërë një kopje të disponueshme për bibliotekat e tjera apo shërbimet arkivore të ngjashme në mënyrë që të zëvendësojnë nga koleksionet e tyre kopjet që kanë humbur, janë shkatërruar ose janë bërë të papërdorshme, në rastet kur është e pamundur të marrin kopje të veprës për mes formave të zakonshme komerciale.

Neni 11

Neni 45 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 45

Incizimet kalimtare

1. Organizatat transmetuese, pa leje e autorit dhe mbajtësve të tjerë të të drejtave dhe pa kompensim, mund të bëjnë incizime të përkohshme të veprave nëpërmjet aparaturave të tyre dhe për transmetimet e tyre, duke rënë dakord që këto regjistrime të fshihen ose të shkatërrohen jo më vonë se brenda dymbëdhjetë (12) muajsh pas transmetimit.

2. Incizimet e referuar në paragrafin 1, mund të dorëzohen për ruajtje në një arkiv zyrtar shtetëror, nëse kanë rëndësi të veçantë dokumentuese.

Neni 12

Neni 49 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 49

Përdorimi për qëllim të informimit të publikut

1. Lejohet që pa lejen e autorit ose të mbajtësit tjetër të të drejtave dhe pa kompensim:

1.1. Përdorimi i veprës ose lëndës tjetër të mbrojtur në lidhje me raportimin e ngjarjeve aktuale, në masën e justifikuar për qëllim informimi dhe për sa kohë burimi, përfshirë dhe emrin e autorit, tregohet, përveç se kur kjo është e pamundur.

1.2. Përdorimi i fjalimeve politike ose fjalimeve të tjera të mbajtura në debatet publike deri në masën për qëllim të informimit.

Neni 13

Neni 57 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 57

Përdorimi nga shtypi i artikujve të publikuar

Lejohet që pa lejen e autorit ose të mbajtësit tjetër të të drejtave dhe pa kompensim: riprodhimi dhe shpërndarja nëpërmjet shtypit, transmetimi, komunikimi në publik ose vënia në dispozicion të publikut i artikujve të publikuar për çështjet aktuale ekonomike, politike ose fetare, ose transmetimi i veprave ose lëndëve tjera të mbrojtura të të njëjtit karakter, në rastet kur përdorimi i tillë nuk është shprehimisht i rezervuar, dhe përdorimi duhet përfshin burimin dhe emrin e autorit.

Neni 14

Pas nenit 59 të ligjit bazik shtohet neni i ri 59A, me tekstin si në vijim:

Neni 59A

Përdorimet e lejuara të veprave jetime

1. Organizatat e përmendura në nenin 12A, paragrafi 5 mund të përdorin veprat jetime që përmban koleksioni i tyre, në mënyrat e mëposhtme:

1.1. duke vënë veprën jetime në dispozicion të publikut;

1.2. duke e riprodhuar për qëllim digjitalizimi, vënies në dispozicion të publikut, indeksimit, bërjes katalog, ruajtjes dhe restaurimit.

2. Organizatat e përmendura në nenin 12A paragrafi 5, janë të obliguara do të përdorin një vepër jetime në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, me qëllim përmbushjen e misionit të interesit publik, përkatësisht për ruajtjen, restaurimin, si dhe ofrimin e qasjes për qëllime kulturore dhe arsimore të veprave dhe fonogrameve, pjesë të koleksioneve të tyre.

3. Organizatat e përmendura në nenin 12A paragrafi 5, mund të gjenerojnë të ardhura gjatë përdorimit të veprave jetime, me qëllimin e vetëm për të mbuluar shpenzimet e digjitalizimit të veprave jetime, si dhe të vënies së të tyre në dispozicion të publikut.

4. Organizatat e përmendura në nenin 12A paragrafi 5, vënë emrin e autorëve të identifikuar dhe mbajtësve të tjerë të drejtave në çdo përdorim të veprës jetime.

5. Mbrojtja me këtë ligj nuk cenon lirinë e kontraktimit të organizatave të fjalë, në përmbushjen e misionit të tyre të interesit publik, veçanërisht në marrëveshjet e partneritetit publik-privat.

6. Në rast se një mbajtës i të drejtës së autorit, më vonë bëhet i njohur ose gjendet, organizatat e përmendura në nenin 12A paragrafi 5, duhet që menjëherë të ndalojnë përdorimin e veprës dhe janë të detyruar ti paguajnë mbajtësit të të drejtës së autorit, një kompensim të arsyeshëm për çdo përdorim të veprës.

7. Kushtet nën të cilat kryhet ky kompensim dhe niveli i këtij kompensimi përcaktohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Neni 15

Neni 61 i ligjit bazik, pas paragrafit 6, shtohet paragrafi i ri 6a, me tekstin si në vijim:

6a. Afati i mbrojtjes së veprave muzikore me tekst do përfundojë shtatëdhjetë (70) vjet pas vdekjes së personit të fundit, pavarësisht nëse këta persona janë ose jo të përcaktuar si bashkë-autor: autori i tekstit dhe kompozitori i kompozimit muzikor, në rast se kontributi i të dyve ishte posaçërisht i krijuar për të njëjtën vepër muzikore me tekst.

Neni 16

Neni 132 i ligjit bazik, paragrafit 1, para fjalës së parë shtohet teksti si në vijim:

1. Kur një fonogram i publikuar për qëllime komerciale, apo një riprodhimi i fonogramit të tillë, përdoren për një transmetim në radio apo televizion me çdo mjet, sikur me valë pa tel, satelit apo kabllorë, ose për komunikim të publikut, shfrytëzuesi është i obliguar të paguajë një kompensim të vetëm dhe të drejtë për interpretuesit, interpretimet e të cilëve janë në këto regjistrime dhe për prodhuesit e këtyre regjistrimeve.

Neni 17

Pas nenit 132 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 132A me tekstin si në vijim:

Neni 132A

Kalimi i të drejtave pasurore të interpretuesit në një fonogram

1. Nëse, pesëdhjetë (50) vjet pasi fonogrami është publikuar në mënyrë të ligjshme, ose kur nuk është publikuar në mënyrë të tillë, pesëdhjetë (50) vjet pasi është komunikuar në publik në mënyrë të ligjshme, prodhuesi i fonogramit nuk ofron për shitje kopje të fonogramit në masë të mjaftueshme ose nuk vë në dispozicion të publikut, me mjete me tel ose pa-tel, në mënyrë të tillë që publiku mund të i qasen atij nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur në mënyrë individuale prej tyre, interpretuesi ka të drejtë të ndërpresë kontratën nëpërmjet së cilës i ka kaluar ose bartur të drejtat për regjistrimin e interpretimit të prodhuesit të fonogramit.

2. E drejta e ndërprerjes së kontratës mbi kalimin ose bartjen e të drejtave mund të ushtrohet nëse prodhuesi, brenda një (1) viti nga marrja e njoftimit nga interpretuesi, me qëllim të ndërprerjes së kontratës mbi kalimin ose bartjen e të drejtave, nuk ka realizuar të dyja të drejtat e shfrytëzimit të përmendura në paragrafin e mësipërm. Nëse në përfundim të periudhës dymbëdhjetë (12) mujore nga data e njoftimit, prodhuesi nuk i ka përmbushur kushtet e përmendura, marrëveshja e tij ndërpritet dhe e drejta e mbi fonogramin pushon me efekt të menjëhershëm. E drejta për të ndërprerë kontratën është e drejtë nga e cila nuk mund të tërhiqet interpretuesi.

3. Në kuptim të këtij neni termi “prodhues” përfshin personin, për sa kohë ky i fundit është mbajtësi së drejtës mbi fonogramin.

4. Në kuptim të këtij neni termi “Sasi të mjaftueshme” do të thotë sasi e tillë që plotëson kërkesat e arsyeshme të publikut për kopje të fonogramit.

5. Në rastin kur kontrata i jep të drejtë interpretuesit të kërkojë një kompensim jo-periodik, atëherë interpretuesi ka të drejtën e një kompensimi plotësues nga prodhuesi i fonogramit për çdo vit të plotë, menjëherë pas pesëdhjetë (50) vjetorit pasi fonogrami është publikuar në mënyrë të ligjshme, ose kur nuk është publikuar në mënyrë të tillë, pesëdhjetë (50) vjet pasi është komunikuar në publik në mënyrë të ligjshme. Interpretuesi nuk mund të tërhiqet nga e drejta për të përfituar kompensimin plotësues vjetor.

6. Shuma e përgjithshme e rezervuar nga prodhuesi i fonogramit për pagesën e kompenzimit plotësues vjetor të parashikuar në paragrafin 3, do të llogaritet në masën

njëzet përqind (20%) të të ardhurave të vitit paraprak që janë përfituar nga prodhuesi si rezultat i riprodhimit, shpërndarjes dhe vënies në dispozicion të publikut të fonogramit në fjalë, pas vitit të pesëdhjetë (50) nga data e publikimit të ligjshëm, apo në mungesë të këtij publikimi, pas vitit të pesëdhjetë (50) të komunikimit publik në mënyrë të ligjshme.

7. Prodhuesit e fonogramit nëpërmjet kërkesës, u ofrojnë interpretuesve të cilët kanë të drejtën e përfitimit të kompenzimit plotësues vjetor siç përmendet në paragrafin 6, çdo informacion të nevojshëm për të siguruar për pagesën e kompenzimit.

8. Kur interpretuesi ka të drejtën e kompenzimit periodik, në këtë kompenzim nuk aplikohet paradhënia dhe nuk bëhen zbritjet e përcaktuara kontraktuese nga kompenzimet e bëra për interpretuesin duke filluar nga viti i pesëdhjetë (50) i publikimit të ligjshëm apo, në mungesë të këtij publikimi, pas vitit të pesëdhjetë (50) të komunikimit në publik në mënyrë të ligjshme

Neni 18

Neni 137 i ligjit bazik, paragrafi 1 riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Të drejtat pasurore të interpretuesit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga interpretimi i bërë. Nëse fiksimi i performancës nuk është në fonogram, por brenda kësaj periudhe në mënyrë të ligjshme publikohet ose i komunikohet publikut, të drejtat e interpretuesit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet nga dita e publikimit të parë, ose e komunikimit të parë në publik, varësisht se cili veprim ka ndodhur më parë. Nëse interpretimi i fiksuar në një fonogram është publikuar në mënyrë të ligjshme ose në mënyrë të ligjshme i është komunikuar publikut brenda kësaj periudhe, të drejtat të zgjasin shtatëdhjetë (70) vjet nga data e publikimit të parë të tillë ose nga komunikimi e parë i tillë në publik, varësisht se cili veprim ka ndodhur më parë.

Neni 19

Neni 141 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 141

Kohëzgjatja e të drejtave të prodhuesit të fonogramit

1. Të drejtat e prodhuesve të fonogramit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet nga koha fiksimit të fonogramit. Megjithatë, nëse fonogrami publikohet brenda kësaj periudhe në mënyrë të ligjshme, këto të drejta zgjasin shtatëdhjetë (70) vjet nga data e publikimit të parë të ligjshëm.

2. Nëse fonogrami nuk është publikuar në mënyrë të ligjshme brenda periudhës të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, dhe nëse fonogrami është komunikuar në mënyrë të ligjshme publikut brenda kësaj periudhe atëherë të drejtat do të zgjasin shtatëdhjetë (70) vjet nga data e komunikimit të parë të ligjshëm në publik.

3. Paragrafi 1 dhe 2 nuk ka efekt në mbrojtjen e të drejtave të prodhuesve të fonogramit, nëse afati i mbrojtjes së këtyre të drejtave ka përfunduar me 22 dhjetor 2002 sipas Ligjit Nr. 04/L065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Neni 20

Në nenin 146 të ligjit bazik, pas fjalës së fundit shtohet teksti si në vijim:

,pavarësisht nëse ky transmetim është bërë më tel apo pa tel, përfshirë me kabëll apo satelit.

Neni 21

Në nenin 160 të ligjit bazik, shtohet nënparagrafi 1.14., dhe paragrafi i ri 2, ndërsa paragrafi 2 i ligjit bazik riformulohet dhe kalon në paragrafin 2.7. dhe neni i shtohet paragrafi 3, me tekstin si në vijim:

1.14. E drejta për të mbledhur një shpërblim plotësues vjetor siç përmendet në nenin 132A paragrafi 3.

2. Në përputhje me dispozitat përkatëse të këtij ligji, të drejtat e mëposhtme mund të ushtrohen vetëm nëpërmjet një shoqate kolektive të licencuar për këtë qëllim nga Zyra për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta:

2.1. e drejta e kompensimit të drejtë për kopjen private të veprave ose objekt i të drejtave të lidhura siç parashikohet në nenin 44, paragrafi 2.1;

2.2. e drejta e kompensimit të drejtë për riprodhimin reprografik siç parashikohet në nenin 44, paragrafi 2.2;

2.3. e drejta e kompensimit të drejtë të autorëve dhe interpretuesve e ruajtur pas kalimit të të drejtës së tyre ekskluzive të qiradhënies tek prodhuesi i fonogramit ose veprës audiovizuale, siç parashikohet në nenin 113, paragrafi 4.3 dhe 132 paragrafi 2;

2.4. e drejta për kompensim për huadhënien siç parashikohet në nenin 37 paragrafi 1;

2.5. e drejta e komunikimit publik të veprave muzikore jo-skenike dhe të veprave të shkruara, të drejtave të vogla;

2.6. e drejta e interpretuesit dhe prodhuesit të fonogramit për një kompensim të drejtë të vetëm për transmetimin dhe komunikimit në publik të fonogrameve të publikuar për qëllime komerciale siç parashikohet në nenin 132 paragrafi 1;

2.7. e drejta e ritransmetimit kabllor të veprave dhe të drejtave të përafërta si parashikohet në nenin 30 paragrafi 1, përveç transmetimeve vetanake të shërbyesve medial audiovizuel, pavarësisht nëse ka të bëjë me të drejtat e tyre vetanake apo të drejtat e kaluara nga bartësit e tjerë të të drejtave.

3. Kompensimet e mbledhura nga përdoruesit, për të cilat nuk ka pas pretendim nga askush brenda tre (3) vjetëve nga fundi i vitit në të cilin ato janë mbledhur, shoqata kolektive është e legjitimuar ti sistemojë ato shuma ose duke i shtuar ato shumave që do të shpërndahen, ose duke i alokuar ato për qëllime të tjera në të mirë të mbajtësve të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Neni 22

Në nenin 161 të ligjit bazik, paragrafi 3 riformulohet, ndërsa pas paragrafit 5 shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si në vijim:

3. Të drejtat në paragrafin 2 të nenit 20 të këtij ligji administrohen nga shoqata për administrim kolektiv të të drejtave pa autorizimin e autorit dhe bartësit të së drejtës.

6. Gjatë kohës kur të drejtat janë të bartura në një shoqatë kolektive, përmes ligjit apo me autorizim, autori nuk mundet të menaxhoj të njëjtat të drejta individualisht.

Neni 23

Neni 163 i ligjit bazik, paragrafi 2, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Shoqata për administrim kolektiv të të drejtave ka statusin e një organizate jo-fitim prurëse.

Neni 24

Neni 167 i ligjit bazik, paragrafit 2 pas fjalës së fundit i shtohet një fjali, dhe të njëjtit paragraf i shtohen edhe nën paragrafët 2.1., 2.2., 2.3., 2.4., 2.5., 2.6., me tekstin si në vijim:

,duke marrë parasysh kriteret si në vijim:

2.1. të hyrat që mund të fitohen nga përdorimi i veprës ose të lëndës së të drejtave të përfaqëta;

2.2. kur të ardhurat nuk e reflektojnë natyrën e përdorimit të veprave ose lëndës së të drejtave të përfaqëta, kostoja e përdorimit të tyre ose ndikimi në shfrytëzimin normal të tyre nga mbajtësi i të drejtës;

2.3. kapacitetin i vendit ku përdoren veprat ose lënda e të drejtave të përfaqëta;

2.4. madhësinë e publikut për të cilin janë vënë në dispozicion veprat ose lënda e të drejtave të përfaqëta;

2.5. rëndësinë e përdorimit të veprave ose lëndës së të drejtave të përfaqëta për aktivitetet relevante të përdoruesve;

2.6. raportin ndërmjet veprave ose lëndës së të drejtave të përfaqëta të mbrojtura me ato të pambrojtura.

Neni 25

Neni 176 i ligjit bazik, paragrafi 4 riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Ndërmjetësuesi mund të paraqesë palëve propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Supozohet që palët e pranojnë propozimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, në rast se asnjë prej tyre nuk ka shprehur kundërshtim, brenda një periudhe tre (3) mujore nga dërgimi i propozimit. Njoftimi i propozimit dhe i çdo kundërshtimi për të do ti dërgohet palëve të përfshira, në përputhje me rregullat e aplikueshme mbi dërgimin e dokumenteve ligjore.

Neni 26

Neni 177 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 177

Personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e masave, procedurave dhe mjeteve juridike

1. Mbajtësit e ligjshëm të të drejtave të njohura e të garantuara në bazë të këtij ligji gëzojnë të drejtën për t'i kërkuar gjykatës respektimin e të drejtave të tyre, konstatimin e shkeljes së kryer dhe dëmshpërblimin përkatës.

2. Të drejtat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, i gëzojnë:

2.1. Individët që janë autorizuar dhe licencuar nga mbajtësit e së drejtës për përdorimin e të drejtave që mbrohen nga ky ligj, në përputhje me autorizimin që iu është dhënë atyre për këtë qëllim.

2.2. Shoqatat e administrimit kolektiv të të drejtave, pavarësisht nëse autorizimi është në bazë të kalimit të të drejtave apo me autorizimin e përfaqësimit. Organizata e administrimit kolektiv, në çdo rrethanë, është e legjitimuar të iniciojë veprime gjyqësore ose jashtëgjyqësore në emër të vet dhe të ushtrorë me legjitimitet të plotë të gjitha të drejtat e kaluara, ose për të cilat ka autorizimin e përfaqësimit.

2.3. Organizatat profesionale të mbrojtjes dhe shoqatat përfaqësuese, të cilat janë autorizuar për të përfaqësuar mbajtësit e të drejtave.

Neni 27

Neni 181 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, riformulohet, dhe këtij paragrafi pas nënparagrafit 1.6, i shtohet nënparagrafi i ri 1.7, me tekstin si në vijim:

1.3. mallrat e krijuara si rezultat i shkeljes së drejtave nga ky ligj, materialet dhe pajisjet e përdorura për krijimin ose prodhimin e këtyre mallrave, do të kërkohej të largohen nga tregu dhe të shkatërrohen me shpenzimet e shkelësit, përveç se kur ka arsye të veçanta për të mos vepruar kështu;

1.7. nxjerrjen e një vendimi kundër ndërmjetësve, shërbimet e të cilëve përdoren nga një palë e tretë për të cenuar të drejtën e autorit apo të drejtat e përafërta.

Neni 28

Neni 184, 185 dhe 186 i ligjit bazik fshihen në tërësi. Ligji plotësohet me nenet e reja 184, 185 dhe 186, me tekstin si në vijim:

Neni 184

Provat

1. Me kërkesë të një pale, e cila paraqet prova të arsyeshme, të mjaftueshme për të mbështetur pretendimin e saj, dhe për të provuar këto pretendime ekzistojnë prova të veçanta, të cilat prova janë nën kontrollin e palës kundërshtare, Gjykata mund të urdhërojë që këto prova të paraqiten nga pala e kundërshtare, duke ju nënshtruar rregullave mbi mbrojtjen e informacionit konfidencial. Provë e arsyeshme nga autoritetet kompetente gjyqësore konsiderohet një mostër e e një numri kopjesh të veprave, ose çdo objekti tjetër të mbrojtur.

2. Në rrethana të njëjta kur kryhet shkelje në nivel komercial, Gjykata, kur është e nevojshme, vendos me kërkesë të palës propozuese, paraqitjen e dokumenteve bankare, financiare ose komerciale të palës kundërshtare, dokumente që u nënshtrohen mbrojtjes së informacionit konfidencial.

Neni 185

Sigurimi i provave

1. Mbajtësit e të drejtave ose përfaqësuesit e tyre të përmendur në nenin 177, të cilët kanë paraqitur prova të arsyeshme e të mjaftueshme për të mbështetur pretendimet e tyre, mund ti kërkojnë Gjykatës, para fillimit të procesit gjyqësor, të marrë masa për sigurimin e provave ose të konstatoj situatën faktike, kur ka rrezik për shkelje të të drejtave të garantuara nga ky ligj, si dhe kur ka rrezik për shkatërrim të elementëve të provës. Këto masa duhet të merren nëse është e nevojshme, dhe pa dëgjuar palën tjetër, në veçanti, nëse çdo vonesë ka mundësi të shkaktojë dëme të parikuperueshme për mbajtësin e të drejtave, ose kur ka rrezik të dukshëm për shkatërrimin e provave.

2. Kur masat për sigurimin e provave merren pa dëgjuar palën tjetër, palët që preken nga ky vendim do të njoftohen, pa vonesë menjëherë dhe më së largu pas ekzekutimit të masave. Një rishqyrtim, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, do të zhvillohet me kërkesë të palëve ndaj të cilave është marrë masa, me synim gjykimin brenda një periudhe të arsyeshme pas njoftimit, për të vendosur nëse masat do të ndryshohen, shfuqizohen apo konfirmohen.

3. Masat e përmendura në paragrafin 1 mund të përmbajnë një përshkrim të hollësishëm të mallrave që shkelin të drejtat, me ose pa marrjen e shembujve të tyre ose sekuestrim fizik, kur vlerësohet edhe të materialeve dhe mjeteve të përdorura për të prodhuar dhe/ose shpërndarë këto mallra, si dhe dokumentet përkatëse. Këto masa do të merren në përputhje me dispozitat e Procedurës Civile.

4. Masat e urdhëruara nga gjykata për sigurimin e provave ose për gjendjen faktike lidhur me shkeljen zbatohen nga personi zyrtar. Mbajtësit e të drejtave ose përfaqësuesit e tyre, të drejtat e të cilëve supozohet se janë shkelur ose janë në rrezik për të u shkelur, lejohet të marrin pjesë në procedurën zbatimin e masave të sigurimit të provave dhe të shqyrtimit faktik.

5. Masat për sigurimin e provave mund të jenë objekt i kushtëzimit me garanci financiare nga pala propozuese, për të garantuar në mënyrë të mjaftueshme e të barasvlershme, kompensimin për çdo cenim që mund të pësojë pala e kundërshtare.

6. Masat për sigurimin e provave revokohen ose pushojnë të kenë efekt, me kërkesë të

palës kundërshtare, në rast se pala propozuese, brenda një periudhe të arsyeshme, nuk inicon procedurë në gjykatën kompetente për të gjykuar çështjen në mënyrë meritore, por pa cenuar dëmshpërblimin i cili mund të kërkohet. Periudha duhet të caktohet nga gjykata kompetente që ka urdhëruar masat, ose në mungesë të këtij përcaktimi, brenda një periudhe e cila nuk duhet ti kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga data kur masa ka filluar.

7. Kur masat për sigurimin e provave janë revokuar, ose janë hequr për shkak të çdo veprimi ose mos veprimi nga pala propozuese, ose kur në vijim rezulton se nuk ka pas shkelje ose rrezik për shkelje të të drejtave, gjykata kompetente mund urdhërojë palën propozuese sipas kërkesë së palës kundërshtare, ti i jap kësaj të fundit kompensimin e duhur për çdo dëm të shkaktuar nga këto masa.

8. Kundër vendimit të gjykatës, me anë të cilit është marrë vendim për të pranuar apo refuzuar sigurimin e provave mund të parashtrahet ankesë.

9. Procedura për sigurimin e provave zbatohet brenda shtatë (7) ditëve nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 186

Masat e përkohshme dhe paraprake

1. Me kërkesë të palës propozuese, Gjykata mund:

1.1. të lëshojë urdhër të përkohshëm kundër shkelësit të pretenduar, me qëllim të ndalimit të shkeljes së mundshme të të drejtave të mbrojtura me këtë ligj, ose të ndalojë, në mënyrë të përkohshme, vazhdimin e shkeljes së pretenduar të të drejtave, ose të bëjë këtë subjekt të garancisë financiare me qëllim kompensimin e mbajtësit të të drejtës; një urdhër i përkohshëm mund të lëshohet gjithashtu dhe kundër një ndërmjetësi, shërbimet e të cilit përdoren nga një palë e tretë për të shkelur të drejtat e mbrojtura me këtë ligj.

1.2. urdhërojë sekuestrimin apo dorëzimin e mallrave, që dyshohet se përdoren për shkeljen e të drejtave që mbrohen me këtë ligj, në mënyrë që të parandalohet hyrja apo qarkullimi i tyre komercial.

1.3. urdhërojë kur është e nevojshme, në rast të moszbatimit të një mase sigurie të vendosur, shqiptimin e një gjobe, me qëllim përmbushjen e saj.

2. Në rastin e shkeljes së kryer në nivel komercial, nëse pala e dëmtuar dëshmon se rrethanat rrezikojnë marrjen e dëmshpërblimit, Gjykata vendos bllokimin paraprak të pasurisë të luajtshme dhe të paluajtshme të shkelësit të pretenduar, përfshi bllokimin e llogarive bankare dhe pasurive të tjera. Për këtë qëllim, gjykata kompetente mund të kërkojë informacione relevante ose qasje në dokumentet bankare, financiare ose dokumentet komerciale.

3. Në lidhje me masat e parashikuara në paragrafët 1 dhe 2, është në kompetencë të gjykatës, t'i kërkojë palës propozuese të ofrojë çdo të dhënë të arsyeshme që ka në dispozicion, me qëllim që të provohet në shkallë të mjaftueshme, se pala propozuese është mbajtës i së drejtës dhe se të drejtat e tij janë shkelur, apo një shkelje e tillë është afër për të ndodhur.

4. Masat e përkohshme të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, në rastet kur është e nevojshme, mund të merren pa dëgjuar palën kundërshtare, veçanërisht kur çdo vonesë do t'i shkaktonte mbajtësit të së drejtës dëme të pariparueshme. Në këtë rast palët njoftohen në kohë, më së largu pas ekzekutimit të masave.

5. Me kërkesë të palës kundërshtare, mund të kërkohet rishikim i vendimit, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, brenda një kohe të arsyeshme pas njoftimit për ekzekutimin e masave, për të vendosur lidhur me ndryshimin, revokimin apo konfirmimin e tyre.

6. Masat e përkohshme të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, revokohen ose pushojnë të kenë efekt, me kërkesë të palës kundërshtare, në rast se pala propozuese, brenda një periudhe të arsyeshme, nuk merr veprim përpara gjykatës kompetente për të gjykuar çështjen në mënyrë meritore. Periudha duhet të caktohet nga gjykata kompetente që ka dhënë masat, ose në mungesë të këtij përcaktimi, brenda një periudhe e cila nuk duhet të kalojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, duke filluar nga data kur masa e përkohshme ka filluar.

7. Gjykata mund të kushtëzojë masat e përkohshme të përmendura në paragrafët 1 dhe 2, me garanci financiare ose siguri të përshtatshme ekuivalente, të palës propozuese, për të garantuar kompensim për çdo cenim që mund të pësojë pala kundërshtare kur masat e përkohshme revokohen ose pushojnë për shkak të veprimit ose mos veprimit të palës propozuese, ose kur në vijim rezulton që nuk ka pas shkelje ose rrezik për shkelje të të drejtave, gjykata kompetente mund të urdhërojë palën propozuese me kërkesë të palës kundërshtare, dhënien e kompensimit të duhur për çdo dëm të shkaktuar nga këto masa.

8. Kundër vendimit të gjykatës e cila ka vendosur masat e përkohshme ose paraprake, mund të ushtrohet ankesë, për ndryshimin ose heqjen e këtyre masave. Ankesa nuk pezullon ekzekutimin e vendimit.

9. Garancioni i ofruar në përputhje me paragrafin 6 të këtij neni i kthehet palës propozuese, në rast se pala tjetër nuk kërkon dëmshpërblim për dëmin e shkaktuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga shpallja e vendimit përfundimtar të Gjykatës, i cili ka shpallur që nuk ka pas shkelje të kryer.

10. Procedura për masat e përkohshme dhe paraprake zbatohet brenda shtatë (7) ditëve nga parashtrimi i kërkesës.

Neni 29

Neni 189 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 189

Detyrimi për dhënie informacioni

1. Në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me shkeljen e së drejtës të autorit dhe të drejtave të përafërta, sipas kërkesës së bazuar dhe të arsyetuar të paditësit, gjykata kompetente mund të urdhërojë dhënien e informatave mbi origjinën dhe rrjetet shpërndarëse të mallrave ose shërbimeve që shkelin të drejtat e mbrojtura me këtë ligj, nga shkelësi dhe/ose çdo person tjetër, i cili:

- 1.1. posedon mallra që shkelin të drejtat në nivel komercial;
- 1.2. përdorë shërbime që shkelin të drejtat në nivel komercial;
- 1.3. konstatohet se ofron shërbime të natyrës komerciale, që përdoren në veprimtari të cilat përbëjnë shkelje; ose
- 1.4. është përmendur nga personi i referuar në pikën 1.1., 1.2. ose 1.3, si i përfshirë në prodhimin, fabrikimin ose shpërndarjen e mallrave apo ofrimin e shërbimeve.

2. Informacioni i përmendur në paragrafin 1, kur është e nevojshme, duhet të përmbajë:

- 2.1. emrat dhe adresat e prodhuesve, fabrikuesve, shpërndarësve, furnizuesve dhe poseduesve të mëparshëm të mallrave ose shërbimeve, si dhe të shitësve me shumicë dhe me pakicë;
- 2.2. informatat mbi sasi të prodhuara, të fabrikuara, të dërguara, pranuar apo porositura, si edhe çmimin e përcaktuar për mallrat ose shërbimet në fjalë.

3. Paragrafët 1 dhe 2 nuk gjejnë zbatim, nëse:

- 3.1. dispozitat e ndryshme i japin të drejtë mbajtësit të së drejtës të marrë informacion më të plotë;
- 3.2. përdorimi i informacionit të përcjellë në përputhje me këtë nen, rregullohet nga dispozita të tjera të procedurës civile ose penale;
- 3.3. Gjykata, në bazë të informacionit që ka në dispozicion, ka arsye të supozojë se e drejta për informim është keqpërdorur nëse:
 - 3.3.1. dhënia e informacionit të kërkuar do të detyronte personin e përmendur në paragrafin 1 të pranonte pjesëmarrjen e tij apo atë të të afërmeve të tij në shkeljen e së drejtës së autorit ose të drejtave të përafërta;
 - 3.3.2. zbulimi i informacionit nuk lejohet, nga rregullat që janë në fuqi për mbrojtjen e konfidencialitetit të burimeve të informacionit apo përpunimin e të dhënave personale.

4. Çdo person i cili nuk përmbush detyrimin për të dhënë informacion sipas dispozitave të këtij neni, do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushja e këtij detyrimi.

Neni 30

Nenit 190 paragrafit 1, nenit 191 paragrafit 1 dhe nenit 192 paragrafit 1 të ligjit bazik, pas fjalëve “person juridik” shtohet teksti si vijon: “ose biznes individual”.

Neni 31

Neni 199 i ligjit bazik, paragrafi 5 riformulohet, si dhe pas këtij paragrafi shtohen paragrafët 6, dhe 7, me tekstin si në vijim:

5. E drejta e parashikuar në nenin 149 do të zbatohet mbi ato baza të të dhënave, prodhuesit e të cilëve ose mbajtësit e të drejtave të tyre janë shtetas të Republikës së Kosovës ose kanë vendbanimin e përhershëm në territorin e Republikës së Kosovës.

6. E drejta e parashikuar në nenin 149 do të zbatohet gjithashtu tek kompanitë dhe firmat tregtare të krijuara në përputhje me legjislacionin e Kosovës dhe që kanë zyrën e tyre të regjistruar, në administratën qendrore apo vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tregtare brenda territorit të Republikës së Kosovës. Në rastet, kur ky subjekt tregtar ose firmë, ka vetëm zyrën e regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës, veprimtaria e tij duhet të jetë e lidhur në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme me ekonominë e Republikës së Kosovës.

7. Marrëveshjet që e shtrijnë të drejtën e parashikuar në nenin 149 për bazat e të dhënave të krijuara në vendet e treta dhe që nuk janë objekt i dispozitave të paragrafëve 5 dhe 6 mbrohen në bazë të një traktati ndërkombëtar ku Republika e Kosovës është palë. Afati i mbrojtjes për bazat e të dhënave të krijuara në një shtet tjetër nuk e tejkalon atë që parashikohet në nenin 149.

Neni 32

Neni 200 i ligjit bazik, paragrafi 2 fshihet dhe ligji plotësohet me paragrafin e ri 2, si në vijim:

2. Kur një akt i komunikimit në publik me anë të satelitit ndodh në një shtet tjetër, i cili nuk ka të njëjtin nivel mbrojtje si parashikohet nga ky ligj:

2.1. nëse sinjalet bartëse të programit transmetohen në satelit nga një stacion transmetimi i ndodhur në një shtet tjetër, ky akt i përcjelljes në publik me anë të satelitit do të konsiderohet sikur ka ndodhur në atë shtet dhe të drejtat do të ushtrohen kundrejt personit që operon me stacionin transmetues.

2.2. nëse nuk përdoret një stacion transmetimi i ndodhur në një shtet tjetër, por një organizatë transmetuese e themeluar në Kosovë ka porositur aktin e përcjelljes në publik me anë të satelitit, ky transmetim konsiderohet të ketë ndodhur në Kosovë dhe të drejtat do të ushtrohen kundrejt organizatës transmetuese.

Neni 33

Neni 201 i ligjit bazik, paragrafit 1, pas fjalës “e huaj”, i shtohen fjalët me tekstin si në vijim:
“të drejtave të autorit dhe “

Neni 34

Neni 204 i ligjit bazik, paragrafi 7 fshihet dhe riformulohet, paragrafi 8 fshihet dhe riformulohet dhe bëhet paragrafi 11, dhe nenit i shtohen paragrafët 8, 9, dhe 10, me tekstin si në vijim:

7. Dispozitat e këtij ligji sa i takon programeve kompjuterike zbatohen mbi programet

kompjuterike të krijuara pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por kontratat e firmosura dhe të drejtat e fituara përpara kësaj dite mbeten të pacenuara.

8. Mbrojtja me këtë ligj sa i takon të drejtës së autorit, do të jetë e vlefshme për bazën e të dhënave të krijuara përpara 1 janar 1998, të cilat në atë moment përmbushnin kërkesat e parashikuara me këtë ligj, sa i takon mbrojtës së bazës të të dhënave nga e drejta e autorit. Mbrojtja e parashikuar në këtë paragraf nuk do të cenojë asnjë veprim juridik të bërë dhe të drejtat e fituara përpara 1 janar 1998.

9. Mbrojtja bazuar në dispozitat e këtij ligji, sa i takon të drejtave të parapara në nenin 149, vlen edhe për bazat e të dhënave, krijimi i të cilave ka përfunduar jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vjet përpara datës 1 janar 1998, dhe të cilat në atë moment përmbushnin kërkesat e parapara në nenin 149. Mbrojtja e paraparë në këtë paragraf nuk do të cenojë asnjë veprim juridik të bërë dhe të drejtat e fituara përpara 1 janar 1998.

10. Në rastin e bazës së të dhënave, krijimi i së cilës ka përfunduar jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) vjet përpara datës 1 janar 1998, afati i mbrojtjes për të drejtat e parashikuara në nenin 149 do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) vjet pas 1 janarit në vijim të asaj date.

11. Me pranimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, shuarja e të drejtës së shpërndarjes, përmendur në nenin 24.2 të këtij ligji, do të aplikohet për çdo shitje të parë apo transferim të pronësisë të një origjinali apo kopje të veprës, të bërë kudo në Bashkimin Evropian ose në Zonën Ekonomike Evropiane.

Neni 35

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 05/L -047

11 tetor 2016

Shpallur me dekretin Nr. DL-37-2016, datë 25.10.2016 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi.